



UDHËRRËFYESI - MODUL PËR TRAJNIMIN E TRAJNERËVE

Modul trajnimi për
të` mësuarit për botëkuptimet
fetare dhe jofetare në
edukimin ndërkulturor

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

UDHËRRËFYESI- MODUL PËR TRAJNIMIN E TRAJNERËVE

Modul trajnimi për të
mësuarit për botëkuptimet
fetare dhe jofetare në
edukimin ndërkulturor

Opinionet e shrehura në këtë botim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës ose të EWC.

Të gjitha kërkesat në lidhje me riprodhimin ose përkthimin e të gjithë ose të pjesëve të veçanta të këtij dokumenti duhet të drejtohen në Drejtorinë e Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int)

Fotot: Shutterstock, Astrit Dautaj, Wanderson

ISBN 978-92-871-8967-7

© Council of Europe, 2020

Autorët dhe kontribuesit

Autorët

- ▶ Z. Jon Harald Bondevik (Norvegji)
- ▶ Z. Astrit Dautaj (Shqipëri)
- ▶ Dr. Kevin O'Grady (UK)
- ▶ Dr. Angelos Vallianatos (Greqi)

Ekipi i Projektit

- ▶ Znj. Ana Perona-Fjeldstad, Drejtore Ekzekutive, Qendra Evropiane Wergeland
- ▶ Znj. Jennie Holck-Clausen, Këshilltare, Qendra Evropiane Wergeland

Korrektor gjuhësor

- ▶ Dr Kevin O'Grady

Ilustrimet dhe dizajni

- ▶ Znj. Marta Melnykevych-Chorna, Këshilltare, Qendra Evropiane Wergeland
- ▶ Znj. Nataly Zhurb

Contents

| | |
|--|-----------|
| PARATHËNIE | 5 |
| UDHËZIME | 7 |
| KAPITULLI 1 – REKOMANDIMET: SFONDI, ÇËSHTJE, SFIDA | 11 |
| KAPITULLI 2 – UDHËRRËFYESI DHE ÇËSHTJET E TIJ KRYESORE | 17 |
| KAPITULLI 3 – TERMINOLOGJIA QË SHOQËRON MËSIMDHËNIEN PËR FENË DHE BESIMET | 37 |
| KAPITULLI 4 – KOMPETENCA DHE DIDAKTIKA PËR TË KUPTUARIT E FEVE | 43 |
| KAPITULLI 5 – KLASA SI HAPËSIRË E SIGURT | 49 |
| KAPITULLI 6 – PARAQITJA E FESË NË MEDIA | 59 |
| KAPITULLI 7 – BINDJET DHE BOTËKUPTIMET JO FETARE | 67 |
| KAPITULLI 8 – ÇËSHTJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT | 73 |
| KAPITULLI 9 – LIDHJA E SHKOLLËS ME KOMUNITETE DHE ORGANIZATA MË TË GJERA | 83 |

Parathënie

Robert Jackson

Ana Perona-Fjeldstad

Botimi i këtij moduli trajnimi që bazohet në “Udhërrëfyesin: Politika dhe praktika për mësimdhënien e botëkuptimeve fetare dhe jofetare në edukimin ndërkulturor” përbën një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e punës bashkëpunuese të Këshillit të Evropës me Qendrën Evropiane Wergeland (EWC) në lidhje me larminë e feve dhe të botëkuptimeve dhe me arsimin në shkollat Evropiane.

Historia relativisht e gjatë e hapave që sollën këtë botim na çon në vendimin për të përfshirë studimin e feve në programet arsimore të Këshillit të Evropës, në shtator të vitit 2002. Për këtë qëllim u hartua një projekt për integrimin e larmisë fetare dhe të dialogut në edukimin ndërkulturor që do të zbatohet nga një grup specialistësh nga shtete të ndryshme të Evropës dhe një përfaqësues nga Kanadaja. Projekti u titullua “Sfida aktuale e edukimit ndërkulturor: Larmia fetare dhe dialogu në Evropë” dhe u përfundua nga Komiteti i Ministrave në vitin në vijim.

Një ndër veprimtaritë e para të projektit ishte takimi i mbajtur në Paris në mesin e vitit 2003, në të cilin u mbledhën së bashku një grup specialistësh të edukimit fetar dhe ndërkulturor për të diskutuar për mënyrën e pasurimit të edukimit ndërkulturor me dimensionin fetar. Grupi rekomandoi që nxënësit e shkollave duhet të mësonin për fetë si pjesë përbërëse e edukimit ndërkulturor dhe duhet të përfshinte, për shembull, strategjitë për të kuptuarit e qëndrimeve të ndryshme fetare, nxitjen e tolerancës për (jo të pranimit) pikëpamjet e ndryshme fetare dhe jofetare, edukimin për të drejtat e njeriut, për qytetarinë dhe menaxhimin e konflikteve si dhe strategjitë kundër diskriminimit racialet dhe fetar në një botë të larmishme. Ngjarja e dytë e madhe e projektit ishte konferenca e nivelit të lartë “Dimensioni fetar në edukimin ndërkulturor” e mbajtur në Oslo në qershor të vitit 2004. Dokumentet e konferencës u botuan në një libër më vete (Këshilli i Evropës, 2004). Më pas grupi filloi punën për të prodhuar materiale, kryesisht për mësuesit dhe politikbërësit në Evropë, ndërkohë që përgatiti edhe një libër referues për shkollat e Evropës në vitin 2007 (Keast 2007).

Në vitin 2017, Qendra Evropiane Wergeland (QEW) vendosi të ndjekë idenë e Angelos Vallianatos (një

trajner mësues i cili punon ngushtë me QEW) për të zhvilluar një modul të trajnimit të mësuesve bazuar në Signposts (Udhërrëfyes). Në partneritet me Divizionin e Politikave Edukative të Këshillit të Evropës, QEW krijoi një grup të vogël ekspertësh për të përmbyshur këtë detyrë.

Rekomandimi ofron udhëzime për edukim për bindjet fetare dhe jofetare në kuadrin e edukimit ndërkulturor. Ai pranon larminë në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar dhe nxit lidhjet ndërmjet “lokales” dhe “globales”, eksplorimin e çështjeve që lidhen me fenë dhe identitetin dhe zhvillimin e marrëdhënieve pozitive me prindërit dhe komunitetet fetare si dhe organizatat që lidhen me filozofitë jofetare, të tilla si humanizmi sekularist. Synimi është të njihen të rinjtë me larminë e qëndrimeve në një klimë të tolerancës së ndërsjellë, brenda “hapësirës së sigurt” të klasës.

Pothuajse në të njëjtën kohë, Këshilli i Evropës po eksploronte mundësinë e krijimit të një qendre burimore dhe për trajnimin e mësuesve, e cila do të ofronte materiale dhe kurse për arsimtarët në të gjithë Evropën. Për këtë qëllim u krye edhe një studim për një mundësi të tillë nga Robert Jackson. Ky studim mbështeti idenë e krijimit të një qendre të tillë dhe si rrjedhim, Norvegjia dhe Këshilli i Evropës krijuan Qendrën Wergeland (EWC) në vitin 2008, me vendodhje në Oslo, e cila u quajt kështu për nder të poetit dhe aktivistit të të drejtave të njeriut të shekullit të 19-të, Henrik Wergeland. Robert Jackson u zgjodh Këshilltar në qendër për të ndihmuar stafin në hartimin e platformës së studimit të larmisë së feve dhe të botëkuptimeve, si pjesë e funksioneve të Qendrës. Ekipi në EWC ishte i interesuar të garantonte marrjen parasysh nga shtetet anëtare të Rekomandimit të vitit 2008, të Këshillit të Evropës për trajtimin e kësaj çështjeje u ngrit edhe një ekip i përbashkët ndërkombëtar, me përfaqësues të Këshillit të Evropës dhe EWC. Grupi përgatiti një pyetësor që u dërgua në Ministrinë e Arsimit në të gjitha shtetet anëtare. Pyetësori ftonte plotësuesit e tij të identifikonin vështirësitë që ata mendonin se do të kishin gjatë përshtatjes së Rekomandimit të Këshillit të Evropës në mjedinë e tyre kombëtar.

Analiza e përgjigjeve të pyetësorit identifikoi çështje të cilat janë të përbashkëta për shumë shtete anëtare, të tilla si:

- ▶ paqartësia dhe mungesa e një terminologjie të saktë në lidhje me mësimdhënien për fetë dhe besimet;
- ▶ nevoja për të kuptuar elementet përbërëse të "kompetencës" për të kuptuarit e feve;
- ▶ përpjekja për ta bërë klasën një "hapësirë të sigurt" për diskutim dhe dialog nga nxënësit;
- ▶ çështja si të ndihmohen nxënësit të analizojnë paraqitjen e feve në media;
- ▶ çështja si të integrohet studimi i bindjeve dhe botëkuptimeve jofetare me studimin për fetë;
- ▶ çështja si të trajtohen çështjet e të drejtave të njeriut në lidhje me fetë dhe besimet në shkollë dhe në klasë;
- ▶ çështja si të lidhet shkolla me komunitetin e gjerë dhe organizata të tjera me qëllim që të rrisë njohuritë e nxënësve për të kuptuarit e feve dhe të filozofive jofetare, të tilla si humanizmi sekularist.

Pas vendimmarrjeve të njëpasnjëshme nga komiteti i përbashkët dhe pas konsultimesh me kolegë në Francë, në Quebec, Norvegji dhe në Federatën Ruse, u mor vendimi për përgatitjen e një libri për vendimmarrësit dhe edukatorët, për eksplorimin e aspekteve të Rekomandimit në lidhje me çështjet e identifikuar në lart. Robert Jacksonit iu caktua detyra të shkruante librin në emër të komitetit, duke marrë parasysh edhe kërkimet ndërkombëtare si dhe duke dhënë shembuj konkretë nga përvoja e trajtimit të disa prej çështjeve në sisteme të ndryshme arsimore. Libri, "Udhërrëfyti: Politika dhe praktika për mësimdhënien e botëkuptimeve fetare dhe jofetare në edukimin ndërkulturor", u botua në vitin 2014. Pjesa kryesore e këtij libri trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjet kryesore të ngritura nga plotësuesit e pyetësorit. Në vitin 2018, Udhërrëfyti është përkthyer në 13 gjuhë dhe përdoret në shumë institucione të arsimit të lartë për përgatitjen fillestare të mësuesve të ardhshëm.

Në vitin 2017, EWC, në partneritet me Këshillin e Evropës ngriti një grup të vogël ekspertësh me

detyrën për të përgatitur një modul trajnimi që bazohet në Udhërrëfytesin. Qëllimi ishte shndërrimi i teorisë në një instrument të orientuar nga praktika, për të qenë në shërbim të mësuesve.

Projekti bashkoi kolegë nga Shqipëria, Greqia, Norvegjia, Suedia dhe Anglia dhe sekretariatit e EWC. Moduli do të përdoret në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe më gjerë dhe është shkruar duke mbajtur parasysh mundësinë e përshatjes së tij në kontekste të ndryshme kombëtare dhe vendore. Drafti i parë i materialeve të modulit u pilotua me mësues në Shqipëri dhe në Greqi dhe kontributet e mësuesve u përfshinë në variantin përfundimtar të modulit.

Ky botim është pikërisht rezultati i kësaj pune. Ai do u shërbejë mësuesve që punojnë në fushën e edukimit për fenë ose të edukimit ndërkulturor dhe synon të rrisë kompetencën ndërkulturore të mësuesve, përmes edukimit ndërkulturor si qasje mbarëshkolllore, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në dimensionin fetar. Moduli lidh çështjen e fesë dhe të botëkuptimeve me kompetencën për kulturë demokratike, të paraqitur në mënyrë të hollesishme në Kuadrin e Referencës së Kompetencave për Kulturë Demokratike të Këshillit të Evropës. Duke përdorur shembujt për fenë, moduli i trajnimit lidh edhe manualin e Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës për Mësimdhënien e çështjeve kundërshtuese (D.Kerr, E.Huddleston,).

Moduli i trajnimit është krijuar për profesionistët e arsimit, për të thelluar njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e tyre për botën e fesë dhe të besimeve jofetare dhe për të zhvilluar kompetencat e nevojshme për të kuptuar identitetin tonë si dhe për të paraqitur atë në mënyrë që nxit dialogun dhe bashkekzistencën. Moduli synon të paraqesë elementet e nevojshme për trajtimin e çështjeve në fjalë në klasë, duke krijuar një mjedis të sigurt të mësuarit, duke respektuar larminë, duke luftuar ksenofobinë dhe radikalizimin dhe duke ndihmuar në qasjen mbarëshkolllore që ndihmon nxënësit të bëhen qytetarë aktivë demokratë në një botë të larmishme.

Ne përgëzojmë autorët e modulit për përpjekjet e tyre, me kënaqësinë e faktit që ky modul tashmë është në dorë të përdoruesve në mbarë Evropën.

Udhëzime

Të nderuar kolegë!

Në vitin 2002, Këshilli i Evropës vendosi të përfshijë dimensionin fetar në edukimin ndërkulturor. Gjashtë vjet më vonë, Komiteti i Ministrave publikoi Rekomandimin CM/Rec(2008)12. Gjashtë vjet të tjera pas këtij dokumenti, u botua Signposts-Udhërrëfyese (hollësi për këtë do të gjeni në parathënien e këtij libri). Botimi që keni në dorë është një hap përpara në këtë drejtim: është shndërrimi i Udhërrëfyese në module trajnimi.

Synimi themelor i këtyre moduleve të trajnimit është të ofrojnë një mënyrë të sigurt të trajtimit të çështjeve që lidhen me fenë dhe botëkuptimet fetare në kuadrin e edukimit ndërkulturor. Këto module janë hartuar për të trajnuar vetë profesionistët e edukimit. Qëllimi i tij është të përdoret më shumë për trajnimin e trajnerëve sesa për mësimdhënie në klasë. Ai synon të ndihmojë profesionistët të thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në lidhje me botën e fesë, për të zhvilluar qëndrime pozitive dhe kompetenca të nevojshme në këtë drejtim. Përmendim këtu reflektimin për identitetin tonë; paraqitjen e feve dhe të botëkuptimeve në mënyrë të tillë që të nxisin dhe zhvillojnë dialogun dhe bashkekzistencën; përgatitjen e mënyrave të ndryshme të trajtimit të çështjeve në fjalë në kontekstin arsimor, duke krijuar një mjedis të sigurt të mësuari, që respekton larinë dhe lufton ksenofobinë dhe radikalizimin. Modulet e trajnimit synojnë krijimin e një qasjeje mbarëshkollore që nxit bashkëpunimin e aktorëve të ndryshëm, ndërkohë që ndihmon nxënësit të bëhen qytetarë demokratë aktiv në një shoqëri të larmishme.

Për të rritur efektshmërinë e përdorimit të moduleve të trajnimit është e nevojshme të përdoren si manuale teorike mbështetëse Udhërrëfyese (Signposts) dhe Rekomandimi CM/Rec(2008)12 të cilëve ai u referohet (Shih Signposts, shtojca 1). Në këtë mënyrë, siç rekomandohet edhe në Udhërrëfyese, në faqen 100, ju mund të përdorni të gjithë dokumentin si një i tërë ose të përqendrohni në kapituj ose në tema të veçanta të tij. Kështu, çdo kapitull i këtij botimi

hapesira ndermjet fjaleve edhe një modul më vete, lidhet me një kapitull të Udhërrëfyese (Signposts), ashtu sikurse dhe veprimtaritë e tij lidhen që në fillim me të njëjtin kapitull.

Çdo kapitull ka dy pjesë. Fillimisht fillohet me një faqe “Pasqyra e fakteve” që përmban mënyrën e qasjes dhe të leximit të kapitullit përkatës të Udhërrëfyese (Signposts). Shih më poshtë për më shumë informacion.

Pasqyra e fakteve

Kjo faqe është strukturuar në mënyrë të tillë që u jep trajnerëve qasjen e duhur për të përdorur kapitujt e Udhërrëfyese (Signposts) në përputhje me kohën dhe nevojat e tyre të trajnimit. Në këtë faqe, kapitujt janë të përmbledhur dhe të strukturuar në bazë të një linje logjike. Kjo do të thotë që mund të ndiqni rendin e kapitujve të Udhërrëfyese (Signposts), por edhe mund ta përshtasni atë për qëllimet e punës suaj.

Çdo “pasqyrë faktesh” përmban:

Çështje kyçe/situata: Këtu mund të gjeni çështjet kryesore që analizohen në kapitullin përkatës të Udhërrëfyese (Signposts). Teksti ofron një pamje të përgjithshme të kapitullit, duke nënvizuar elementet e rëndësishme që mund të përdoren në trajnim.

Kompetencat për kulturën demokratike: Kjo pjesë lidh çdo kapitull të Udhërrëfyese (Signposts) dhe të moduleve të trajnimit me modelin e Kompetencave për Kulturë Demokratike (KKD) të Këshillit të Evropës, duke dhënë edhe mundësinë për të lidhur modulet e trajnimit të Udhërrëfyese me modelin e KKD-së. Duke përdorur referimin ndaj KKD-së, ju mund të pasuroni punën për to përmes përfshirjes së çështjeve që lidhen me botëkuptimet fetare dhe jofetare. Po kështu, ju mund të zgjeroni edhe përdorimin e moduleve të trajnimit të Udhërrëfyese përmes referencave tek KKD-ja.

Çështjet kundërshtuese për t'u marrë në shqyrtim nga mësuesi: Këtu përfshihet një listë me çështjet e "vështira" që shtrohen në çdo kapitull. Këto çështje kundërshtuese lidhen me përvojën e trajtimit të botëkuptimeve fetare dhe jofetare në arsim, duke përfshirë këtu edhe pyetjet e profesionistëve të arsimit.

Çështjet themelore që përfshihen në këtë rubrikë janë katër. Përmbajtja e tyre, nga njëra anë ndihmon trajnerët për të kuptuar frymën e Rekomandimit CM/Rec(2008)12, si ai analizohet në Udhërrëfyesin (Signposts) dhe, nga ana tjetër, lidh trajnerët dhe trajnimin me KKD-në dhe, në mënyrë të veçantë, me punën dhe materialet mësimore të Këshillit të Evropës për çështjet kundërshtuese.

1. **Si ndikon te mua kjo çështje?** Kjo pikë lidh të mësuarit për botëkuptimet fetare dhe jofetare me vetë mësuesin. Ato përmbledhin çështjet që duhet të merren parasysh, si individ, kur shqyrton përmbajtjen e botëkuptimeve fetare dhe jofetare ose me shembuj që përdoren gjatë trajnimit ose mësimit.
2. **Si ndikon kjo në mësimdhënien time?** Kjo pikë trajton çfarë duhet të merret parasysh në procesin e trajnimit ose të mësimdhënies, gjatë trajtimit të botëkuptimeve fetare dhe jofetare të edukimit ndërkulturor.
3. **Çfarë mund të bëj unë si mësues?** Kjo pikë ka të bëjë me propozime praktike që ndihmojnë trajtimin e çështjeve të analizuara në pyetjet e mëparshme. Ato lidhen me nevojat dhe veprimtarinë vetjake dhe profesionale.
4. **Çfarë duhet të zhvilloj?** Ndërsa çështjet e mësipërme lidhen me nevoja të ndërhyrjes së menjëhershme, përmbajtja e kësaj pike lidhet me të ardhmen. Ajo lidhet me zhvillimin afatgjatë profesional për zhvillimin e kompetencave të nevojshme për trajtimin e çështjeve të botëkuptimeve fetare dhe jofetare.

Veprimtaritë

Çdo veprimtari është pikënisje e një procesi që lidhet me një pjesë të Udhërrëfyesit (Signposts). Veprimtaritë për modulet e trajnimit janë vendosur sipas kapitujve të Udhërrëfyesit (Signposts). Kjo zgjidhje është bërë për arsye se ato lidhen me një kapitull të caktuar dhe duhet të përdoren kur trajnimi trajton çështjet e tij. Megjithatë, veprimtaritë mund të përdoren edhe në lidhje me çështje të tjera të larmishme dhe në nivele të ndryshme, si shpjegohet më poshtë.

Siç do ta vini re, veprimtaritë nuk propozojnë detyrimisht afate kohore. Kjo zgjidhje është bërë për arsye se çdo veprimtari është ndërtuar si pjesë e një procesi të mësuarit. Së pari ajo mund të përdoret siç është. Koha

mund të jetë e kufizuar dhe ende duhet kohë për të ndërtuar vetëbesimin. Megjithatë, në praktikë do të shikoni që është e pamundur që të parashikoni në mënyrë absolute rezultatet e veprimtarisë. Me kohë, çdo veprimtari duhet të arrijë në një nivel më të lartë, ku pjesëmarrësit do të mund të përfshihen në diskutime të gjera për të lidhur çështjet e saj dhe përvojat e tyre me mjedisin e tyre arsimor dhe punën e përditshme.

Të gjitha veprimtaritë pasurohen nga një përmbledhje e gjatë dhe e pasur. Aty, pjesëmarrësit, përmes diskutimit, mund të vendosin cilat çështje janë më shumë ose më pak të vështira për t'u trajtuar, cilat kanë nevojë për analiza të mëtejshme, si mund të fillojmë të vëmë në praktikë atë që kemi mësuar e kështu me radhë. Pjesëmarrësit kanë nevojë për një hapësirë të sigurtë për t'u shprehur dhe për të diskutuar çështjet që ata vetë kanë ngritur për veprimtaritë, për Udhërrëfyesin (Signposts), për Rekomandimin CM/Rec (2008)12. Këto pyetje janë burime për të kaluar në nivele të ndryshme. Në çdo rast, nëse këto çështje kanë mbetur jashtë veprimtarive ose nuk mbulojnë si duhet prej tyre, është detyrë e trajnerit t'i përfshijë ato në diskutim.

Në përgjithësi, veprimtaritë janë të hapura nga pikëpamja kohore. Ato mund të zbatohen siç janë ose në mënyrë të zgjeruar: gjatë një sesiioni ose në sesione online, ballë për ballë; ato mund të zbatohen të kombinuara me kërkime, me lojë me role etj.

Është e rëndësishme që, në çdo hap, veprimtaritë të lidhen me tekstin e Udhërrëfyesit (Signposts) dhe, përmes tij, me Rekomandimin CM/Rec (2008)12. Në fund të fundit, veprimtaritë janë hartuar për të mundësuar një studim më të thelluar të Udhërrëfyesit (Signposts) dhe për një të kuptuar më të mirë të tij. Tekstet e Udhërrëfyesit (Signposts) shërbejnë edhe si burim i drejtpërdrejtë për veprimtaritë.

Bazat themelore të Udhërrëfyesit (Signposts), të Rekomandimit CM/Rec (2008)12 dhe të moduleve të trajnimit të Udhërrëfyesit janë shqetësimi për të drejtat e njeriut dhe për demokracinë. Ky është filli që lidh të mësuarit e botëkuptimeve fetare dhe jofetare me metodologjinë e mësimdhënies dhe me nevojat e trajnimit të mësuesve.

Lidhur me këto të fundit, shënimet e mëposhtme tregojnë si disa lloje të veprimtarive mund të përdoren në kohë të ndryshme, në mënyra të ndryshme edhe në lidhje me çështje të ndryshme, përtej atyre që ndodhen në një kapitull të veçantë.

Hartat mendore

(kapitulli 1, veprimtaria 1; kapitulli 6, veprimtaria 2)

Harta mendore ka shumë zbatime. Ajo mund të përdoret, për shembull, për të analizuar pjesë të Udhërrëfyesit (Signposts), zhvillimin e njohurive

dhe të përvojave të pjesëmarrësve ose të situatave të paraqitura në media. Hartat mendore mund të ndërtohen gjatë një periudhe kohore: në një sesion të vetëm, gradualisht, gjatë disa javëve ose ato mund të shoqërojnë një proces trajnimi gjatë një viti shkollor. Procesi mund të vijojë në përputhje me një plan trajnimi, me kohën në dispozicion dhe me nevojat e të trajnuarve, por gjithmonë duke lënë hapësirën e nevojshme për shtesa ose ndryshime.

Të shkruarit e një letre

(kapitulli 1, veprimtaria 2; kapitulli 5, veprimtaria 1; kapitulli 7, veprimtaria 1; kapitulli 9, veprimtaria 1 dhe 2)

Të shkruarit e një letre është një teknikë që mund të përdoret në mënyra të ndryshme. Ajo mund të përdoret si mjet për të thelluar dhe përmirësuar të kuptuarit e koncepteve në një tekst, por edhe për të rritur vetëdijen për larinë e pikëpamjeve. Rolet dhe pikëpamjet e dhënësit dhe të marrësit duhet të merren parasysh dhe të respektohen. Mundësitë e përdorimit në mjedise dhe raste të ndryshme janë disa. Çështjet bazë që mund të merren parasysh në hartimin e një letre janë disa: cilat pika ose argumente duhet të përfshihen në të? Si duhet të zgjidhen dhe të përshtatet gjuha, shprehjet dhe terminologjia? Si duhet të fillojë dhe të mbyllet një letër? Si shprehen njohuritë dhe respekti për larinë? Diskutimet duhet të vazhdojnë derisa të arrihet një marrëveshje për draftin e parë të letrës (draftimi i një letre është një veprimtari grupi shumë e efektshme). Kështu, mund të lindin pyetje të tjera. Do të ishte mirë që një letër të rishikohej disa herë, në përpjekje për të marrë parasysh qëndrimin dhe reagimin e mundshëm të marrësve.

Përdorimi i elementeve fetare

(kapitulli 2, veprimtaria 1)

Përdorimi i elementeve konkrete ose abstrakte të një feje, në këtë rast figurat, por edhe pamjet e qeta ose në lëvizje të vendeve, të ndërtesave, të skenave, të artikujve, të simboleve, të ritualeve, të objekteve etj., ofrojnë mundësinë për t'u marrë me njohuritë, perceptimet dhe të kuptuarit e kësaj feje nga pikëpamja dhe përvoja si e atyre që janë brenda, ashtu edhe e atyre që janë jashtë saj. Një pikë që mungon shpesh është të kuptuarit dhe respektimi i kuptimit dhe vlera që ajo ka për vetë besimtarët. Pa këtë, paragjykimet, stereotipat dhe radikalizimi do të mbeten të pasfiduar.

Përzgjedhja e materialeve të përshatshme mësimore kërkon përdorimin e kriterëve të qarta. Materialet duhet të lidhen me realitetin e një botëkuptimi fetar ose jofetar, ashtu si ato shihen nga një

këndvështrim i një të brendshmi. Duke ofruar kohën e nevojshme për këtë proces në trajnimin e mësuesve,

ofrohen edhe shanse për shkëmbimin e njohurive dhe për kërkime të mëtejshme.

Trajnerët duhet të shqyrtojnë çështjen e nivelit të njohurive që pjesëmarrësit duhet të zotërojnë, si kusht i domosdoshëm për mësimdhënien e një feje ose të një botëkuptimi. Trajneri duhet të ketë besim në rezultatet e pritshme të të mësuarit dhe të jetë i vetëdijshëm për nivelin e njohurive dhe të nevojave të pjesëmarrësve.

Analiza e situatave

(kapitulli 2, veprimtaria 2, kapitulli 6, veprimtaria 1, kapitulli 8, veprimtaria 2)

Të parandalosh problemet është më mirë se të kundërpërgjigjesh ndaj tyre. Në çdo rast, një analizë e situatës është teknikë e mirë si për parandalimin ashtu edhe për qëndrimin ndaj problemit. Për të rikrijuar një situatë që ka nevojë të analizohet mund të përdoren burime të ndryshme: një ngjarje, një foto, një pjesë muzikore ose teksti, një citim ose një kombinim i të gjithave. Në këto module trajnimi, situatat janë ndërtuar ose janë marrë nga burime të ndryshme të shkruara, nga interneti ose nga media. Ato mund të paraqiten të gjitha menjëherë ose hap pas hapi. Këtu, ju do të gjeni teknika të ndryshme për të punuar me analizën e situatës.

Është mirë që të përdoren situata që mund të lidhen me çështjet me të cilat ndeshen pjesëmarrësit, por pa iu referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë rasteve ose personave që janë të lidhur ngushtë me to. Procesi i të mësuarit synon të zhvillojë argumente të diferencuara dhe njohuri dhe jo të ftojë zgjidhje të njëanshme të problemeve. Lidhja e një analize të tillë me teknikat e hartës mendore ofron mundësi për thellime dhe zgjerime të mëtejshme.

Fillimi nga një fe e veçantë

(kapitulli 3)

Një veprimtari për "të kuptuarit fetar" mund të përdoret si pikënisje për "të kuptuarit e fesë". Në këtë model, mund të fillohet nga terminologjia dhe përmbajtja e një feje të veçantë dhe të kalosh në testimin e nivelit dhe të kriterëve që formojnë procesin e "të kuptuarit të fesë". Përdorimi i kësaj teknike me shembuj të feve të ndryshme e lehtëson respektimin e larmisë fetare si nga pikëpamja e besimtarëve, ashtu edhe nga pikëpamja e atyre që qëndrojnë jashtë saj. Për më tepër, kjo lloj veprimtarie, kur përdoret në mjedise të ndryshme arsimore, mund të ndihmojë në kuptimin e qëllimeve kryesore dhe të larmisë së modeleve të ndryshme të edukimit fetar dhe në kuptimin e parakushteve bazë për të kuptuarit e fesë në kontekstin e edukimit ndërkulturor.

Puna me terminologjinë

(kapitulli 3)

Veprimtaritë në këtë kapitull ndihmojnë në rritjen e vetëdijes për kuptimet e ndryshme që terma të njëjtë marrin në mjedise të ndryshme. Përmes këtyre veprimtarive rritet vetëdijja për kujdesin që duhet treguar në përdorimin e terminologjisë. Për trajnerët është e rëndësishme të jenë të sigurt që pjesëmarrësit janë të vetëdijshëm për problemin dhe për rëndësinë e përdorimit të kuptimeve të njëjta për të njëjtët terma.

Pavarësisht nga koha që kërkon, është e rëndësishme të grumbullohet përvoja e pjesëmarrësve për këtë çështje dhe të bazohet puna trajnuese në të. Çështjet e jetës së përditshme duhet të trajtohen si pjesa më e rëndësishme e trajnimit të tyre. Sa më pranë realitetit të jenë pjesëmarrësit, aq më mirë është. Qartësimi i terminologjisë që do të përdoret në veprimtaritë mund të jetë një detyrë përpara trajnimit ose një proces që ndodh gjatë kryerjes së tij.

Puna me qasje të ndryshme didaktike

(kapitulli 2, veprimtaritë 1 dhe 2; kapitulli 4, veprimtaria 1; kapitulli 5, veprimtaria 3; kapitulli 7, veprimtaria 2; kapitulli 8, veprimtaria 1 dhe 2; kapitulli 9, veprimtaria 1)

Udhërrëfytyesi (Signposts) paraqet dy qasje didaktike: atë interpretuese dhe dialoguese. Në këto module trajnimi shpjegohen të dyja. Në kapitullin 4, përmes një teksti, përdoret qasja hap pas hapi. Në veprimtari të tjera përdoren foto, objekte ose muzikë. Të kuptuarit e qasjes interpretuese dhe dialoguese e lehtëson përdorimin e teknikave të përshtatshme të të mësuarit dhe mundëson përdorimin e tyre për çështje dhe nivele të ndryshme.

Në veprimtarië 1 të kapitullit 4, nxënësit, pas leximit të tekstit, e nënvizojnë atë duke përdorur kriteret e qasjes interpretuese. Këto parime janë pikënisje për vlerësim, duke trajtuar edhe me mënyrën e përdorimit në praktikë të këtyre parimeve. Më poshtë vijojnë disa komente për mënyrën e përdorimit të proceseve të ngjashme në raste të ndryshme.

Shembuj të ndryshëm të punës me qasjen interpretuese gjenden në kapitullin 2 (përdorimi i fotove), dhe në kapitullin 8 (puna me të drejtat dhe përgjegjësitë), duke nënvizuar edhe mënyrat e ndryshme të përdorimit të kësaj qasjeje didaktike.

Shembuj të qasjes dialektike janë përdorur për një lojë me role në kapituj të ndryshëm: një ngjarje

(kapitulli 4), një këngë (kapitulli 7), një tekst nga Udhërrëfytyesi ose nenet e të drejtave të njeriut (kapitulli 8), duhet hequr presja dhe një studim rasti (kapitulli 9). Diskutimet që pasojnë gjatë kohës që nxënësit janë ende në rolet e tyre përfshijnë argumentet e tyre, rrugën që ata ndjekin për vendimet e tyre si dhe negociimet që i çojnë në zgjedhjet e bëra.

Përmbledhja mund të ofrojë materiale dhe argumente për mënyrën dhe vendin ku mund të përdoren qasje të tilla didaktike, për nevojat arsimore dhe për nivelin e nxënësve. Të dyja qasjet janë të vlefshme për trajtimin e botëkuptimeve fetare dhe jofetare në mjedisin e sigurt për të cilin ka nevojë edukimi ndërkulturor.

Krijimi i mjedisit të sigurt duke përdorur rregullat dhe teknikat e diskutimit

(kapitulli 5, veprimtaria 2; kapitulli 9, veprimtaria 2)

Rregullat për diskutim duhet të jenë të duhurat: mbrojtja e krijimit të një hapësire të sigurt të mësuarit, krijimi i më shumë shanseve për trajnerët dhe mësuesit për të përfshirë diskutimin e çështjeve kundërshtuese dhe zgjerimi i mësimdhënies për botëkuptimet fetare dhe jofetare, nxitja e krijueshmërisë dhe pjesëmarrjes. Rregullat duhet të jenë të qarta, të respektojnë opinionet e ndryshme dhe të synojnë përmbushjen e nevojave arsimore.

Në këtë mënyrë, marrëveshja për rregullat është në vetvete një proces të mësuarit. Krijimi i një hapësire të sigurt përfshin diskutimin tërësor për rregullat bazë të nevojshme që anëtarët e komunitetit të të mësuarit të ndihen njëllorj të barabartë dhe të respektuar.

Në këto module trajnimi, ilustrohen teknika të ndryshme diskutimi, që përfshijnë ndryshimin e radhës së drejtuesit (kapitulli 1); përdorimin e pyetjeve (kapitulli 3, 5 dhe 6); përdorimi i kartave me deklarata (kapitulli 4); përdorimi i listës së konfirmimit (kapitulli 5); përdorimi i opinionëve dhe shënimeve personale (kapitulli 5); analiza e pohimeve pozitive dhe negative (kapitulli 9).

Unë shpresoj që ju t'i vlerësoni këto module si ndihmë praktike në përgatitjen e pjesëmarrësve për të përmbushur rolin e tyre si mësimdhënës në shoqëritë e larmishme nga pikëpamja fetare dhe kulturore të Evropës.


Angelos Vallianatos

Drejtuesi i grupit të autorëve

Kapitulli 1


Rekomandimet: sfondi, çështje, sfida

Çështje kyçe/situata



- ▶ Përpara vitit 2002, Këshilli i Evropës nuk kishte projekte arsimore që përqendroheshin në botëkuptimet fetare dhe jofetare. Megjithatë, vetëdija për rëndësinë publike të feve është në rritje. Që nga viti 2002, Këshilli i Evropës gjithnjë e më shumë ka pranuar rëndësinë e dimensionit fetar dhe jofetar në edukimin ndërkulturor.
- ▶ Të gjitha shtetet janë të larmishme nga pikëpamja kulturore dhe fetare, pavarësisht se qasjet e tyre ndaj vendit të fesë në arsim mund të jenë të ndryshme.
- ▶ Në qasjen e Këshillit të Evropës, edukimi në lidhje me bindjet fetare dhe jofetare lidhet ngushtë me edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut. Forma e edukimit që mbrohet është e ndryshme nga ushqimi fetar.
- ▶ Qëndrimet dhe kompetencat janë pjesë e këtij edukimi: sfidat ndaj racizmit dhe intolerancës, nxitja e tolerancës. Për këtë qëllim duhet të zhvillohen kërkimet, edukimi i mësuesve dhe burimet.

Kompetencat për kulturë demokratike



- ▶ Të qenit i hapur ndaj tjetres kulturore.
- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore.
- ▶ Njohuri dhe të kuptuarit kritik të botëkuptimeve fetare dhe jofetare.

Çështjet kundërshtuese për t'u marrë në shqyrtim nga mësuesi



- ▶ A duhet edukimi për botëkuptimet fetare dhe jofetare të ushqejë përkushtimin fetar apo duhet të jetë i hapur dhe kritik?
- ▶ Disa njerëz e lidhin fenë me ekstremizmin; si duhet ta menaxhojnë mësuesit këtë lidhje?
- ▶ A është feja çështje private apo publike?

Si ndikon tek mua kjo çështje?



- ▶ Unë duhet të vlerësoj qëndrimin tim ndaj pluralizmit kulturor, pluralizmit fetar dhe gatishmërisë sime për mësimdhënie.
- ▶ Unë duhet të pranoj përgjegjësinë për të trajtuar pozitivisht pluralizmin kulturor dhe pluralizmin fetar dhe të jem i gatshëm për të mbrojtur vlerat demokratike dhe të drejtat e njeriut.

Si ndikon kjo në mësimdhënien time?



- ▶ Të drejtat e njeriut dhe demokracia duhet të jenë në themel të metodologjisë sime.
- ▶ Në klasën time, fetë e ndryshme dhe traditat jofetare duhet të paraqiten dhe të diskutohen ndershmërisht, pa paragjykime dhe në mënyrën e pranueshme nga anëtarët e saj.
- ▶ Të rinjve në klasën time duhet t'u mundësohet shkëmbimi dhe eksplorimi i ideve të tyre në një klimë të sigurt të respektit të ndërsjellë.

Çfarë mund të bëj unë si mësues?



- ▶ T'i përkushtohem mësimdhënies që mbështet këto vlera.
- ▶ Të ndërtoj shembuj të mirë për nxënësit, kolegët dhe publikun.
- ▶ Të nxis dhe të mbështes edukimin dhe dialogun ndërkulturor, duke përfshirë edhe dimensionet e tyre fetare dhe jofetare.

Çfarë duhet të zhvilloj?



- ▶ Vetëdijen e rëndësishme publike të fesë, në nivel lokal, kombëtar dhe global.
- ▶ Gatishmërinë për të sfiduar racizmin, paragjykimin fetar, diskriminimin dhe intolerancën.
- ▶ Të kuptuarit e pluralizmit fetar dhe natyrën e fesë dhe të feve.

VEPRIMTARIA 1 – ANALIZA E KONTEKSTIT TUAJ

Fokus

Fokusi i kësaj veprimtarie janë njohuritë dhe të kuptuarit e larmisë kulturore dhe fetare në kontekstin vendor dhe kombëtar të pjesëmarrësve. Veprimtaria përfshirë ndërtimin e një grupi shënimesh ose të një harte mendore për mënyrën se si përjetohet larmia kulturore dhe fetare në vendin e pjesëmarrësit dhe, nëse është e mundur, rajonin ose komunitetin e tij.

Këshilla

Siç do të shihni më poshtë, veprimtaria mund të fillojë gjatë një sesioni në universitet ose shkollë, por do të duhet të shtrihet përtej saj: p.sh. pjesëmarrësve mund t'u duhet të kryejnë disa kërkime në bibliotekë ose në internet dhe të bisedojnë me stafin në shkollën e tyre për këtë qëllim. Hollësitë për shënimet ose për hartën mendore do të zhvillohen në mënyrë graduale, ndoshta gjatë një periudhe disa javore dhe juve do t'ju duhet të planifikoni mundësinë e shkëmbimit të informacionit ndërmjet pjesëmarrësve për gjetjet e tyre në një kohë të ardhme.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit për shumicat dhe pakicat kulturore dhe fetare të pranishme në vendin dhe rajonin e tyre;
- ▶ do të zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit e modeleve kryesore të migracionit brenda dhe jashtë vendit dhe rajonit të tyre;
- ▶ do të vlerësojnë çështje të tilla si: Si ndikojnë faktorët e mësipërm në jetën e shkollës dhe të komunitetit të saj? Si ndikojnë në procesin e mësimdhënies? Cilat janë politikat aktuale të shkollës për trajtimin e këtyre faktorëve : sa shpesh rishikohen ata për t'u përditësuar ose për t'u fuqizuar më tej?

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Të qenit i hapur ndaj tjetrës kulturore.
- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit e botëkuptimeve fetare dhe jofetare.

Procedura/hapat

1. Trajneri u paraqet pjesëmarrësve detyrën, duke u dhënë atyre kopje të materialit të mëposhtëm. Atyre u kërkohet të ndërtojnë një listë shënimesh ose një hartë mendore për mënyrën e përjetimit të larmisë kulturore dhe fetare në vendin e tyre dhe, nëse është e përshtatshme, edhe në nivel rajonal ose vendor. Ata duhet t'u përgjigjen pyetjeve të tilla si:
 - ▶ Cilat janë shumicat dhe pakicat kulturore dhe fetare të pranishme në vendin ose në rajonin tuaj?
 - ▶ Cilat kanë qenë modelet kryesore të migracionit brenda dhe jashtë vendit ose rajonit tuaj?
 - ▶ Si kanë ndikuar këta faktorë në jetën e shkollës dhe të komunitetit të saj? Cilat janë politikat aktuale të shkollës për trajtimin e faktorëve të tillë?; sa shpesh rishikohen ato për t'u përditësuar dhe a kanë ato nevojë të përditësohen ose të fuqizohen më tej?
2. Pjesëmarrësve u kërkohet të formojnë çifte ose grupe të vogla dhe të ndajnë me njëri-tjetrin njohuritë ekzistuese për këto çështje.

35 minuta

3. Trajneri u kërkon çifteve dhe grupeve të vogla të ndajnë njohuritë e tyre me të gjithë klasën, përpara se t'u ofrojë atyre udhëzimet e tjera vijuese.

15 minuta

Përmbledhja dhe vijimësia

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të vijojnë këtë veprimtari fillestare duke kryer disa kërkime në internet ose në bibliotekë. Pjesëmarrësit mund të kenë nevojë të flasim me mësuesit dhe drejtuesit në shkollë për praktikën e mësimdhënies në shkollë. Në këto mënyra, hollësitë e shënimeve ose të hartës mendore mund të pasurohen në mënyrë graduale.

Trajneri duhet të vendosë së bashku me pjesëmarrësit për një veprimtari raportimi në javët e ardhshme.


5 minuta

Fletë pune

— *“Larmia kulturore dhe fetare përjetohen në çdo vend. Asnjë shtet nuk është homogjen nga pikëpamja kulturore. Disa vende kanë pakica të konsoliduara etnike dhe fetare, shpeshherë me histori të gjata, të cilat në disa raste i kanë paraprirë formimit të shtetit. Shumë shtete i kanë pakicat e tyre si rrjedhojë e migrimit nga vende të tjera brenda Evropës dhe më tej, kryesisht gjatë shekullit XX dhe shekullit në të cilin jetojmë. Larmia brenda shteteve është komplekse dhe lidhet me çështjet globale si dhe me ato kombëtare dhe vendore. Të gjithë këta faktorë shoqërohen me një pikëpamje në rritje se feja dhe besimet nuk janë çështje tërësisht private dhe, për këtë arsye, duhet të jenë pjesë e diskutimit dhe e dialogut brenda sferës publike”.*

Udhërrësyeni faqe 14-15

— Ndërtoni një listë shënimesh ose një hartë mendore për mënyrën se si përjetohet larmia kulturore dhe fetare në vendin tuaj dhe, nëse është e përshtatshme, edhe në nivel rajonal ose vendor. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

| | |
|---|--|
|  | ▶ Cilat janë shumicat dhe pakicat kulturore dhe fetare të pranishme në vendin ose në rajonin tuaj? |
| | ▶ Cilat kanë qenë modelet kryesore të migracionit brenda dhe jashtë vendit ose rajonit tuaj? |
| | ▶ Si kanë ndikuar këta faktorë në jetën e shkollës dhe të komunitetit të saj? Cilat janë politikat aktuale të shkollës për trajtimin e faktorëve të tillë? Sa shpesh rishikohen ato për t'u përditësuar dhe a kanë ato nevojë të përditësohen ose të fuqizohen më tej? |

VEPRIMTARIA 2 – SKENARI: QARTËSIMI I VLERAVE VETJAKE DHE GATISHMËRIA PËR TË SFIDUAR PRAGJYKIMET

Fokus

Kjo veprimtari fokusohet në sfidën ndaj paragjykit. Pjesëmarrësve u kërkohet të përfytyrojnë që një grup prindërisht i kanë shkruar një letër shkollës së tyre, me anë të së cilës i kërkojnë që fëmijët e tyre të mos ndjekin mësimet për fenë islame, sepse, sipas tyre, Islami është një "fe terroriste". Pjesëmarrësit duhet të formulojnë një përgjigje që komunikon vlerat pozitive të shkollës.

Këshilla

Nuk ka asnjë dyshim se këto çështje janë të komplikuar dhe të vështira, por pjesëmarrësit duhet të sigurohen që ata duhet të komunikojnë shumë qartë idenë e tyre. Trajneri u kërkon atyre të hartojnë draftin disa herë, duke u pëpjekur të vënë veten në vendin e prindërve të shqetësuar sa herë që lexojnë draftin e shkruar prej tyre.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të identifikojnë vlerat e tyre në lidhje me paragjykimet fetare;
- ▶ do të zhvillojnë aftësitë dhe vetëbesimin për të komunikuar vlerat pozitive dhe për të sfiduar paragjykimin.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Të qenit i hapur ndaj tjetrës kulturore.
- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit e botëkuptimeve fetare dhe jofetare.

Procedura/hapat

1. Trajneri u jep pjesëmarrësve kopje të materialit të mëposhtëm. Ai bisedon me ta përmes detyrës së të shkruarit të letrës, duke marrë parasysh dhe duke diskutuar çdo pyetje që ata mund të ngrenë.

15 minuta

2. Trajneri kërkon nga pjesëmarrësit të zgjedhin një person të shkruajë letrën, gjatë kohës që ndjek ecurinë e diskutimit të të gjithë grupit dhe një person tjetër të drejtojë diskutimet. Ai u jep detyrën si më poshtë:

- ▶ Diskutoni cila nga pikat e dhëna në material duhet të përfshihet në letër? A është patjetër e nevojshme të ndryshohet gjuha? Si duhet të fillojë dhe të përfundojë letra? A ka ndonjë pikë që nuk është dhënë në material që duhet të përfshihet në letër? Diskutimet duhet pjezeza "te" e lidhore- duhet të vazhdojnë deri sa grupi të ketë hartuar draftin e parë të letrës.

45 minuta

Përmbledhja dhe vijimësia

Letra mund të lexohet me zë të lartë nga shkruesi i saj. Anëtarët e grupit mund të vënë veten në rolin e prindërve, ndoshta të prindërve me prejardhje ose komunitete të ndryshme dhe të përpiqen të përfytyrojnë si mund të ndihen ose të përgjigjen prindërit pasi të lexojnë këtë letër. Një kundërpërgjigje e mundshme e prindërve mund të shërbejë për të rishkruar letrën, deri sa grupi të arrijë në përfundimin besimplotë se letra e tyre komunikon qartë dhe në mënyrë të efektshme vlerat e shkollës. Në këtë mënyrë, qëllimi është të sigurohen të gjithë prindërit për qëllimet më të mira të shkollës dhe, në të njëjtën kohë, të sfidohen paragjykimet e shprehura nga një pjesë e tyre.

15 minuta

Fletë pune

— Një grup prindërisht ju ka shkruar një letër me anë të së cilës kërkojnë që fëmijët e tyre të mos ndjekin mësimet për fenë islame, sepse, sipas tyre, Islami është një "fe terroriste".

— Përgjigja juaj synon të ftoni prindërit të vijnë në shkollën tuaj për të diskutuar për këtë çështje, por ju mendoni se është më mirë t'u shkruani atyre fillimisht një letër zyrtare, me anë të cilës t'u shpjegoni atyre qartë dhe tërësisht, qëndrimin e shkollës për çështjen në fjalë. Mos harroni, shkolla duhet të ketë një përgjigje të pranuar dhe koherente ndaj vërejtjeve të tilla dhe që i gjithë stafi i shkollës duhet të kuptojë dhe të zbatojë atë në të njëjtën mënyrë. Për këtë arsye, letra duhet të formulohet nga i gjithë grupi, nga të gjithë kolegët, nëse ndodheni në të njëjtën shkollë me ta, me pedagogët ose me të trajnuar të tjerë, nëse ndodheni në një universitet. Po kështu, bëni kujdes që përgjigja juaj duhet të bazohet në shqetësimet për të drejtat e njeriut dhe demokracinë.

— **Pikat e mëposhtme mund të jenë të dobishme për t'i diskutuar dhe shqyrtuar me radhë gjatë kohës që hartoni draftin e letrës:**




- ▶ Shkolla nuk e pranon lidhjen ndërmjet Islamit dhe terrorizmit. Pjesa më e madhe e myslimanëve janë paqësore dhe zbatues të ligjit.
- ▶ Në të njëjtën kohë, një arsim i përgjegjshëm nuk mund të shpërfillojë faktin që disa grupe ekstremiste pretendojnë që Islami është baza e veprimeve të tyre. Kjo të çon në ndërlikime dhe kontradikta, të cilat ju dëshironi t'i bëni objekt diskutimi me nxënësit e shkollës në hapësirën e sigurt të klasës suaj.
- ▶ Komuniteti i shkollës përshin familje myslimane. Fëmijët myslimanë kanë të drejtën të shprehin besimet e tyre në klasë.
- ▶ Një ndër qëllimet themelore të përfshirjes së edukimit për islamin në kurrikulën e shkollës është shembulli pozitiv njerëzor që ai ofron: kërkimi për kuptimin e jetës, duke treguar respekt për jetën njerëzore, solidaritetin me të varfërit dhe për vlera të tjera qëndrore islamike.
- ▶ Një tjetër qëllim i përfshirjes së edukimit për Islamin është të nxisë dhe të mbështesë mirëkuptimin dhe marrëdhëniet e mira ndërmjet të rinjve brenda shkollës dhe më tej në shoqëri. Në këtë kuadër, të gjithë të rinjtë kanë të drejtën t'i përgjigjen përmbajtjes dhe të shprehin opinionin e tyre, me ndjeshmëri dhe respekt. Në asnjë rast, feja dhe fetë nuk mësohen për të nxitur devocionin fetar dhe fetë ndër nxënësit e shkollës.
- ▶ Në çdo rast, asnjë nxënës nuk do të lejohet të mbrojë ekstremizmin ose dhunën, e çdo lloji qoftë ajo, në shkollë. Të gjithë nxënësit kanë të drejtë të mbrohen nga ekstremizmi ose gjuha dhe veprimet e dhunës dhe, nëse është e nevojshme, shkolla do të përfshijë organet e policisë për këtë qëllim.

— Sigurisht që mund të ketë edhe pika të tjera që do të dëshironit t'i diskutoni dhe t'i përfshini. Pa dyshim, këto çështje janë të koklavitura dhe të vështira, por e rëndësishme është që ju të komunikoni qartë atë që dëshironi. Për këtë arsye, ia vlen që letra të shkruhet disa herë, duke u përpjekur vazhdimisht ta vendosni veten në vendin e prindit të shqetësuar, sa herë që lexoni draftet e shkruara.

Kapitulli 2


Udhërrëfyti dhe çështjet e tij kryesore

Çështje kyçe/situata




- ▶ Rekomandimi është i përshtatshëm për të gjithë kulturën e shkollës dhe jo vetëm për lëndët kurrikulare.
- ▶ Qëllimi i paraqitjes së botëkuptimeve fetare dhe jofetare si degë e edukimit ndërkulturor është të nxisë dhe të mbështesë të kuptuarit e gjuhës dhe të praktikës së bartësve të tyre.
- ▶ Është e nevojshme të kuptohet gjuha fetare, në mënyrën si përdoret nga besimtarët, duke përfshirë këtu edhe shprehjet e besimeve, vlerave dhe emocioneve të tyre, si dhe historinë e feve, të praktikave të tyre, të veprave të artit dhe të ndërtesave.
- ▶ “Të kuptuarit fetar” zakonisht nënkupton ushqimin dhe udhëzimet fetare. Të kuptuarit e feve nënkupton zhvillimin e të kuptuarit të larmisë së botëkuptimeve fetare dhe jofetare.
- ▶ Rekomandimi përfshin edhe të kuptuarit e bindjeve jo fetare – Kapitulli 7 trajton në mënyrë të veçantë çështjet e integritit të studimit të bindjeve jo fetare dhe ato fetare.

Kompetencat për kulturë demokratike



- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore
- ▶ Të qenit i hapur ndaj tjetrës kulturore dhe besimeve të tjera janë me mire pa pike në fund.
- ▶ Toleranca ndaj paqartësisë.
- ▶ Aftësitë e të mësuarit të pavarur.
- ▶ Aftësitë e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit
- ▶ Empatia
- ▶ Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria.
- ▶ Aftësitë për të bashkëpunuar.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të vetes dhe të botës (kultura, kulturat, historia dhe qëndrueshmëria).

Çështjet kundërshtuese për t'u marrë në shqyrtim nga mësuesi



- ▶ Mësimdhënia për botëkuptimet fetare dhe jofetare në kuadrin e edukimit ndërkulturor dallon nga fillimi ose përkushtimi ndaj një këndvështrimi të veçantë fetar.
- ▶ Zhvillimi i të kuptuarit të një qëndrimi të ndryshëm fetar mund të çojë në ngritjen e një sërë çështjesh fetare ose teologjike. Pra, mund të zhvillojë të kuptuarit fetar.
- ▶ Cila është marrëdhënia ndërmjet edukimit për fenë, i parë si mjet i thellimit të të kuptuarit të fesë dhe të feve nga të rinjtë dhe të kuptuarit fetar si fillimi i hyrjes së të rinjve në mënyrën e jetesës së një feje të veçantë?
- ▶ Si duhet të përkufizojmë, të integrojmë ose të trajtojmë bindjet jofetare krahas atyre fetare?
- ▶ Cilat janë parimet e duhura për përzgjedhjen e njohurive? Cila duhet të jetë barazpesha e materialeve të përzgjedhura për studim, në lidhje me kontekstin e veçantë të studiuësit dhe me moshën dhe aftësitë e nxënësve?



Si ndikon tek mua kjo çështje?




- ▶ Unë duhet të jem i qartë për qëllimet e ndryshme të ushqimit të këndvështrimit të një feje të veçantë dhe mësimdhënies për fetë dhe të pranoj parimet e edukimit ndërkulturor.
- ▶ Unë duhet të zhvilloj të kuptuarit e qëndrimeve të ndryshme fetare dhe të fitoj njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e duhura për të paraqitur fetë dhe çështjet teologjike përkatëse.
- ▶ Unë duhet të kuptoj çështjet që përfshihen në trajtimin e bindjeve jofetare krahas atyre fetare.

Si ndikon kjo në mësimdhënien time?



- ▶ Unë duhet të aftësoj nxënësit të kuptojnë gjuhën, besimet dhe pretendimet e atyre që bartin qëndrime fetare dhe jofetare në shoqëri.
- ▶ Unë duhet të përdor metoda që aftësojnë nxënësit të kuptojnë gjuhën e fesë nga këndvështrimi i besimtarit, por dhe të zhvilloj vetëdijen për konceptet dhe vlerat e tyre.
- ▶ Unë duhet të fuqizoj dhe të zhvilloj kompetencën e të nxënit për të kuptuar këndvështrimet fetare dhe jofetare të njerëzve të tjerë.

Çfarë mund të bëj unë si mësues?



- ▶ Unë mund të lehtësoj ndeshjen dhe ndërveprimin me besimtarët fetarë dhe tekstet , historitë, praktikat, doktrinat e tyre.
- ▶ Unë mund të përdor metodat që u japin mundësi nxënësve të investigojnë botën e fesë, pavarësisht zgjedhjeve fetare ose jofetare.

Çfarë duhet të zhvilloj?



- ▶ Imagjinatën dhe empatinë për të aftësuar nxënësit të kuptojnë gjuhën fetare nga këndvështrimi i një besimtari.
- ▶ Njohuri, por edhe aftësi e qëndrime që rrisin vetëdijen dhe të kuptuarit e besimeve dhe vlerave të tjerëve, si dhe të vlerat që pohojnë dinjitetin njerëzor.
- ▶ Njohuri dhe të kuptuarit e bindjeve fetare dhe jofetare, të cilat janë të ndryshme nga të miat.

VEPRIMTARIA 1 – DIMENSIONET E MËSIMDHËNIES SË KONCEPTVE FETARE DHE JOFETARE

Fokus

Fokusi i kësaj veprimtarie është të zbulojë njohuritë personale edhe aftësitë që nevojiten kur feja trajtohet si një dukuri kulturore, pa e portretizuar atë vetëm si një shprehje kulturore ose pa e reduktuar në kulturën njerëzore. Së fundi, kjo veprimtari përqipet të shqytojë kufijtë e të kuptuarit të thelbit të besimeve, të vlerave, të emocioneve dhe të gjuhës fetare nga këndvështrimi i besimtarit.

Këshilla

Veprimtaria mund të zhvillohet në disa nivele, në varësi të kohës në dispozicion dhe të njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me fe të ndryshme. Ajo përdor silueta që përfaqësojnë lutës në fe të ndryshme. Trajneri mund të përdorë të gjitha figurat, për të përmendur disa nga fetë, të përzgjedhë figurat nga një ose më shumë fe ose të kërkojë informacion për lutjet në fe të ndryshme. Figurat mund të përdoren në dy mënyra: si një fletë e vetme, ku trajneri mund të përshtasë pozicionin e tyre ose si karta të veçanta për t'u përdorur sipas mundësisë.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të gjejnë, do të organizojnë dhe do të zhvillojnë të dhëna të përshtatshme (të lidhura p.sh. me historinë, me tekstet, artet, praktikat dhe kulturën e feve) për të punuar për aftësitë ndërfaqetare;
- ▶ do të kuptojnë, do të analizojnë dhe do të vlerësojnë metodat arsimore dhe strategjitë e mësimdhënies të nevojshme për të trajtuar aspektet personale dhe ato të mësimdhënies së feve;
- ▶ do të zhvillojnë empatinë dhe do të shqyrtojnë kufijtë e empatisë në të kuptuarit.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Të qenit i hapur ndaj tjetrës kulturore dhe besimeve të të tjerëve, të botëkuptimeve dhe praktikave.
- ▶ Toleranca ndaj paqartësisë.
- ▶ Empatia
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të vetes dhe të botës (kultura, kulturat).

Procedura/hapat

1. Trajneri i ndan pjesëmarrësit në grupe me katër ose pesë persona.
2. Ai u paraqet fletën e punës 1, duke u dhënë secilit nga një kopje të saj.
3. Në një kohë të caktuar, grupet bëjnë zgjedhjen e tyre për 4 figura të përbashkëta.
4. Përmbledhja. Trajneri mund të përdorë pyetjet e mëposhtme:
 - ▶ Cilat janë ndjenjat që shkaktuan figurat ?
 - ▶ A ju lindi ndonjë pyetje për to?
 - ▶ A lidhet ndonjëra prej pyetjeve me çështje kundërshtuese?
 - ▶ Si i zgjodhi secili individualisht figurat?
 - ▶ Si vendosi grupi për zgjedhjen përfundimtare? Cilat ishin kriteret që përdorët? (p.sh. a ishin kriteret të bazuara në fenë e portretizuar nga figura, apo në njohuritë ose në mungesën e njohurive tuaja për të?)
5. Trajneri paraqet fletën e punës 2 dhe i jep çdo grupi nga një kopje të saj.
6. Në kohën e duhur, trajneri paraqet materialin "Fusha dhe përkufizime" dhe "Parakushte arsimore". Ai u jep kohë grupeve për të lexuar dhe për të diskutuar në grup. Në varësi të kohës në dispozicion dhe të nevojave të grupit, trajneri vendos nëse duhet t'u japë grupeve një ose dy faqe të materialit.

7. Trajneri paraqet fletën e punës 3 dhe i jep çdo grupi një kopje të saj.
8. Trajneri i paraqet posterin e përshkrimit të mësimit secilit grup dhe i var posterat në mure, në një largësi të caktuar nga njëri tjetri. Ai u jep nga një numër çdo anëtari të grupeve dhe formon grupe të reja në bazë të numrave të njëjtë. Më pas vendos grupet e reja përballë një posterit. Ai pyet anëtarin e grupit nga grupi që krijoi posterin ta shpjegojë atë. Grupet lëvizin në sens orar çdo dy minuta, derisa ata të kenë vizituar të gjithë posterat.
9. Trajneri përmbledh veprimtarinë, duke përdorur pyejet e mëposhtme:
 - ▶ Ç'mendim keni për procedurën?
 - ▶ Çfarë ju pëlqeu ose ju duk e vështirë në planifikimin e mësimit tuaj?
 - ▶ Cili është informacioni më i pakët i nevojshëm për mësime të mësimdhënien?
 - ▶ Si ndikojnë nivelet e ndryshme të informacionit në mësime?
 - ▶ A është kjo veprimtari e vlefshme për trajnimin e mësuesve? Çfarë do të ndryshonit apo do të mbanit?
 - ▶ Si mund të përdoren diskutimet e lutësit për rritjen dhe zhvillimin e vetëdijes personale dhe të kuptuarit e besimeve dhe të vlerave të tjerëve, duke respektuar dinjitetin e tyre?

ALTERNATIVË

Trajneri zëvendëson hapin 9 me 10, si më poshtë (për këtë nuk është e nevojshme fleta e punës 3.

10. Trajneri kërkon nga grupet të krijojnë një histori, duke përdorur figurat e zgjedhura dhe duke përfshirë idetë kryesore të Materialit 1 dhe 2.
11. Çdo grup ka 5 min. kohë për të paraqitur historinë duke përdorur të gjitha format e mundshme. Grupet e tjera duhet të hamendësojnë përse bën fjalë historia.
12. Përmbledhja si më sipër.



Fleta e punës 1



Shkruani tri gjëra që shikoni te figurat.

Cilat janë ngjashmëritë që vini re te figurat?

Cilat janë ndryshimet që vini re te figurat?

Shkruani tri gjëra që figurat ju bëjnë të mendoni.

Shkruani tri pyetje për të cilat figurat ju bëjnë të çuditëni.

Pasi t'u përgjigjeni pyetjeve, diskutoni përgjigjet tuaja në grup dhe më pas vendosni cila nga figurat është më e njohura për grupin dhe cila më pak e njohura.

Fleta e punës 2

Qasja ndaj një besimtari

Në grupe, zgjidhni një figurë, atë që është më shumë ose më pak e njohur ju. Ju jeni i padukshëm, kështu që mund t'i afroheni figurës pa u vënë re.

Ku është figura?

■ Çfarë vini re përreth figurës?

■ Çfarë dëgjoni?

■ Çfarë po bën figura?

■ Çfarë sheh personi?

■ Çfarë thotë personi?

■ Cili është kuptimi i veprimit, për personin që e kryen atë?

Fleta e punës 3

Përgatitja e një mësimi

Ju jeni i padukshëm dhe mund t'u afroheni figurave, një nga një, pa u vënë re. Tema e mësimit tuaj është lutja në fe.

Cili është informacioni i rëndësishëm për të cilin keni nevojë për të përgatitur mësimin? Nëse planifikoni t'i referoheni lutjes në fe në përgjithësi:

■ Nëse planifikoni t'i referoheni "lutjes" në një ose më shumë fe:

■ Për çfarë qëndrimesh dhe aftësish personale keni nevojë për mësime të "lutjes" në fe?

■ Cilat janë metodat e mësimit që planifikoni të përdorni në mësime të tuaja?

■ Sa shumë dhe sa thellë mund t'i ndihmoni nxënësit tuaj të dinë, të kuptojnë dhe të respektojnë idetë dhe veprimet që mund të jenë të ndryshme nga të tyret?

■ Cili është kuptimi i veprimit, për personin që kryen atë?

Krijoni një poster, që paraqet përgatitjen tuaj për mësimin për lutjen në fe, duke mbajtur parasysh dy pjesët e përzgjedhura nga Udhërrëfyesi (Signposts) (shih fletën e punës 4 më poshtë).

(Përdorni një formë poster sipas dëshirës: fjalë, vizatim, hartë mendore etj.).

Materiali 1 – Fusha dhe përkufizimet

Nga Udhërrëfyesi (Signposts) fq.118

1. Qëllimi i Rekomandimit është të sigurojë trajtimin e dimensionit të bindjeve fetare dhe jofetare në kuadrin e edukimit ndërkulturor, si ndihmesë për të fuqizuar të drejtat e njeriut, demokracinë, qytetarinë dhe pjesëmarrjen si dhe të zhvillojë kompetencën për dialog ndërkulturor në nivelin e:
 - ▶ politikave arsimore, në formën e parimeve dhe objektivave të qarta arsimore;
 - ▶ institucioneve, veçanërisht përmes mjediseve të hapura arsimore dhe politikave përfshirëse;
 - ▶ zhvillimit profesional të stafit mësimdhënës përmes trajnimeve cilësore.
2. Për qëllime të këtij rekomandimi “bindjet fetare dhe jofetare” trajtohen si fakte kulturore në kuadrin e fushës së larmisë shoqërore.
3. Bindjet fetare dhe jofetare janë një dukuri komplekse dhe e larmishme. Ato nuk janë gdhendur në gur. Përveç kësaj njerëzit kanë bindje fetare dhe jofetare në shkallë të ndryshme dhe për arsye të ndryshme. Për disa këto bindje janë shumë të rëndësishme dhe mund të jenë çështje zgjedhjeje, për të tjerë mund të jenë të dorës së dytë dhe të lidhura me rrethana historike. Për këtë arsye, edhe dimensionin e bindjeve fetare dhe jofetare në kuadrin e edukimit ndërkulturor duhet të reflektojë këta larmi dhe kompleksitet në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar.

Materiali 2 – Mësimdhënia e aspekteve të një qasjeje ndërkulturore të bindjeve fetare dhe jofetare në arsim

Nga Udhërrëfyesi (Signposts) fq.120-121

4. Parakushtet arsimore dhe metodat e të mësuarit më poshtë janë shumë të përshatshme për të nxitur marrjen parasysh të larmisë së bindjeve fetare dhe jofetare në kontekstin arsimor dhe për të zhvilluar dialogun ndërkulturor:
 - 4.1. Parakushtet arsimore.
 - ▶ Ndjeshmëria ndaj dinjitetit të barabartë të çdo individi;
 - ▶ Pranimi i të drejtave të njeriut si vlera që duhet të zbatohen përtej larmisë fetare dhe kulturore.
 - ▶ Komunikimi ndërmjet individëve dhe aftësia për të vënë veten në vendin e tjetrit për të krijuar një mjedis ku edukohet besimi dhe mirëkuptimi i ndërsjellë.
 - ▶ Të mësuarit në bashkëpunim, në të cilin mund të përfshihen dhe të marrin pjesë njerëz të të gjitha traditave.
 - ▶ Kushtet e një hapësire të të mësuarit të sigurt për të nxitur të shprehurit pa pasur frikën e të qenit i gjykuar ose i tallur.
 - 4.2. Metodatat e ndryshme të të mësuarit
 - ▶ Përdorimi i simulimeve për të krijuar situata të mësimdhënies që përfshijnë dialogun, dilemat dhe reflektimin.
 - ▶ Nxitja e nxënësve për të reflektuar objektivisht për ekzistencën dhe pikëpamjet e veta dhe të të tjerëve.
 - ▶ Loja me role është një përpjekje për të riprodhuar dhe për të kuptuar pikëpamjet dhe emocionet e të tjerëve.
 - ▶ Përdorimi i bibliotekave të gjalla.
 - ▶ Bashkëpunimi më shumë se konkurrenca për të ndërtuar një imazh pozitiv për veten.
 - ▶ Zhvillimi i qasjeve të përshatshme pedagogjike të tilla si:
 - qasja fenomenologjike që synon kultivimin e njohjes dhe të kuptuarit e bindjeve fetare dhe jofetare si dhe respektin për të tjerët, pavarësisht nga bindjet e tyre fetare ose jofetare;
 - qasja interpretuese e cila nxit të kuptuarit fleksibël të bindjeve fetare dhe jofetare dhe shmang vendosjen e tyre në një kuadër të ngurtë të paracaktuar;
 - qasja që aftëson nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të përfshihen në dialog me personat që zotërojnë vlera dhe ide të tjera;
 - qasja kontekstuale që merr parasysh kushtet vendore dhe globale të të mësuarit.

VEPRIMTARIA 2

Fokus

Veprimtaria fokusohet në kompetencën ndërfaqetare si politikë e gjithë shkollës. Siç përmendet në Udhërrëfuesin (fq.24), "Rekomandimi është i rëndësishëm jo vetëm në lidhje me klasën, por edhe për të gjithë politikën e shkollës për larminë (duke ndihmuar në edukimin ndërkulturor).

Këshilla

Veprimtaria, në fakt, përbën një hyrje dhe parapërgatitje për trajtimin e çështjeve që lidhen me identitetin fetar të anëtarëve të komunitetit të shkollës (drejtuesit, mësuesit, nxënësit, stafi, prindërit). Puna me studime rasti të tilla realizohet në mënyra të ndryshme, në varësi të kohës në dispozicion dhe të nevojave të veçanta të çdo mjedisi social. Ky studim rasti mund të zëvendësohet me të tjerë të marrë nga media. Nuk duhet haruar që është me e sigurtë dhe më e efektshme të përdoren raste që nuk lidhen drejtpërdrejt dhe nuk të referojnë në vende, raste dhe persona të shkollës ose të komunitetit vendor.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të analizojnë dimensionin fetar të edukimit ndërkulturor si përbërës i rëndësishëm i të gjithë politikës së shkollës për larminë dhe do të paraqesin përfundimet;
- ▶ do të shqyrtojnë rrugë të ndryshme në të cilat mësimdhënia e bindjeve fetare dhe jofetare nuk është thjesht një lëndë kurrikulare, por lidhet me kulturën e shkollës;
- ▶ do të zhvillojnë kompetencat ndërkulturore të mësuesve në lidhje me botëkuptimet fetare dhe jofetare.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore.
- ▶ Të qenurit i hapur ndaj tjetres kulturore dhe besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave të tjera.
- ▶ Toleranca ndaj paqartësisë .
- ▶ Fleksibilitet dhe përshtatshmëri.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të vetes dhe të botës (kultura, kulturat, historia, qëndrueshmëria).

Procedura/hapat

Nëse koha është e pamjaftueshme, përdoret vetëm Materiali 1. Nëse koha është e mjaftueshme përdoret edhe Materiali 2, para ose pas Materialit 1. Materiali 2 mund të përdoret edhe pas Fletës së punës, duke i pyetur pjesëmarrësit nëse informacioni shtesë solli ndonjë ndryshim. Këtu është rasti të diskutohet për ndikimin e medias dhe të medias sociale, si dhe të çështjeve të larmisë kulturore.

1. Formohen grupe me katër ose pesë persona.
2. Çdo grupi i jepet Materiali 1 dhe Materiali 2, të cilin ata e lexojnë me kujdes.
3. Pasi lexojnë artikullin, grupet diskutojnë për historinë.
4. Trajneri i jep secilit grup nga një kopje të Fletës së punës 1
5. Ai u jep grupeve kohën e nevojshme për të analizuar çështjet dhe për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve.
6. Çdo grup krijon një poster në të cilin paraqesin edhe propozimet e tyre.
7. Përmbledhje. Trajneri mund të përdorë pyetjet e mëposhtme me pjesëmarrësit:
 - ▶ Ç'mendim keni për këtë procedurë?
 - ▶ Çfarë ju pëlqeu dhe çfarë përjetuat si të vështirë në këtë veprimtari?
 - ▶ Cilat janë pengesat e mundshme në zbatimin e propozimeve tuaja?
 - ▶ Çfarë do të mbanit dhe çfarë do të ndryshonit në këtë veprimtari.

ALTERNATIVË

1. Pjesëmarrësit ndahen në dy grupe, që punojnë, nëse është e mundur, në dy mjedise të ndryshme.
2. Çdo grup merr një kartë rolesh (Fleta e punës 2) me detyrën të bëjnë çfarë kërkon roli.
3. Pasi pjesëmarrësit diskutojnë për rolet e tyre, trajneri i pyet ata nëse kanë vendosur të takojnë nxënësit.
4. Pas kësaj, grupet mblidhen së bashku. Secili prej tyre përzgjedh tre përfaqësues për të folur.
5. Në çdo rast, grupet bashkohen pasi kanë pasur kohë të diskutojnë vendimet e tyre.
6. Në seancë plenare, trajneri bën përmbledhjen, duke përdorur pyetjet e mëposhtme:
 - ▶ Cili është rezultati i takimit?
 - ▶ Si u ndjetë?
 - ▶ Cili ishte, sipas, jush shkak i incidentit?
 - ▶ A ka rrugëdalje?



Materiali 1

Lidhja e Rekomandimit me kulturën e shkollës

Ahmet Mohamed ishte shumë i kënaqur ditën e hënë, kur shkoi në shkollën e mesme në Irvin, në Tekas. Një adoleshent, që me ëndrrën të bëhej inxhinier, dëshironte t'i tregonte mësuesit të tij orën digjitale që kishte bërë me një kuti lapsash.

Dita e djalit 14 vjeçar nuk përfundoi me vlerësim por me ndëshkim, pasi shkolla thirri policinë dhe ai u arrestua.

“Unë ndërtova një orë për t'i bërë përshtypje mësueses dhe është shumë e trishtueshme që ajo krijoi përshtypjen e gabuar për të” – u tha Ahmeti gazetarëve”

Ahmeti foli me medien e mbledhur në oborrin e tij dhe dukej se kishte veshur të njëjtën bluzë të NASA-s, të cilën ai kishte të veshur edhe në një foto, të marrë ditën që u arrestua. Në atë foto, ai dukej i hutuar dhe i mërzhitur, pasi kishte dalë nga shkolla në pranga.

“Ata më arrestuan dhe më thanë që kisha kryer një krim, krijimin e një bombe mashtruese, një bombë jo të vërtetë” shpjegonte një nxënës më vonë pasi autoritetet e lanë atë të lirë.

Zëdhënësi i Policisë së Irvin, oficer Xhejms Meklelan, i tha stacionit televiziv “Ne u përpoqëm të pyesnim të riun për atë që kishte bërë dhe duhej thjesht të na tregonte që ishte një orë”


Adoleshenti e bëri këtë sepse ajo ishte një orë, vazhdoi ai.

Ditën e mërkurë, policia deklaroi se adoleshenti nuk do akuzohej për ndonjë vepër penale.

Shefi Lary Boid, tha se Ahmet duhet të ishte më i hapur, duke shkuar përtej përshkrimit se ajo që kishte bërë ishte një orë. Por autoritetet thonë se Boid ishte i vendosur se adoleshenti nuk kishte asnjë qëllim që të shkaktonte ndonjë alarm dhe pajisja, të cilën shefi e quajti një eksperiment i bërë në shtëpi ishte i padëmshëm.

Ahmeti, që ëndërron të shkojë në Institutin e Teknologjisë, tha se ishte i kënaqur për tërheqjen e akuzave dhe nuk i kushton rëndësi faktit që policia nuk i kërkoi falje për arrestimin. Më pas ai deklaroi se ishte pyetur nga policia pa praninë e një avokati dhe avokatja e tij, Linda Moreno, u tha gazetarëve se ata nuk do t'u përgjigjeshin më pyetjeve që lidheshin me procesin ligjor.

Ahmet tha se ishte pezulluar nga shkolla deri të enjten, por po shqyrton idenë e transferimit në një shkollë tjetër.



Materiali 2

Reagimet e medias sociale

Një ndjenjë tërbimi në lidhje me këtë – shumë e lidhnin incidentin me faktin që nxënësi ishte mysliman - u përhap në medien sociale me parulla si “Mbështesni Ahmetin”, e cila u përhap botërisht në Twitter dhe numri ndjekësve deri të martën në mëngjes ishte më shumë se 100,000. Facebook-u i shkollës ziente nga kritikizmi i mprehtë për mënyrën e trajtimit të adoleshentit dhe fraza “inxhinier për ahmetin” po fitonte popullaritet.

Babai i adoleshentit pa djalin e tij të rrethuar nga policët

Babai i Ahmetit, Mohamet Elhasan Mohamet, i cili emigroi nga Sudani ku kishte kandiduar dy herë për president, i tha CNN të mërkurën si ai ishte shumë i mërzitur për faktin që shkolla nuk e kontaktoi atë menjëherë për ta vënë në dijeni për situatën.

Ai u tha gazetarëve se e para gjë që ai dëgjoi për të ishte kur u thirr nga policia, e cila e vuri në dijeni se djali i tij akuzohej për një bombë alarm. Ai nxitoi për në stacionin e policisë, ku pa djalin të prangosur e të rrethuar nga pesë policë. Ahmeti i tha të atit se do ta kishte telefonuar, por policia nuk e lejoi me pretekstin se ishte i arrestuar. - sqaroi Ahmeti më tej.

Ahmeti tha se kur u nxor nga klasa, e vendosën në një dhomë me katër policë dhe njëri prej tyre i tha: “Po. Ky është ai që mendova se do të ishte”. Një gazetar, në një konferencë shtypi, të mërkurën, pyeti shef Boid nëse identiteti fetar ose etnik i adoleshentit luajti rol në mënyrën si ai u trajtua nga policia. Shefi e mohoi një gjë të tillë, madje vlerësoi marrëdhëniet e departamentit me komunitetin mysliman të Irving. Megjithatë, ai thotë se “Ne jetojmë në një kohë ku gjërat në shkollë nuk mund të trajtohen në atë mënyrë”.

Në konferencën e shtypit të të mërkurës, një zëdhënëse për komunitetin e pavarur të shkollës së Irving u tha gazetarëve se mënyra si u përshkrua përvoja e adoleshentit në media ishte jo e duhura”

Ajo nuk pranoi të shpjegonte përse, duke cituar nevojën për të mbrojtur privatësinë e nxënësit. Deklarata e saj u botua të mërkurën në një site të komunitetit. Ajo shtoi se shkolla do të japë më shumë informacion kur familjet të japin lejen me shkrim për të diskutuar për incidentin, në fjalë.

Unë kam qenë mësuesi i gjuhës angleze, i cili raportoi Ahmetin tek drejtori - sqaroi polici.

“Ne gjithmonë pyesin për nxënësit dhe stafin dhe raportojmë menjëherë nëse vëzhgojmë ndonjë gjë ose sjellje të dyshimtë” thuhet në deklaratën e shkollës. “Nëse diçka del mbi të zakonshmen, ajo duhet të raportohet menjëherë tek administratori i shkollës dhe/ose te policia për t’u trajtuar menjëherë. Ne duhet gjithmonë të marrim masat e nevojshme për të mbrojtur nxënësit tanë dhe për të mbajtur komunitetin tonë sa më të sigurt”.

Burimi i Materialit 1 dhe 2: Ashley Fantz, Steve Almas and Anne Claire Stapleton, MUSLIM TEEN AHMED MOHAMMED CREATES CLOCK, SHOWS TEACHER – GETS ARRESTED, Artikull online nw <http://edition.cnn.com/2015/09/16/us/texasstudent-ahmed-muslimclock-bomb/> downloaded on 17 July 2017.


Fletë pune 1

Një instrument për analizën e problemit

| Pyetje | Përgjigje |
|--|-----------|
| <p>Kur?</p> <p>Kur u shfaq çështja?</p> <p>Kur ishte i nevojshëm veprimi? Deri kur duhet të zgjidhet çështja?</p> | |
| <p>Kush?</p> <p>A është e vërtetë që kultura e shkollës është përgjegjëse?</p> <p>Kush ndikohet prej saj?</p> <p>Kush duhet të informohet?</p> | |
| <p>Ku?</p> <p>Ku u shfaq problemi? Ku ndikon ai?</p> <p>Ku është i rëndësishëm?</p> | |
| <p>Çfarë?</p> <p>Cilat janë faktet? Çfarë dëshiroj të arrij?</p> <p>Çfarë duhet të ndryshojë shkolla për të siguruar që kjo të mos ndodhë përsëri?</p> | |
| <p>Pse?</p> <p>Pse ndodhi problemi?</p> <p>Pse njerëz të ndryshëm sillen në atë mënyrë? Pse sjellja ime mund të jetë e ndryshme?</p> | |
| <p>Si?</p> <p>Si mund t'i ndryshojmë këto situata të ngjashme? Si mund të përfshijmë njerëzit e duhur në këtë? Nëse ndodh, në një situatë të ngjashme, si mund t'i vlerësoj veprimet e mia? Çfarë lloj qëndrimesh, sjelljesh etj. janë të nevojshme që të trajtohen në mënyrën e duhur?</p> | |


Krijoni një poster që ilustron tre veprime që duhet të ndërmerret shkolla për të përmirësuar klimën e saj, për të qenë në gjendje të përballojë çështje të tilla.

Fletë pune 2



Karta e rolit A

Është kohë pushimi. Ju jeni në sallën e mësuesve, me mësues të tjerë. Një mësues hyn në sallë, shumë i shqetësuar. Ju e dëgjoni atë të thotë: "A mund të kem vëmendjen tuaj? Gjatë rrugës për këtu, në një nga klasat, pashë një grup nxënësish të mbledhur rreth një tavoline. Ahmed Mohamed po u tregonte një kuti disa nxënësve të tjerë somalezë. Unë vura re që brenda saj ishte një orë plot me fije e gjëra të tjera. Dukej si diçka e bërë vetë. Çfarë duhet të bëjmë?" Diskutoni së bashku përgjigjen tuaj. Nxënësit janë ende në klasë.



Karta e rolit B

Është kohë pushimi. Ju jeni në klasë, si zakonisht me grupin tuaj prej pesë shokësh. Ahmet Mohamet po ju tregon një orë që ka prodhuar vetë. Ju e dini ëndrrën e tij për t'u bërë inxhinier dhe ai dëshiron t'ju tregojë juve veprën e tij, përpara se t'ia tregojë mësueses. Ju e keni diskutuar këtë më parë, pra ju dini gjithçka rreth saj. Ai kërkon mendimin tuaj kur t'ia tregojë mësuesit, para, gjatë apo pas mësimit si një surprizë ose ai kërkon mbështetjen dhe këshillën tuaj. Ju jeni shokët e tij të ngushtë. Diskutoni për mënyrën e paraqitjes së veprës së tij dhe cili mund të jetë roli juaj.

VEPRIMTARIA 3 – TË PËRCAKTOJMË “TË KUPTUARIT E FEVE” DHE “TË KUPTUARIT FETAR”

Fokus

Veprimtaria fokusohet në ndryshimin e rezultateve të pritshme ndërmjet mësimëve që synojnë të nxihin të kuptuarit e feve dhe të tjerave që synojnë të kuptuarit fetar. Qasjet e ndryshme krijojnë lloje të ndryshme mësimi: është e nevojshme të jemi të qartë për këtë ndryshim, me qëllim që kuptojmë edhe lidhjen ndërmjet të kuptuarit të feve dhe edukimit ndërkulturor.

Këshilla

Ky mësim është hartuar duke përdorur një version të “të kuptuarit të feve”. Ideja është që të ndihmohen mësuesit të identifikojnë elementet që karakterizojnë një mësim të tillë dhe, në të njëjtën kohë t’u jepet atyre material fetar të cilin ata mund ta pasurojnë për të krijuar tipin e mësimi për “të kuptuarit fetar”. Një mësim i tillë që bazohet në “ushqimin” fetar, nëse pasurohet nga materiale dhe metoda të caktuara mund të shndërrohet në një mësim për të kuptuarit e feve, pa humbur vlerën e saj fetare.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ Do të përshkruajnë dhe justifikojnë dallimin ndërmjet një mësimi për “të kuptuarit e feve” dhe mësimi për “të kuptuarit fetar”.
- ▶ Të krijojnë një plan mësimor për mësimdhënien e botëkuptimeve fetare dhe jofetare në edukimin ndërkulturor.
- ▶ Të ndërtojnë vetëdijen dhe ndjeshmërinë ndaj materialeve mësimore të nevojshme për punën me nxënës me prejardhje të ndryshme fetare dhe jofetare.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore.
- ▶ Të qënurit i hapur ndaj tjetres kulturore dhe besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave të tjera.
- ▶ Toleranca ndaj paqartësisë.
- ▶ Fleksibilitet dhe përshtatshmëri.
- ▶ Aftësi për të bashkëpunuar.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të vetes dhe të botës (kultura, kulturat, historia, qëndrueshmëria).

Procedura/hapat

Nëse koha është e pamjaftueshme, përdoret vetëm Materiali 1. Nëse koha është e mjaftueshme përdoret edhe Materiali 2, para ose pas Materialit 1. Materiali 2 mund të përdoret edhe pas Fletës së punës, duke i pyetur pjesëmarrësit nëse informacioni shtesë solli ndonjë ndryshim. Këtu është rasti të diskutohet për ndikimin e medias dhe të medias sociale, si dhe të çështje të larmisë kulturore.

1. Trajneri krijon grupe me 5 anëtarë.
2. MÇN (Mendo-puno në Çift – Ndaj). Pjesëmarrësve u kërkohet të tregojnë një histori shpëtimi që u ka bërë përshtypje (nga përvoja vetjake ose e tjerëve).
3. Trajneri paraqet Fletën e punës 1 dhe i jep nga një kopje të saj çdo grupi. Grupet kanë kohë të lexojnë historinë dhe të diskutojnë pyetjet, duke menduar edhe mundësinë që ato të shërbejnë si një mësim i mundshëm.
4. Përmbledhje:
 - ▶ Çfarë mendoni për mësimin?
 - ▶ Çfarë do të mbanit ose do të ndryshonit?
5. Në grupe, pjesëmarrësit diskutojnë mundësinë e mësimdhënies së një mësimi të tillë në mjediset e tyre arsimore ose në të ndryshëm. Ata mund të përdorin pyetjet:
 - ▶ Cilat janë rezultatet e pritshme të këtij mësimi?
 - ▶ Cilat janë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që përfshin ai?
 - ▶ Cilat janë metodat e mësimdhënies që kërkohen për t’i fituar ato?

6. Në grupe, pjesëmarrësit diskutojnë çështjet e mundshme pozitive dhe negative që mund të ngrihen si rrjedhojë e ndryshimeve të mundshme të identiteteve fetare dhe jofetare të nxënësve dhe të familjeve të tyre. Ata përpiqen të gjejnë shembuj të ndryshëm për këtë qëllim.

Grupeve, si alternativë, mund t'u jepet përshkrimi i karakterit të një nxënësi me prejardhje të caktuar (p.sh. në varësi të vendit dhe të mësimit, një i krishterë, një mysliman, një agnostic etj.)

Më poshtë janë disa pyetje që mund të përdoren për këtë qëllim:

- ▶ Çfarë do të shihte nxënësi si interesante në këtë mësim?
 - ▶ Përse? Çfarë mund të gjente të vështirë?
7. Cilat janë pikat pozitive në këtë mësim? A ka pika që mungojnë?
 8. Grupet lexojnë paragrafin "Të kuptuarit e feve dhe të kuptuarit fetar" (Udhërrëfyese fq. 22 - shih Fleta e punës 3).
 9. Në grupe, pjesëmarrësit e klasifikojnë planin mësimor si plan për "të kuptuarit e feve" ose për "të kuptuarit fetar".

10. Pjesëmarrësit përzgjedhin kriteret për vendim-marrjet e tyre.
11. Kriteret raportohen në seancë plenare.
12. Po në seancë plenare, kriteret renditen sipas rëndësisë, duke iu referuar përsëri pjesës nga Udhërrëfyese.
13. Pjesëmarrësit, në grupet e tyre, rilexojnë pjesët: Rekomandim: Fusha dhe përkufizimet (Udhërrëfyese, fq. 120-121). Parakushtet arsimore dhe stilet e ndryshme të të mësuarit (Udhërrëfyese, fq.120-121). Grupet diskutojnë për këto çështje për disa minuta.
14. Trajneri paraqet "Fleta e punës 2" duke i dhënë nga një kopje çdo grupi. Grupet kanë detyrën të shtojnë në planin e tyre mësimor elementet e mundshme që mungojnë (burime, metoda, materiale) për të përgatitur mësimin për mësimdhënien e botëkuptimeve fetare dhe jofetare në edukimn ndërkulturor.



Fletë pune 1

Ajo që vijon bazohet në konceptimin Ortodoks të shpëtimit. Lexoni historinë, bisedoni rreth saj dhe përgjigjuni pyetjeve:

Qepa

Na ishte një herë një fshatare mjaft e keqe. Ajo vdiq dhe nuk la asnjë vepër të mirë pas. Djalli e mori dhe e zhyti në liqenin e zjarrtë. Ëngjëlli i saj ruajtës përpiqej të kujtonte çfarë veprash të mira kishte bërë gruaja që t'ia tregonte zotit e ta shpëtonte. "Ajo një herë tërhoqi një qepë në kopshtin e saj" tha ai dhe ia dha atë një lypsareje. Zoti u përgjegj: Merre qepën, mbaje mbi liqen dhe jepi asaj mundësi të kapet prej saj dhe të dalë jashtë. Nëse ti mund ta tërheqësh atë jashtë liqenit me anë të qepës, atëherë ajo do të jetë e mirëpritur në Parajsë. Por, nëse qepa këputet, atëherë gruaja do të qëndrojë aty ku është" Ëngjëlli vrapoi drejt gruas dhe i zgjati asaj qepën. "Hajde" i tha ai gruas, kapu pas kësaj qepe dhe unë do të nxjerr jashtë". Ai filloi ta tërhiqte atë me kujdes. Sapo e nxorri në sipërfaqe, mëkatarët e tjerë në liqen, duke e parë atë të tërhiqej jashtë, filluan të kapen pas saj, me shpresën që të dilnin jashtë bashkë me të. Por, duke qenë një grua shumë e keqe, ajo filloi t'i qëllonte ata. "Unë duhet të nxirrem jashtë, jo ju. Qepa është e imja, jo juaja" Sapo tha këto fjalë gruaja ra në liqenin me flakë dhe, që nga ajo ditë, ajo vazhdon të digjet në të. Ëngjëlli u largua me lot të sy.

Vëllezërit Karamazov nga Fjodor Dostojevski

Fjodor Mihajloviç Dostojevski (1821-1881) është romancier, tregimtar, eseist, gazetar dhe filozof rus. Vepra e tij letrare eksploron psikologjinë njerëzore në atmosferën e trazuar politike, sociale dhe shpirtërore të Rusisë së shk. 19 dhe ka qenë autor i shumë shkrimeve me temë filozofike dhe fetare.

Përshkruani pamjen e jetës dhe të vdekjes si paraqitet ajo në tregim.

A ka ndonjë lidhje, sipas shkrimtarit, ndërmjet jetës dhe jetës pas vdekjes ?

Çfarë e ndihmoi dhe çfarë e shkatërroi personazhin e tregimit?

Cilat janë, sipas tregimit, kriteret për ndarjen e njerëzve?

Fletë pune 2 – Planifikimi i mësimit

| Përmbajtja | |
|--------------------------------------|----------|
| Lënda: | |
| Klasa: | |
| Titulli i mësimit | |
| Rezultatet e pritshme të të mësuarit | |
| Vlerat | |
| Njohuritë dhe të kuptuarit kritik | 1. 2. |
| Aftësitë: | 1. 2. |
| Qëndrimet: | 1. 2. |

| Metodat | | | | |
|-----------------------|------|---------------------------|---------------------|----------------------------|
| Mënyra e mësimdhënies | | | | |
| | Koha | Përshkrimi i veprimtarisë | Çfarë do të bëj unë | Çfarë do të bëjnë nxënësit |
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |

Materiale

Nga *Udhërrëfytyesi*, fq. 22


Të kuptuarit e feve dhe të kuptuarit fetar

Disa autorë bëjnë dallimin ndërmjet “të kuptuarit të feve” dhe “të kuptuarit fetar” (p.sh. Cox 1983) Disa fetarë pretendojnë që të kuptuarit mund të ndodhë vetëm përmes fillimit të një rruge fetare. Nga ky këndvështrim, “të kuptuarit” mund të arrihet vetëm përmes ushqimit fetar, duke u përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mësimet dhe në praktikën fetare. Kjo formë e edukimit fetar (të cilën ne mund ta quajmë zhvillimi i “të kuptuarit fetar”, një mënyrë e qartë fetare e të kuptuarit) do të ishte e përshtatshme për të rinjtë që vijnë nga familje që janë besimtarë në kuadrin e një traditë fetare të caktuar. Megjithatë kjo nuk do të ishte e përshtatshme, si pjesë e një arsimit publik që u ofrohet të gjithë nxënësve me prejardhje të larmishme, duke përfshirë këtu edhe këndvështrimet e ndryshme fetare dhe jofetare. Fusha akademike e studimit të feve mbron pikëpamjen që disa shkallë të kuptuarit (të kuptuarit e feve) u mundësohen të gjithëve, pavarësisht nga angazhimi fetar, duke argumentuar se brenda larmisë së disiplinave të ndryshme akademike ekzistojnë instrumente që mund të aftësojnë nxënësit të zhvillojnë të kuptuarit e feve dhe këndvështrimet e njerëzve të fesë. Të tilla fusha përfshijnë, për shembull, historinë, artin, dramën, letërsinë dhe studimin e literaturës, etnografinë, psikologjinë dhe studimet kulturore dhe ndërkulturore. Teknikat e kërkuara përfshijnë jo vetëm fitimin e njohurive, por edhe zhvillimin e aftësive dhe kultivimin e qëndrimeve të ndryshme. Këto teknika nuk përdoren vetëm në përpjekjet për të kuptuar gjuhën dhe përvojën e të tjerëve, por edhe në zhvillimin e vetëdijes së nxënësve në lidhje me idetë dhe vlerat e tyre aktuale. Nga pikëpamja e metodës, është e rëndësishme të mos bëhet dallim i prerë ndërmjet teknikave të përdorura nga besimtarët/praktikantët e fesë për zhvillimin e “të kuptuarit fetar” dhe nga ata që janë “jashtë feve” në përpjekjet për “të kuptuarit e feve”. Për shembull, të dyja fushat e studimit të teologjisë dhe e studimit të feve përdorin të njëjtat teknika dhe koncepte si: qëndrimet, aftësitë dhe njohuritë, që shoqërojnë procesin e “dialogut”. Po kështu, zhvillimi i të kuptuarit të një këndvështrimi fetar ndeshet dhe ndërvepron me besimtarët fetarë dhe/ose me tekstet, tregimet, praktikat, doktrinën e tyre. Për më tepër, klasat e larmishme në shkollat publike ka të ngjarë të përfshijnë të rinj nga prejardhje fetare dhe jofetare. Për disa, zhvillimi i të kuptuarit të një qëndrimi të ndryshëm fetar mund të ngrejë pyetje fetare ose teologjike. Për këtë arsye, për disa nxënës, zhvillimi i të kuptuarit të feve mund të zhvillojë në një farë shkalle, “të kuptuarit fetar”

Kapitulli 3


Terminologjia që shoqëron mësimdhënien për fenë dhe besimet

Çështje kyçe/situata




- ▶ Mësimdhënia për fetë dhe besimet po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme.
- ▶ Politika, zbatimi dhe shkëmbimi varen nga mënyra si kuptohen konceptet.
- ▶ Termat dhe konceptet që shoqërojnë mësimdhënien për fetë dhe besimet mund të jenë të paqartë dhe mund të çojnë në keqkuptime dhe konflikte.
- ▶ Kur nevojiten politika dhe veprime të përbashkëta nevojitet edhe kuptimi i njëjtë i koncepteve që qëndrojnë në themel të tyre.
- ▶ Nevoja për kuptim të njëjtë të koncepteve e termave është i nevojshëm kur zhvillohen synime dhe objektiva arsimore për kurrikulën, mësimdhënien dhe programet e trajnimit.

Kompetencat për kulturë demokratike



- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të botës: politikës, ligjit, të drejtave të njeriut, kulturës, kulturave, historisë, medias etj.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të gjuhës dhe të komunikimit.
- ▶ Të qenit i hapur ndaj tjetrës kulturore dhe ndaj besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave.
- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore.
- ▶ Toleranca ndaj paqartësisë.

Çështjet kundërshtuespër t'u marrë në shqyrtim nga mësuesi



- ▶ Si t'u përgjigjemi kuptimeve të ndryshme të të njëjtit koncept ose term?
- ▶ Si t'u përgjigjemi pretendimeve konfliktuale për të vërtetat ndërmjet nxënësve dhe ndërmjet feve, të cilat lindin në kontekste të ndryshme?
- ▶ Si të nxisim nxënësit të pranojnë, të përpiqen të kuptojnë dhe të çmojnë mënyra të ndryshme të të kuptuarit të koncepteve dhe termave dhe të reflektojnë për të kuptuarit e tyre, si një hap i rëndësishëm drejt përpjekjeve të përbashkëta.
- ▶ Si të vendosim për burimet e informacionit për qartësimin e koncepteve/termave (fetare, sociologjike, filozofike, historike etj).

Si ndikon te mua kjo çështje?




- ▶ Sfidon mënyrën time të të menduarit, njohuritë e mia aktuale për këtë çështje dhe gatishmërinë time për të mësuar nga larmia që më rrethon.
- ▶ Më sfidon mua si mësues, në lidhje me aftësinë time për të përdorur pedagogjinë e duhur për mësimdhënien reth larmisë dhe çështjeve kundërshtuese në klasë.
- ▶ Sfidon gatishmërinë time për të marrë parasysh dhe për të eksploruar me kujdes çështjet e vështira kundërshtuese, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me pluralizmin fetar dhe ndryshimet për pretendimet e të vërtetave.

Si ndikon kjo në mësimdhënien time?



- ▶ Unë do të jem në gjendje dhe i gatshëm për mësimdhënie që aftëson nxënësit të shprehin pikëpamjet dhe besimet e tyre, duke shpresuar që të dëgjojnë plotësisht dhe me kujdes njëri-tjetrin.
- ▶ Unë do të jem në gjendje dhe i gatshëm për të menaxhuar diskutimin e çështjeve kundërshtuese dhe për të pranuar dhe komunikuar tek nxënësit idenë se marrëveshjet ose përgjigjet përfundimtare mund të jenë të paarritshme.
- ▶ Unë do të jem në gjendje dhe i gatshëm për të sfiduar mënyrën e të mësuarit të nxënësve, duke eksploruar, interpretuar, marrë dhe mbrojtur qëndrimet në lidhje me materialet, temat dhe çështjet kundërshtuese.

Çfarë mund të bëj unë si mësues?



- ▶ Të shpjegoj kuptimin e termave kyç të përdorura në dokumente të tilla si dokumentet politike dhe kurrikulare.
- ▶ Të paraqes një metodologji të qartë për studimin e botëkuptimeve fetare dhe jofetare, e koncepteve dhe termave që marrin parasysh larminë e koncepteve dhe teorive që qëndrojnë në themel të tyre.
- ▶ Të nxis nxënësit të eksplorojnë kuptimet e ndryshme që u jepet termave teknike dhe arsyeve që qëndrojnë pas tyre (vlerat, interesat, qëndrimet, mungesën e njohurive etj.).
- ▶ Të krijoj një model shembull të paraqitjes dhe të interpretimit të feve, koncepteve, termave, duke vepruar me ndershmëri dhe në mënyrë të paanshme si mësues.

Çfarë duhet të zhvilloj?



- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit e botëkuptimeve të ndryshme fetare dhe jofetare, duke përfshirë larminë ndërmjet dhe brenda tyre, për të qenë në gjendje t'u paraqes dhe t'i nxis nxënësit të interpretojnë këto në mënyrë të ndershme.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit e koncepteve kyç që lidhen me botëkuptimet e veçanta fetare dhe jofetare.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit e këndvështrimeve, praktikave dhe besimeve të grupeve brenda një feje të veçantë dhe grupeve jofetare.
- ▶ Një numër metodash të mësimdhënies që nxisin kërkimin në larminë fetare dhe në shkëmbimin e këndvështrimeve të ndryshme ndërmjet nxënësve.
- ▶ Aftësitë në menaxhimin e diskutimit të çështjeve kundërshtuese, duke nxitur nxënësit të marrin pjesë në dialogjet për të ndryshmen dhe duke këmbëngulur që ata të dëgjojnë dhe të flasin me njëri tjetrin me respekt.

VEPRIMTARIA 1

Fokus

Këto veprimtari synojnë të bëjnë pjesëmarrësit të vetëdijshëm për faktin që gjithmonë ka dhe do të ketë ndryshime ose paqartësi në termat dhe konceptet e përdorura në çdo fushë studimi dhe, në mënyrë të veçantë, në mësimdhënien për fetë dhe besimet; këto janë edhe burim i mundëshëm i keqkuptimeve dhe konflikteve.

Pjesëmarrësit duhet të pranojnë rëndësinë e të kuptuarit të njëjtë të termave, kur janë të nevojshme politika dhe veprime të përbashkëta dhe kur zhvillohen synime dhe objektiva arsimore dhe programe trajnimi, si dhe rastet e pjesëmarrjes në diskutime për tema të këtilla.

Këshilla

Këto veprimtari mund të zhvillohen gjatë një seance trajnimi me mësuesit, nxënësit etj. në shkollë ose në mjedise të tjera. Pjesëmarrësit në trajnime duhet të jenë të familjarizuar me kuptimet e ndryshme që mund të marrin konceptet dhe termat dhe me arsyet e ndryshimeve të tilla. Për këtë arsye, ata duhet të kryejnë, paraprakisht kërkime në biblioteka ose në internet me qëllim që të zbulojnë këto kuptime dhe informacionet që lidhen me to. Në sesione të tjera, trajnerët mund të diskutojnë me nxënësit kërkimet dhe kuptimin që ata vetë kanë për termat dhe konceptet. Për veprimtarinë 3, pjesëmarrësit duhet të kujtohen, paraprakisht, për të sjellë dokumente kurrikulare, programe ose tekste shkollore të përdorura në shkollë.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Nxënësit:

- ▶ do të identifikojnë dhe do të eksplorojnë kuptimet e ndryshme të termave dhe koncepteve që lidhen me fenë dhe arsyet (vlerat, interesat, qëndrimet, mungesa e njohurisë etj.) që qëndrojnë në themel të tyre;
- ▶ do të shpjegojnë kuptimin e termave kyçe që lidhen me fenë, të përdorura në dokumente të tilla si dokumentet e politikës arsimore dhe kurrikula dhe rëndësinë e termave në praktikë;
- ▶ do të shpjegojnë rëndësinë e një metodologjie të qartë për studimin e botëkuptimeve fetare dhe jofetare, në lidhje me mundësinë e përmbajtjeve ose kuptimeve të ndryshme që mund të kenë konceptet dhe termat që lidhen me to;
- ▶ do të paraqesin dhe do të interpretojnë në mënyrë të paanshme botëkuptimet fetare dhe jofetare, duke përfshirë edhe termat që lidhen me ndryshimet dhe kundërshtitë;
- ▶ do të marrin pjesë në diskutime ku trajtohen çështje kundërshtuese.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të koncepteve, termave dhe pikëpamjeve fetare dhe jofetare.
- ▶ Aftësia për të pyetur dhe për të qartësuar konceptet, termat dhe idetë.
- ▶ Të qenurit i hapur për të mësuar për të tjerët.
- ▶ Aftësia për të identifikuar burime të besueshme informacioni.
- ▶ Vetëdija dhe njohja e kufizimeve të veta.

Procedura/hapat

Hyrje

Njohja me çështjen FOKUS

Kjo veprimtari do të ndihmojë pjesëmarrësit të trajtojnë termat dhe konceptet e njohura për ta. Ajo do t'u japë atyre mundësinë të njihen me temat dhe rëndësinë e trajtimit të tyre në punën e përditshme. Përveç kësaj, kjo veprimtari do t'i ndihmojë ata të qartësojnë metodologjinë e tyre të menduarit për shqyrtimin e termave dhe të koncepteve që interpretohen në mënyra të ndryshme.

1. Trajneri fton pjesëmarrësit të kujtojnë termat dhe konceptet me të cilat janë ndeshur dhe që kanë kuptime të ndryshme dhe i shkruan ato në tabelë, tabakë etj. Trajneri mund të sugjerojë terma dhe koncepte të tjera, si p.sh. "kultura" përmbajtja e të cilëve ndryshon në konteskte të ndryshme. Pjesëmarrësve mund t'u kërkohet të mendojnë sa më shumë fjalë që janë sinonime të koncepteve të zgjedhura.

Për shembull:

- ▶ Kultura barazohet me sjelljen ose edukatën (kuptimi ngushtohet)
- ▶ Kultura barazohet me arsimin (kuptimi ndryshohet)

10 minuta

2. Trajneri i ndan pjesëmarrësit në grupe dhe i fton të shqyrtojnë të dyja rastet (kuptimin e ngushtuar dhe atë të ndyshuar) për secilin koncept. Pjesëmarrësit duhet të diskutojnë për pasojat që sjell përdorimi i secilit prej kuptimeve gjatë zhvillimit të një programi trajnimi në kuadrin e edukimit ndërkulturor. Më pas grupet paraqesin punën e tyre.

10 minuta

Përmbledhje

Trajneri fton pjesëmarrësit të interpretojnë gjetjet dhe të reflektojnë për to. Ai vijon me diskutim, gjatë të cilit mund të përdorë pyetjet e mëposhtme:

- ▶ Çfarë ndodh nëse ne ngushtojmë ose zgjerojmë përmbajtjen e një koncepti?
- ▶ Çfarë ndodh nëse ne përdorim të njëjtin koncept duke nënkuptuar përmbajtje të ndryshme të tij?
- ▶ Çfarë pasoje mund të ketë të kuptuarit e gabuar të një koncepti për zhvillimin e politikave arsimore?

VEPRIMTARIA 2

Procedura/hapat

Hyrje

Njohja me çështjen

1. Trajneri fton pjesëmarrësit të kujtojnë çfarë mësuari nga veprimtaria e mëparshme dhe shkruan pikat kryesore në tabelë. Më pas ai shkruan termin "edukim fetar" dhe ndan pjesëmarrësit në katër grupe, duke u dhënë përkatësisht detyrat si më poshtë:
 - ▶ Grupi 1 dhe 2 do të zhvillojnë një kurrikul të shkurtër (qëllimet, objektivat dhe një plan të shkurtër zbatimi) për "edukimin fetar" në nivelin parauniversitar.
 - ▶ Grupi 3 do të zhvillojë një kurrikul të shkurtër (qëllimet, objektivat dhe një plan të shkurtër zbatimi) të quajtur "edukimi për fenë".
 - ▶ Grupi 4 do të zhvillojë një kurrikul të shkurtër (qëllimet, objektivat dhe një plan të shkurtër zbatimi) me temë "edukimi përmes fesë".

Më pas grupet paraqesin kurrikulën e tyre dhe trajneri përmbledh rezultatet kryesore të çdo kurrikule në tabelë.

20 minuta

2. Trajneri fton pjesëmarrësit të lexojnë me kujdes pjesën më poshtë, të shkëputur nga Udhërrëfytyrja (fq. 27-28), që trajton kuptimet e ndryshme të koncepteve që ata kanë përdorur në veprimtarinë e tyre dhe aspekte të tjera që lidhen me ta.

Shprehja "larmi fetare" nuk është e qartë dhe përdoret në mënyra të ndryshme. Ajo mund të nënkuptojë larminë e brendshme të një feje të caktuar, larminë e marrëdhënieve që individët mund të vendosin me një traditë fetare të trashëguar ose disa fe që praktikohen (me shumë mundësi në mënyra të larmishme) në të njëjtën hapësirë. Në disa gjuhë, për shembull, në gjuhën angleze, termi "besim" (faith) mund të përdoret në të njëjtin kuptim me fjalën "fe" (religion). Megjithatë, larmia e kuptimeve të secilit term nuk përputhet saktësisht dhe disa shkrimtarë parapëlqejnë të përdorin termin "traditë besimi" (faith tradition) ose "traditë fetare" (religious tradition) në vend të termit "besim (faith) ose "fe" (religion), duke u përpjekur të sugjerojnë diçka më të përcaktuar dhe konkrete. Gjuha gjermane bën qartë dallimin ndërmjet termit

besim (faith) me të cilin kupton këndvështrimin individual dhe termit fe (religion) me të cilin kupton më shumë një këndvështrim institucional.

Termi "sekular" mund të përdoret si ide e kundërt me termin "fetar", si në shprehjen "larmia fetare dhe sekulare". Në Rusi, termi "sekular" priret të lidhet me termin ateizëm dhe jofetar. Megjithatë, në shumë kontekste, fjala "sekular" përdoret në kuptimin "joteologjik", që nënkupton më shumë një mënyrë qeverisjeje sesa një qëndrim ateist. Në këtë kuptim është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet termit "sekular" dhe "sekularist".

Një sistem arimor sekular mund të mbështesë një formë të edukimit fetar që lejon lirinë e fesë ose të besimit. Ky qëndrim ndryshon tërësisht nga programi sekularist, i cili kërkon të shtypë studimin e fesë ose të interpretojë fenë tërësisht në mënyrë të ngushtë.

Më tej, duhet bërë dallim i qartë ndërmjet përdorimit përshkruar të termave (sekularitet, pluralitet, modern/postmodern etj.) dhe përdorimit normativ të tyre (sekularisëm, pluralizëm, modernizëm/postmodernizëm etj.).

5 minuta

Përmbledhje

Trajneri fton pjesëmarrësit të reflektojnë për materialin e lexuar dhe u kërkon atyre të shprehin për të. Më tej ai i fton në një diskutim duke përdorur pyetjet e mëposhtme, të cilat lidhen me objektivat e veprimtarisë:

- ▶ Përse ne i japim përmbajtje të ndryshme të njëjtit koncept?
- ▶ Çfarë duhet të bëjmë për të shmangur një gjë të tillë?(çfarë duhet eksploruar, qartësuar etj.)
- ▶ Çfarë duhet të bëjmë për të zgjidhur problemin e kuptimeve të ndryshme për të njëjtin koncept?

Përgjigje të mundshme përshijnë:

- ▶ Të vëmë në dyshim konceptin?
- ▶ Të pranojmë kufizimet tona dhe të të tjerëve si burime informacioni dhe njohurish?
- ▶ Të gjejmë burimin e duhur të informacionit?
- ▶ Të zgjedhim metodën e duhur të studimit?

VEPRIMTARIA 3 – VEPRIMTARI KËRKIMORE

■ Trajneri fton pjesëmarrësit të kujtojnë çfarë mësuuan nga veprimtaritë e mëparshme dhe shkruan pikat kryesore në tabelë. Ai shkruan termin “Edukim fetar” dhe i ndan pjesëmarrësit në katër grupe duke u dhënë detyrat e mëposhtme:

- ▶ Në dokumentet kurrikulare, programe ose tekste shkollore që përdorni në shkollë kërkoni për terma, koncepte ose ide që lidhen me fenë ose kulturën, të cilat i përdorët në këtë veprimtari.
- ▶ Identifikoni dhe eksploronit kuptimet e ndryshme që u janë dhënë termave, koncepteve ose ideve që lidhen me fenë ose kulturën si dhe arsyet që qëndrojnë në themel të këtyre kuptimeve (vlerat, interesat e ndryshme, qëndrimet, mungesa e njohurive etj.).

- ▶ Kërkoni në burimet e ndryshme të informacionit për termat, konceptet ose idetë që lidhen me fenë ose kulturën dhe identifikoni ato që mendoni se janë më të saktat ose më të përdorurat dhe justifikoni zgjedhjen tuaj.


■ Më pas trajneri mund t’u paraqesë pjesëmarrësve, të përmbledhura, rezultatet e kërkimit të tyre, së bashku me sugjerime të mundshme për hartuasit e kurrikulës ose për institucionet përgjegjëse për zhvillimin e materialeve mësimore.



Kapitulli 4


Kompetenca dhe didaktika për të kuptuarit e feve

Çështje kyçe/situata



- ▶ Cilësia e mësimdhënies dhe kompetencat e nxënësve janë të ndërlidhura. Dy janë qasjet didaktike që theksohen në lidhje me këto: qasja interpretuese dhe ajo dialoguese.
- ▶ Qasja interpretuese përqendrohet në: *paraqitjen* (si botëkuptimet fetare dhe jofetare portretizohen ose paraqiten tek nxënësit); *interpretimin* (si gjuha dhe simbolet fetare interpretohen nga nxënësit); ndjeshmëria (si përgjigjen nxënësit ndaj të mësuarit të tyre në lidhje me botëkuptimet fetare dhe jofetare).
- ▶ Qasja dialoguese, sipas Julia Ipgrave, ka tre elemente: pranimin e larmisë, të të ndryshmes dhe ndryshimit; të qenit i hapur dhe përgjigja pozitive ndaj të ndryshmes dhe diskutimi dhe debati

Kompetencat për kulturë demokratike



- ▶ Aftësitë e të menduarit analitik dhe kritik, empatia.
- ▶ Respekti, toleranca ndaj paqartësisë, të qenit i hapur ndaj besimeve dhe botëkuptimeve të tjerëve.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të feve.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të komunikimit

Çështjet kundërshtuese për t'u marrë në shqyrtim nga mësuesi



- ▶ Si të përgjigjemi ndaj pretendimeve konfliktuale për të vërtetën ndërmjet nxënësve dhe ndërmjet feve, duke përfshirë këtu edhe çështjen e mbajtjes së anës në lidhje me një çështje, në mënyrë që mësuesi të mos ndihet i kompromentuar ose nxënësit të mendojnë që ka diçka të fshehtë në lidhje me të.
- ▶ Si të nxiten nxënësit të dëgjojnë pikëpamjet e të tjerëve, që ata të mësojnë t'i respektojnë të tjerët, të çmojnë opinionet e tyre dhe të mësojnë vetë përmes reflektimit për besimet dhe vlerat e të tjerëve.
- ▶ Si të menaxhojnë çështjet kundërshtuese, veçanërisht ato që lidhen me paraqitjen e botëkuptimeve fetare dhe jofetare edhe vetë, në mënyrë që mësuesit të mos ndihen të kompromentuar ose të prekshëm ndaj kritikizmit për njëanshmëri ose paaftësi.

Si ndikon tek mua kjo çështje?



- ▶ Unë duhet të jem i hapur ndaj mundësisë së të mësuarit nga larmia fetare që më rrethon.
- ▶ Unë duhet të jem i duruar dhe dëgjues me mendje të hapur.
- ▶ Unë duhet të jem i gatshëm për të shqyrtuar me kujdes çështjet e vështira dhe kundërshtuese, në mënyrë të veçantë, ato që lidhen me larminë fetare dhe ndryshimet që ekzistojnë në lidhje me pretendimet për të vërtetën.

Si ndikon kjo në mësimdhënien time?



- ▶ Unë duhet të jem i gatshëm për të mësuar të rinjtë në mënyrë që ata të jenë në gjendje të shprehin pikëpamjet dhe besimet e tyre dhe të dëgjojnë njëri-tjetrin me vëmendje dhe plotësisht.
- ▶ Unë duhet të jem i gatshëm për të menaxhuar diskutimet për çështjet kundërshtuese dhe të pranoj –dhe këtë t’ua komunikoj nxënësve- që marrëveshjet dhe përgjigjet përfundimtare mund të jenë të paarrtshme.
- ▶ Unë duhet të sfidoj të rinjtë të shprehin pikëpamjet për materialet kundërshtuese, duke ngulur këmbë, njëherazi, në ndjeshmërinë e tyre dhe në mbrojtjen e tyre nga pandjeshmëria e të tjerëve.

Çfarë mund të bëj unë si mësues?



- ▶ Unë mund të vendos rregulla të përbashkëta me nxënësit, për të nxitur dhe mbështetur paraqitjen dhe interpretimin e ndershëm e të paanshëm të botëkuptimeve fetare dhe jofetare si dhe të nxis dialogun për trajtimin e çështjeve kundërshtuese në një hapësirë të sigurt.
- ▶ Unë mund të mishëroj vlerat që janë në themel të parimit të paraqitjes dhe të interpretimit të paanshëm të botëkuptimeve fetare dhe jofetare dhe të dialogut për të ndryshmet, duke vepruar me ndershmëri dhe paanshmëri si mësues, duke ndërtuar një kulturë klase në të cilën të gjithë nxënësit të ndihem plotbesim për të folur dhe për të dëgjuar. Unë mund të krijoj një shembull demokracie tek nxënësit.
- ▶ Unë mund të ndaj këto vlera dhe praktika me kolegët e mi, me prindërit dhe anëtarë të tjerë të komunitetit të shkollës, duke u shpjeguar çfarë kuptohet me paraqitje dhe interpretim i ndershëm dhe i paanshëm i botëkuptimeve fetare dhe jofetare dhe me dialog për trajtimin e çështjeve kundërshtuese në një mjedis të sigurt.

Çfarë duhet të zhvilloj?



- ▶ Unë duhet të zhvilloj njohuritë dhe të kuptuarit e botëkuptimeve të ndryshme fetare dhe jofetare dhe për larminë ndërmjet dhe brenda tyre, për të qenë në gjendje t’ua paraqes nxënësve dhe t’i nxis ata t’i interpretojnë këto në mënyrë të ndershme.
- ▶ Unë duhet të zhvilloj aftësitë në menaxhimin e diskutimit të çështjeve kundërshtuese, duke nxitur nxënësit të marrin pjesë në dialogët për të ndryshmen dhe duke këmbëngulur që ata të dëgjojnë dhe të flasin me njëri-tjetrin me respekt.
- ▶ Unë duhet të zhvilloj një numër metodash të mësimdhënies që nxisin kërkimin në larminë kulturore si dhe shkëmbimin e këndvështrimeve të ndryshme ndërmjet të rinjve. Kjo do të thotë që unë duhet të mbaj parasysh edhe organizimin e klasës dhe të materialeve të paraqitura në të: A e lehtëson organizimi i klasës komunikimin ndërmjet nxënësve, përveç mësuesit? A ndihmojnë materialet e paraqitura në klasë kuptimin e idesë se pikëpamjet dhe besimet e njerëzve janë të ndryshme dhe duhen respektuar? A ekzistojnë rregulla bazë që mundësojnë shprehjen e qartë të ideve në një diskutim?

VEPRIMTARIA 1 – TË KUPTOJMË DHE TË PËRDORIM QASJEN INTERPRETUESE

Fokus

Qëllimi i kësaj veprimtarie është të ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë qasjen interpretuese dhe ta përdorin atë në planifikimin e një mësimi. Veprimtaria përfshin analizën e tekstit që përmbledh përdorimin e qasjes nga një mësues dhe, më pas, planifikimin e një mësimi ose të disa mësimëve për moshë dhe kontekste të ndryshme.

Këshilla

- ▶ Kjo mund t'ju ndihmojë në fotokopjimin e materialeve më poshtë në një faqe A3, për të pasur hapësirën e mjaftueshme për shënime të pjesëmarrësve.
- ▶ Ju mund të keni nevojë edhe për thekues në ngjyra të ndryshme.
- ▶ Ju mund të keni paraprakisht të përgatitura në power-point ose në tabakë të mëdhenj përmbledhjen dhe pyejtet vijuese.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të ndërtojnë njohuritë dhe të kuptuarit e qasjes interpretuese;
- ▶ do të mësojnë të përdorin qasjen interpretuese në planifikimin e një mësimi

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Aftësitë e të menduarit kritik, empatia.
- ▶ Respekti, toleranca ndaj paqartësisë, të qenit i hapur ndaj besimeve dhe botëkuptimeve të tjerëve.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të botëkuptimeve fetare dhe jofetare dhe njohuritë dhe të kuptuarit kritik të komunikimit.

Procedura/hapat

1. Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të rilexojnë në materiale (më poshtë) shënimet e Kevin O'Grady për mësimin që përdor qasjen interpretuese
10 minuta

2. Në vijim, trajneri u kërkon pjesëmarrësve t'u rikthehen shënimeve dhe të nënvizojnë e të bëjnë shënime në tekst. Ata duhet të përdorin një ngjyrë për të nënvizuar pjesët që trajtojnë mënyrën si portretizohen dhe paraqiten fetë tek nxënësit, një ngjyrë tjetër për pjesët që kanë të bëjnë me mënyrën si interpretohen gjuha dhe simbolet fetare nga nxënësit dhe një ngjyrë tjetër për të nxjerrë në pah mënyrën si nxënësit i përgjigjen të mësuarit të tyre për fetë. Në çdo rast, ata duhet të shënojnë shkurt si e siguron mësimdhënia zbatimin në praktikë të parimeve që lidhen me këto çështje.

30 minuta

3. Trajneri kërkon nga çdo pjesëmarrës të shprehë mendimin e tij, duke diskutuar me rradhë për secilin nga parimet e qasjes interpretuese dhe për mënyrën si mësimdhënia synoi ta zbatonte atë në praktikë. Trajneri bën kujdes për qartësimin e të gjitha pyetjeve ose të çështjeve që ngrihen në diskutim.

15 minuta

4. Trajneri sqaron pjesëmarrësit që mësimi i Kevin O'Grady është planifikuar për fëmijët e moshës 12-13 vjeç në lidhje me Islamin, duke përdorur tre parimet e qasjes interpretuese. Duke punuar në çifte, pjesëmarrësit duhet të planifikojnë një mësim (ose të skicojnë një numër mësimesh), duke përdorur të njëjtët parime, por duke i përshtatur ata për një moshë tjetër ose për një tjetër traditë fetare.

45-60 minuta

Përmbledhje dhe vijim

Trajneri u kërkon çifteve të pjesëmarrësve të paraqesin për diskutim planin e mësimit ose të mësimëve të përgatitura më sipër. Ndërkohë që grupet diskutojnë, trajneri përdor pyetjet e mëposhtme si një listë konfirmimi:

- ▶ A siguron mësimi paraqitjen e drejtë të botëkuptimeve fetare dhe jofetare?
- ▶ A u jepet nxënësve mundësia të interpretojnë gjuhën dhe simbolet fetare dhe jofetare, duke bërë pyetje të tilla si: çfarë mund të nënkuptojë ato për njerëzit që lidhen me to?
- ▶ A kanë nxënësit mundësinë t'u përgjigjen pyetjeve eksploruese për të mësuarit e tyre, të tilla si: Çdo
- ▶ të thotë kjo për mua ose cila është ngjashmëria ose ndryshimi me mënyrën time të jetesës?

45-60 minuta

Materiale

— Këto janë shënimet e Kevin O'Grady për mësimin që përdor qasjen interpretuese (nga *Udhërrëfytyesi*, faqe 41).

- ▶ Unë ideova një projekt veprimi kërkimor me një klasë për një periudhë 12 javore, duke përdorur vëzhgimin në klasë, intervistat në grup dhe analizën e ditareve të disa nxënësve. Nxënësit ndihmuan në kërkim, duke bërë të qarta interesat dhe parapëlqimet e tyre. Në këtë mënyrë, ata ndihmuan në planifikimin e punës për Islamin. Nxënësit shënuan në ditar idetë e reja dhe vlerësimet hap pas hapi të punës së tyre. Ata shkruan edhe përgjigjet për pyetjet që unë u kisha drejtuar në intervistat në grup.
- ▶ Unë analizova shënimet në ditar dhe rishikova programin e studimit duke marrë parasysh idetë e nxënësve. Idetë e shprehura në ditare sugjeruan edhe qasjen e studimit të Islamit që lidhej me temat që u interesonin, në mënyrë të veçantë, fëmijëve.
- ▶ Unë kalova nga interesi vetjak i nxënësve për veshjen dhe modën (një temë e zakonshme në ditaret e tyre) në pyetjet për veshjen Islame, duke përdorur shembuj të zgjedhur nga ngjarjet e ofruara nga media dhe duke i lidhur me Islamin në përgjithësi. Interesi për kuptimin simbolik të veshjeve dhe tërheqja ndaj modës dëshmonte për interesin e nxënësve ndaj veshjeve islamike. Interesa të tillë u morën parasysh në planet tona mësimore. Po kështu, në këto plane u përfshinë edhe puna për qëndrimet e nxënësve ndaj veshjeve dhe krahasimi me kodet islamike. Tema në tërësinë e saj bazohej në synimin që materiali islamik do të nxiste rivlerësimin e qëndrimeve të nxënësve në lidhje me veshjet, me jetën familjare ose me çështje të tjera të ngritura prej tyre.
- ▶ Nxënësit vlerësuan të rëndësishme veprimtari të tilla si arti, të shkruarit krijues dhe diskutimin e videove, por veprimtaria më popullore për eksplorimin e çështjeve ishte drama. Çështjet e ngritura kishin të bënin me islamin (për myslimanët, besimet dhe konceptet islamike) dhe me individët dhe shoqërinë (çështje personale dhe fetare dhe çështje për shoqërinë dhe botën e gjerë).
- ▶ Ditaret e nxënësve dhe vëzhgimet e mia vërtetuan rëndësinë që nxënësit i jepnit të mësuarit për vete si dhe për Islamin. Prej tyre u ngritën edhe pyetje për racat dhe identitetin etnik dhe u shfrytëzuan mundësitë për eksplorimin e tyre të mëtejshëm, duke ndihmuar në edukimin ndërkulturor dhe qytetar si dhe në studimin e feve.
- ▶ Veprimtaritë imagjinuese të ideura nga nxënësit, për shembull, në rastin e veshjes islame, përfshinë analizën e marrëdhënieve ndërmjet veshjes dhe bullingut, kërkimet për kodet e veshjeve islamike dhe përdorimin e dramës për të eksploruar ndjenjat që lindin në rastin e ndalimit të një veshjeje fetare në shkollë. Është për t'u vlerësuar fakti që, në diskutimet që vijuan këto veprimtari, nxënësit treguan shkallë të lartë pjekurie.
- ▶ Çështje të tjera që u diskutuan ishin dhe ato që lidheshin me paraqitjen e Islamit si fe dhe e individëve myslimanë në kontekstin e shkollës, të familjes dhe në portretizimet e medias. Po kështu, gjatë diskutimit të kuptimit të koncepteve dhe të simboleve kryesore (si dhe të veshjeve) u morën parasysh edhe çështjet e interpretimit. Gjatë trajtimit të interesave dhe shqetësimeve personale të nxënësve dhe të ngjashmërisë së tyre me shembuj nga Islami u qëndrua edhe në reflektimet e nxënësve për veten, vlerat, ndjenjat, motivet e tyre.

VEPRIMTARIA 2 – TË KUPTOJMË DHE TË PËRDORIM QASJEN DIALOGUESE

Fokus

Qëllimi i kësaj veprimtarie është të ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë qasjen interpretuese dhe ta përdorin atë në planifikimin e një mësimi. Veprimtaria përfshin pjesëmarrësit në përdorimin e disa prej teknikave të zhvilluara nga Julia Ipgrave dhe diskutimin për vendin dhe mënyrën e përfshirjes së tyre në kurrikulën e shkollës si dhe, ku është e mundur, përdorimin e teknikës me nxënësit në shkollë.

Këshilla

Ju duhet të fotokopjoni, paraprakisht, materialet më poshtë për grupin dhe të përgatisni karta me pohime provokuese për veprimtarinë "Qarku".

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të ndërtojnë njohuritë dhe të kuptuarit e qasjes dialoguese;
- ▶ do të shpjegojnë ku dhe si mund të përdorin qasjen dialoguese në kurrikulën shkollore.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ aftësitë e të menduarit analitik dhe kritik, empatia.
- ▶ Respekti, toleranca ndaj paqartësisë, të qenit i hapur ndaj besimeve dhe botëkuptimeve të tjerëve.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të botëkuptimeve fetare dhe jofetare dhe njohuritë dhe të kuptuarit kritik të komunikimit.

Procedurat/hapat

1. Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të rilexojnë përmbledhjen e mësimdhënies së Julia Ipgrave në Material e më pas të diskutojnë shkurt për pika ose çështje që mund të lindin nga leximi.

10 minuta

2. Në vijim, trajneri fton grupin të provojë lojën me role "tigrin njerëzor". Loja me role duhet të vijojë me diskutime edhe gjatë kohës së lojës, përmes një drejtuesi që u kërkon personazheve me radhë të japin komente për arsyet e pikëpamjes së tyre, për mënyrën si ata arritën tek këto arsye, për arsyet përse njerëz të tjerë mund të mos jenë dakord me ta dhe nëse këta të tjerë po thonë diçka. Çdo pjesëmarrës duhet t'i kërkohej të përmbledhë atë që ka mësuar përmes kësaj veprimtarie.

45 minuta

3. Pas diskutimit të veprimtarisë, trajneri diskuton me pjesëmarrësit për vendin dhe mënyrën e përshtatjes së kësaj veprimtari në kurrikulën ose në praktikën mësimore të shkollës së tyre. Ai u kërkon atyre ta provojnë atë në klasë me nxënësit dhe ndoshta, në të ardhmen, nëse do të kenë mundësi, të ndajnë me të tjerët përvojën e tyre.

25 minuta

Përmbledhje dhe vijim

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të përpiqen ta provojnë këtë veprimtari dialoguese në grup, përpara se ta provojnë atë me të rinjtë në mjedise të tjera mësimore. Për këtë qëllim, pjesëmarrësit kanë nevojë për gjashtë karta me pohime provokuese, p.sh.:

- ▶ Jeta nuk ka qëllim të paravendosur.
- ▶ Kur vdisni, vdisni dhe ky është fundi.
- ▶ Martesa duhet të zgjasë gjatë gjithë jetës.
- ▶ Fëmijët duhet të ndjekin besimin e prindërve të tyre.
- ▶ Nuk ka zot!
- ▶ Universi nuk mund të jetë krijuar nga asgjëja, duhet të ketë një krijues.

Pjesëmarrësit ulen në një reth. Secili prej tyre merr një kartë dhe bashkë me të edhe përgjegjësinë për të drejtuar diskutimin për kartën e tij. Ai duhet të sigurojë që çdo person është në gjendje të përgjigjet, ndërsa të tjerët të dëgjojnë me vëmendje. Përsëri, folësit duhet të japin komente për arsyet e pikëpamjes së tyre, për mënyrën si arritën në këto arsye, për arsyet përse njerëz të tjerë mund të mos jenë dakord me ta dhe nëse këta të tjerë po thonë diçka. Në fund, çdo pjesëmarrës duhet të përmbledhë ato që mësoi përmes kësaj veprimtarie.

60 minuta

Material

— Kjo është një përmbledhje e një aspekti të mësimdhënies së Julia Ipgrave që përdor qasjen dialoguese (nga Udhërrëfytyesi, faqe 43).

— Fëmijët u nxitën:

- ▶ të reflektojnë për kontributin e tyre dhe të justifikojnë opinionet e tyre (Përse mendoni në këtë mënyrë?);
- ▶ të shqyrtojnë si mbërritën në këto përfundime (Si arritët në këtë përgjigje?);
- ▶ të pranojnë mundësinë e një pikëpamje të ndryshme (A mund të jepni disa arsye përse disa njerëz mund të mos jenë dakord me atë që thatë ju?);
- ▶ të jenë të hapur ndaj argumenteve të tjerëve (A mendoni se tjetri ka thënë diçka?);

— Loja me role u përdor për të ndihmuar nxënësit të përballen me pikëpamje të ndryshme. Në këtë veprimtari, fëmijët (si individë ose në grup) duhet të argumentonin një rast nga këndvështrimi i një interesi të caktuar. Për shembull, në diskutimin nëse duhet të vritet ose të gjuhet një tigër njerëzgjatës, fëmijët 9- vjeçarë morën rolet e një mbrojtësi të natyrës, të një turisti, të një punonjësi të qeverisë, të një babai të hidhëruar. Kjo veprimtari ndihmon fëmijët të dallojnë që vlerat e tyre mund të mos jenë të njëjta me vlerat e fëmijëve të tjerë, megjithatë mund të kenë shuma pika të përbashkëta me to dhe me vlerat e pranuarat të drejtave të njeriut.


Pohime provokuese të përdorura në veprimtarinë “rrethi”

- ▶ Jeta nuk ka qëllim të paravendosur.
- ▶ Kur vdisni, vdisni dhe ky është fundi.
- ▶ Martesa duhet të zgjasë gjatë gjithë jetës.
- ▶ Fëmijët duhet të ndjekin besimin e prindërve të tyre.
- ▶ Nuk ka zot!
- ▶ Universi nuk mund të jetë krijuar nga asgjëja, duhet të ketë një Krijues.

Kapitulli 5


Klasa si hapësirë e sigurt

Çështje kyçe/situata




- ▶ Hapësira e sigurt është themelore për mësimdhënien në kuadrin e të drejtave të njeriut.
- ▶ Hapësira e sigurt nënkupton klimën e klasës ku të rinjtë ndihen të lirë dhe në gjendje të diskutojnë hapur së bashku për pikëpamjet e tyre, ku respektohen rregullat bazë për të dëgjuarit dhe për respektimin e të tjerëve.
- ▶ Mësuesit duhet të jenë jo gjykues dhe të paanshëm, të qartë për rregullat e pjesëmarrjes, të qetë, mbështetës dhe respektues në konflikte.
- ▶ Diskutimet duhet të lidhen me jetën personale të të rinjve.
- ▶ Kërkimet mbështesin pikat e mësipërme. Nxënësit dëshirojnë të kuptojnë fetë dhe botëkuptimet fetare dhe jofetare të njëri-tjetrit, besojnë në këtë mundësi, shikojnë shkollë si vendin ku kjo gjë mund të ndodhë dhe dëshirojnë të ndodhë në një klasë të sigurt me procedura të qarta dhe të pranuar diskutimi.

Kompetencat për kulturë demokratike



- ▶ Vlerësimi i demokracisë, i drejtësisë, i ndershmërisë, i barazisë dhe i shtetit të së drejtës.
- ▶ Aftësitë e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit.
- ▶ Aftësitë për të bashkëpunuar.
- ▶ Respekti, toleranca ndaj paqartësisë, të qenit i hapur ndaj besimeve dhe botëkuptimeve të të tjerëve.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të komunikimit

Çështjet kundërshtuese për t'u marrë në shqyrtim nga mësuesi



- ▶ Ndryshimet në fe dhe në botëkuptime mund të shkaktojnë emocione të forta. Ato mund të jenë të ndjeshme edhe politiksht. Disa mosmarrëveshje ndërmjet të rinjve janë të pashmangshme.
- ▶ Çështjet që shfaqen nga studimi i botëkuptimeve fetare dhe jofetare mund të shkaktojnë kundërshti, p.sh.: A ka zot apo jo? A ka kuptim jeta? A mund të jetë e drejtë të marrësh një jetë? Ka dhe shumë çështje të tjera që janë sfiduese dhe prodhojnë qëndrime të ndryshme.



Si ndikon tek mua kjo çështje?




- ▶ Unë duhet të jem i ndjeshëm në prani të larmisë që më rrethon dhe ndaj mundësisë së kundërshtive që ajo mund të krijojë.
- ▶ Unë duhet të jem i përkushtuar ndaj menaxhimit paqësor të pikëpamjeve kundërshtuese dhe atyre në konflikt.
- ▶ Aftësitë e mia të të dëgjuarit, të të reflektuarit dhe të arsyetuarit do të bëhen më të rëndësishme.

Si ndikon kjo në mësimdhënien time?



- ▶ Unë duhet të jem i gatshëm për të mësuar të rinjtë në mënyrë që ata të jenë në gjendje të shprehin pikëpamjet dhe besimet e tyre dhe të dëgjojnë njëri-tjetrin me vëmendje dhe plotësisht.
- ▶ Unë duhet të jem i gatshëm për të menaxhuar diskutimet për çështjet kundërshtuese dhe të pranoj dhe këtë t'ua komunikoj nxënësve, që marrëveshjet dhe përgjigjet përfundimtare mund të jenë të paarrtshme.
- ▶ Unë duhet të sfidoj të rinjtë të shprehin pikëpamjet për materialet kundërshtuese, duke ngulur këmbë, njëherazi, në ndjeshmërinë e tyre dhe në mbrojtjen e tyre nga pandjeshmëria e të tjerëve.

Çfarë mund të bëj unë si mësues?



- ▶ Unë mund të vendos rregulla të përbashkëta me nxënësit, për të nxitur dhe për të mbështetur diskutimin e çështjeve kundërshtuese në një hapësirë të sigurt.
- ▶ Unë mund të mishëroj vlerat që janë në themel të klasës si një hapësirë e sigurt, duke vepruar me ndershmëri dhe në mënyrë të paanshme, duke ndërtuar një kulturë klase në të cilën të gjithë nxënësit të ndihen besimplotë për të folur dhe për të dëgjuar. Unë mund të krijoj një shembull demokracie tek nxënësit.
- ▶ Unë mund të ndaj këto vlera dhe praktika me kolegët e mi, me prindërit dhe anëtarë të tjerë të komunitetit të shkollës, duke u shpjeguar çfarë kuptohet me klasë si një hapësirë e sigurt dhe si unë përpiqem ta bëj klasën time një hapësirë të sigurt.

Çfarë duhet të zhvilloj?



- ▶ Unë duhet të zhvilloj njohuritë dhe të kuptuarit e botëkuptimeve të ndryshme fetare dhe jofetare, për të qenë në gjendje t'i paraprij larmisë që mund të shfaqet në klasën time dhe për të qenë i gatshëm për menaxhimin e saj.
- ▶ Unë duhet të zhvilloj aftësitë në menaxhimin e diskutimit, të nxis të rinjtë të marrin pjesë dhe të ngulin këmbë për të dëgjuar me respekt njëri-tjetrin.
- ▶ Unë duhet të zhvilloj një numër metodash të mësimdhënies që nxisin shkëmbimin e këndvështrimeve të ndryshme ndërmjet të rinjve. Kjo do të thotë që unë duhet të mbaj parasysht edhe organizimin e klasës dhe të materialeve të paraqitura në të:
- ▶ A e lehtëson organizimi i klasës komunikimin ndërmjet nxënësve, përveç mësuesit? A e ndihmonjë materialet e paraqitura në klasë kuptimin e idesë se pikëpamjet dhe besimet e njerëzve janë të ndryshme dhe duhen respektuar? A ekzistojnë rregulla bazë që mundësojnë shprehjen e qartë të ideve në një diskutim?

VEPRIMTARIA 1 – SKENARI: LETËR DREJTUAR PRINDËRVE

Fokus

Qëllimi i kësaj veprimtarie është të përgatisë pjesëmarrësit për mesimdhënie në një çështjeje kundërshtuese.

Komunikimi me prindërit mund të jetë një mundësi e mirë për këtë qëllim dhe të menduarit për realizimin e tij do të ndihmojë pjesëmarrësit të qartësojnë vlerat dhe qëllimet e tyre. Veprimtari kërkon shkrimin me kujdes të një letre për prindërit për t'i informuar ata në lidhje me planifikimin e mësimit, për t'i ftuar në diskutim dhe për të aftësuar prindërit të mbështesin shkollën.

Këshilla

- ▶ Zgjedhja e çështjes kundërshtuese mund t'i ndihmojë pjesëmarrësit të reflektojnë për çështje të tjera që kanë shkaktuar kundërshtitë në procesin mësimor, në shkollë ose në lajme. Cilat janë problemet e veçanta ose të ndjeshme që kanë ngritur këto çështje dhe përse ka ndodhur një gjë e tillë?
- ▶ Në hartimin e letrës, pjesëmarrësit duhet të vendosin veten në vendin e prindërve të cilët do ta marrin atë. Si mund të ndjehen prindërit? Cilat mund të jenë disa prej pyetjeve që ata mund të ngrenë dhe për çfarë mund të kërkojnë sqarime të mëtejshme?
- ▶ Kjo veprimtari do të ndihmojë në shqyrtimin e përgjigjeve të ndryshme të prindërve, për shembull, nga prindërit që bëjnë pjesë në komunitete të ndryshme kulturore ose fetare.
- ▶ Koha e sugjeruar për këtë veprimtari është e përafërt: për shembull, kur nuk zhvillohen më diskutime, mund të jetë e nevojshme që të lihet më shumë kohë për t'i nxitur ato. Por nëse ju jeni të sigurt që procesi i të mësuarit është realizuar dhe pikat kryesore të tij janë trajtuar, atëherë mund të kalohet në hapin tjetër. Zakonisht, në praktikë, koha varet edhe nga madhësia e grupit.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të bëhen të vetëdijshëm për problemet e mundshme dhe ndjeshmëritë e mundshme që mund të lindin gjatë mesimdhënies së çështjeje kundërshtuese;
- ▶ do të fitojnë përvojë dhe do të ushtrohen
- ▶ për të komunikuar me prindërit dhe për të
- ▶ kërkuar mbështetjen e tyre .

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Vlerësimi i demokracisë, i drejtësisë, ndershmërisë, i barazisë dhe i shtetit të së drejtës.
- ▶ Aftësitë e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit. Aftësitë për të bashkëpunuar.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të komunikimit.

Procedurat/hapat

1. Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të përfytyrojnë që po përgatën për mesimdhënien e një çështjeje kundërshtuese në një periudhë mësimore dy deri tri javë dhe kanë vendosur të vënë në dijeni prindërit për këtë qëllim (qëllimi është të shmangen keqkuptimet, të mbrohen nga lëndimet emocionale dhe të sigurojnë mbështetjen e tyre). Ai u kërkon atyre të zgjedhin një çështje që ata mendojnë se është e rëndësishme në kontekstin e tyre (shembuj: a duhet të lejohet paraqitja e simboleve fetare në një mjedis publik? A është pacifizmi mënyra më e mirë për të zgjidhur ose parandaluar konfliktet?). Për këtë detyrë, pjesëmarrësit mund të punojnë në dyshe.

20 minuta

2. Trajneri fton pjesëmarrësit t'i shpjegojnë grupit me rradhë zgjidhjen e tyre për çështjen kundërshtuese, duke u përgjigjur edhe pyetjeve që mund të lindin. Pas kësaj ata duhet të shkruajnë letrën duke u bazuar në pyetjet e mëposhtme:

- ▶ Çfarë do të themi për qëllimet dhe sjelljen e planifikuar për këtë mësim?
- ▶ Cilat janë mesazhet kryesore që duhet të komunikojmë në mënyrë të paanshme dhe të sigurt?
- ▶ A do të ftohen prindërit në shkollë për të diskutuar me ne për mësimet e planifikuara, nëse ata e dëshirojnë një gjë të tillë?
- ▶ A do të lejohen prindërit të tërheqin fëmijët e tyre nga mësimet nëse parapëlqejnë një gjë të tillë dhe cilat mund të ishin disa nga alternativat e tjera që mund të merren parasysh?

Përsëri, pjesëmarrësit duhet të mendojnë për qëndrimet e mundshme të prindërve që bëjnë pjesë në komunitete të ndryshme. Për të mundësuar shqyrtimin me kujdes të çështjeve të mësipërme, letra duhet të rishikohet disa herë.

60 minuta

Përmbledhje dhe vijim

Pasi të kenë përfunduar letrat, pjesëmarrësit duhet t'i lexojnë ato me zë të lartë dhe të diskutohen me të gjithë grupin. Pyetjet ku do të bazohet diskutimi janë ato të hapit të dytë. A janë komunikuar qartë qëllimi dhe përmbajtja e planifikuar e mësimit? A janë komunikuar qartë mesazhet për paanshmërinë dhe sigurinë? A janë të qarta pikat për diskutime të mundshme me prindërit për mundësinë e tërheqjes së fëmijëve të tyre? A janë marrë parasysh qëndrimet e mundshme të prindërve?

Letra duhet të përfundojë pas diskutimit të këtyre çështjeve.

20 minuta



Fletë pune

■ Përfytyroni që po përgatisni një mësim për trajtimin e një çështjeje kundërshtuese gjatë një periudhe mësimore prej dy deri tre javë dhe keni vendosur të vini në dijeni prindërit për këtë (qëllimi juaj është të shmangni keqkuptimet, t'i mbron nxënësit nga ndjeshmëritë e mëdha. Zgjidhni një çështje që mendoni se është e rëndësishme në kontekstin tuaj (shembuj: A duhet të lejohet paraqitja e simboleve fetare në mjedise publike? A bën feja më shumë dëm apo mirë? A është pacifizmi mënyra më e mirë për të trajtuar konfliktet?). Shkruani draftin e parë të letrës, dhe bëhuni gati të jepni shpjegime dhe të diskutoni për përmbajtjen e saj. Merrni parasysh çështje të tilla si:

■ Çfarë do të thoni për qëllimet dhe veprimtaritë e planifikuara të mësimit?

■ Cilat janë mesazhet kryesore që duhet të komunikojmë në mënyrë të paanshme dhe të sigurt?

■ A do të ftohen prindërit në shkollë për të diskutuar me ne për mësimet e planifikuara, nëse ata e dëshirojnë një gjë të tillë?

■ A do të lejohen prindërit të tërheqin fëmijët e tyre nga mësimet nëse parapëlqejnë një gjë të tillë dhe cilat mund të ishin disa nga alternativat e tjera që mund të merren parasysh?

VEPRIMTARIA 2 – RREGULLAT E KLASËS

Fokus

Qëllimi i kësaj veprimtarie është të vendosë për rregulla të qarta për diskutimin e çështjeve kundërshtuese në klasë, si bazë e efektshme për të bërë klasën një hapësirë të sigurt.

Veprimtaria kërkon përgatitjen e një posteri që do të vendoset në një vend të dukshëm në klasë dhe do të përmbajë rregullat, për t'ia kujtuar të rinjve sa herë të jetë e nevojshme.

Këshilla

- ▶ Pjesëmarrësve u sugjerohet që, gjatë hartimit të rregullave në praktikën e shkollës, të konsultohen me të rinjtë edhe për rregullat që sigurojnë hapësirën e sigurt.
- ▶ Gjatë identifikimit të rregullave, pjesëmarrësve mund t'u kërkohet të vënë veten në vendin e të rinjve të moshave të ndryshme duke u bërë pyetje të tilla:
 - A janë rregullat të rëndësishëm dhe të qartë?
 - A janë këta rregulla të tillë që të rinjtë do të jenë në gjendje t'i respektojnë dhe t'i zbatojnë?
 - A mendoni se ato do të ndihmojnë në ruajtjen e hapësirë të sigurt në klasë?

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit e kushteve të nevojshme për të mbajtur klasën si një hapësirë të sigurt;
- ▶ do të shpjegojnë dhe do të tregojnë me shembuj menaxhimin e klasës si një mjedis i sigurt;
- ▶ do të zhvillojnë aftësitë e komunikimit me të rinjtë.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Vlerësimi i demokracisë, i drejtësisë, ndershmërisë, i barazisë dhe i shtetit të së drejtës.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të komunikimit.

Procedurat/hapat

1. Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të mendojnë për rregullat e klasës, të nevojshme për krijimin dhe ruajtjen e një hapësire të sigurt në klasë dhe për të bërë sugjerime të tjera nëse është e nevojshme. Trajneri shënon në tabelë ose në një tabak letre sugjerimet e pjesëmarrësve dhe pasi i diskuton ato me ta, u komunikon idetë e mëposhtme për rregullat (këto mund të shkruhen paraprakisht në një slide ppt, së bashku me pyetjet që do të vijojnë në hapin 2):
 - ▶ Dëgjoni në qetësi dhe me kujdes këdo që flet.
 - ▶ Prisni derisa të jeni i qartë që folësi ka mbaruar përpara se të përgjigjeni.
 - ▶ Filloni përgjigjen tuaj me diçka pozitive të asaj që folësi ka thënë.
 - ▶ Mos përdorni kurrë komente personale për folësin, për prejardhjen ose fenë e tij.
 - ▶ Nëse dëshironi t'i drejtoni folësit një pyetje në lidhje me atë që ka thënë, në fillim kërkonte leje prej tij.
 - ▶ Nëse dikush zgjedh të mos i përgjigjet një pyetjeje, respektoni lirinë për ta bërë këtë.

Jepuni pjesëmarrësve pak kohë për të bërë pyetje për t'u shprehur për çdo rregull.

20 minuta

2. Trajneri fton pjesëmarrësit të përgatisin një poster për ta shfaqur në klasë, me titull "Hapësirë e sigurt" dhe të japin rregulla të qarta për sjelljen dhe diskutimet. Ata mund të shqyrtojnë rregullat e sugjeruara më sipër, të shtojnë të tjera nga vetja dhe, në fund, të rendisin rregullat sipas rëndësisë. Po kështu, pjesëmarrësit mund të japin sugjerime edhe për mënyrën e paraqitjes së posterit (p.sh. nëse posteri duhet të ketë edhe figura në të). Pjesëmarrësit duhet të mbajnë gjithmonë parasysh pyetjet:
 - ▶ A janë rregullat të rëndësishme dhe të qarta?
 - ▶ A janë këto rregulla të tilla që të rinjtë do të jenë në gjendje t'i respektojnë dhe t'i zbatojnë?
 - ▶ A mendoni se ato do të ndihmojnë në ruajtjen e hapësirës së sigurt në klasë?

Pjesëmarrësit mund të punojnë në dyshe për realizimin e kësaj detyre.

30 minuta

Përmbledhje dhe vijimësi

Pasi të kenë përfunduar posterat, pjesëmarrësit duhet t'i paraqesin dhe t'i diskutojnë me të gjithë grupin. Pyetjet ku do të bazohet diskutimi janë ato të hapit të dytë.

- ▶ A janë rregullat të rëndësishme dhe të qarta?
- ▶ A janë këto rregulla të tilla që të rinjtë do të jenë në gjendje t'i respektojnë dhe t'i zbatojnë?
- ▶ A mendoni se ato do të ndihmojnë në ruajtjen e hapësirës së sigurt në klasë?

30 minuta

Fletë pune

■ Ideoni një poster për ta paraqitur në klasë, me titull “Hapësirë e sigurt” dhe jepni rregulla të qarta për menaxhimin e diskutimeve. Kjo mund t’ju ndihmojë të merrni parasysh sugjerimet në vijim, të shtoni të tjera nga vetja dhe në fund të rendisni rregullat sipas rëndësisë së tyre. Jini gati për të diskutuar idetë tuaja:


- ▶ Dëgjoni në qetësi dhe me kujdes këdo që flet.
- ▶ Prisni derisa të jeni i qartë që folësi ka mbaruar përpara se të përgjigjeni.
- ▶ Filloni përgjigjen tuaj me diçka pozitive të asaj që folësi ka thënë.
- ▶ Mos përdorni kurrë komente personale për folësin, për prejardhjen ose fenë e tij.
- ▶ Nëse dëshironi t’i drejtoni folësit një pyetje në lidhje me atë që ka thënë, në fillimi kërkoni leje prej tij.
- ▶ Nëse dikush zgjedh të mos i përgjigjet një pyetjeje, respektoni lirinë për ta bërë këtë.



Kapitulli 6


Paraqitja e fesë në media

Çështje kyçe/situata




- ▶ Sot, pjesa më e madhe e informacionit tek njerëzit vjen përmes internetit dhe medias pamore, të cilat vlerëohen si burime të besueshme informacioni.
- ▶ Pamjet me të cilat njerëzit ndeshen në median pamore ndikojnë në mendimet, ndjenjat dhe sjelljet e tyre ndaj njerëzve të kulturave dhe feve të tjera, shpeshherë pa qenë të vetëdijshëm për këtë ndikim.
- ▶ Gjuha dhe mendja e të rinjëve, në shkallë të madhe, ndikohet nga ligjërimet sunduese për fenë dhe politikën, në mënyrë të veçantë nga paraqitja e Islamit në median sunduese, gjë që rrit prirjen e qëndrimeve negative ndaj myslimanëve.
- ▶ Për këtë arsye, mësuesit duhet të aftësojnë nxënësit të përdorin mendjen dhe fjalët e tyre për të analizuar paraqitjen e feve në media.

Kompetencat për kulturë demokratike



- ▶ Njohuri dhe të kuptuarit kritik të gjuhës dhe të komunikimit
- ▶ Njohuri dhe të kuptuarit kritik të botës: politikën, ligjin, të drejtat e njeriut, kulturën, fetë, historinë, median etj.
- ▶ Hapja ndaj tjetrit dhe ndaj besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave të të tjerëve.
- ▶ Vlerësimi i demokracisë, drejtësisë, barazisë dhe shtetit të së drejtës.

Çështjet kundërshtuese për t'u marrë në shqyrtim nga mësuesi



- ▶ Si t'u përgjigjem kuptimeve/përmbajtjeve të ndryshme që lidhen me të njëjtin koncept/term?
- ▶ Si t'u përgjigjem pretendimeve të ndryshme e kundërshtuese për të vërtetën për fetë, individët, ngjarjet etj. në media?
- ▶ Si t'i bëj nxënësit të aftë të pranojnë, të përpiqen të kuptojnë dhe të vlerësojnë mënyra të tjera të të kuptuarit të koncepteve/termave dhe të reflektojnë për vetë të kuptuarit e tyre, si një hap i rëndësishëm drejt përpjekjeve të përbashkëta?
- ▶ Si të zgjedh burimet e informacionit që do të përdor si kriter për të qartësuar mesazhet e medias?

Si ndikon tek mua kjo çështje?



- ▶ Kjo sfidon aftësinë time si mësues për të përdorur pedagogjinë e duhur të trajtimit të çështjeve kundërshtuese dhe të ndryshme në klasë edhe në lidhje me mesazhet e medias/
- ▶ Kjo sfidon gatishmërinë time për të shqyrtuar dhe për të eksploruar çështjet kundërshtuese dhe, në mënyrë të veçantë, ato që lidhen informacionin nga media.

Si ndikon kjo në mësimdhënien time?



Nëse do të trajnohem unë do të jem i aftë dhe i gatshëm:

- ▶ për të shfrytëzuar në mënyrë kritike burimet e informacionit, duke përfshirë edhe autoritetet e ndryshme dhe burimet e medias.
- ▶ për të mësuar të rinjtë në mënyrë të tillë që të jenë të aftë shprehin pikëpamjet dhe besimet e tyre dhe të dëgjojnë plotësisht dhe me kujdes njëri-tjetrin.
- ▶ të menaxhoj diskutimin e çështjeve kundërshtuese dhe të pranoj e t'u komunikoj të rinjve mesazhin që ata mund të mos jenë në gjende të arrijnë në një marrëveshje ose në një përgjigje përfundimtare.
- ▶ të sfidoj, nëse është e nevojshme, mënyrën e të mësuarit të nxënësve, duke eksploruar, duke interpretuar dhe duke mbrojtur qëndrime në lidhje me materialet, temat dhe çështjet kundërshtuese etj.

Çfarë mund të bëj unë si mësues?



Unë mund:

- ▶ të paraqes një metodologji të qartë për studimin e botëkuptimeve fetare dhe jofetare, të koncepteve dhe termave që marrin parasysh shpjegimet e ndryshme të tyre.
- ▶ të nxis nxënësit të eksplorojnë kuptimet e ndryshme të termave teknikë dhe të arsyeve (vlerëve, interesave, qëndrimeve, mungesës së njohurive etj.) që qëndrojnë në themel të larmisë së kuptimeve.
- ▶ të jem një model/shembull i mirë i përfaqësimit dhe i interpretimit të paanshëm të feve, të koncepteve në raport me larminë dhe kundërshtitë që i shoqërojnë, duke vepruar ndërshtërisht dhe në mënyrë të paanshme si mësues.
- ▶ të ndihmoj nxënësit të analizojnë përplasjet kulturore dhe pamjet mediatike.
- ▶ të nxis tek nxënësit qasjen kritike ndaj përdorimit të internetit, duke u kërkuar atyre të jenë më të ndjeshëm ndaj stereotipave dhe mesazheve të nënkuptuara për njerëzit nga fe dhe kultura të ndryshme.
- ▶ të përzgjedh dhe të përshtas materiale të botuara për të plotësuar nevojat e nxënësve, duke i ndihmuar ata të analizojnë paraqitjen e feve në media.

Çfarë duhet të zhvilloj?



Unë mund të zhvilloj:

- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit e ndikimit të përmbajtjes së medias në gjykimin dhe sjelljen e individit.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit e pasojave që ka propaganda në botën e sotme.
- ▶ Aftësitë për të përdorur më shumë se një burim informacion përpara se të krijohet një opinion dhe të marr një vendim.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit për mënyrën se si mund të paraqiten dhe të mësohen historitë dhe ngjarjet në këndvështrimin etnocentrik.
- ▶ Vullnetin dhe gatishmërinë për të pranuar dhe për të eliminuar paragjykimet dhe stereotipat e mi.
- ▶ Materiale mësimore për të ndihmuar nxënësit në analizën e pamjeve media-tike, duke përfshirë shembuj nga fetë e jetesës së përbashkët, përfshirjen pozitive shoqërore dhe veprimin bashkëpunues ndërmjet komuniteteve të besimeve të ndryshme.
- ▶ Aftësinë dhe gatishmërinë time për të trajtuar pasaktësitë dhe për të përdorur qasje kritike ndaj paraqitjes së feve në media.

Veprimtari

Fokus

Këto veprimtari synojnë të ndërgjegjësojnë pjesëmarrësit për rolin e medias përtej misionit të saj si një burim i informacionit dhe si instrument i demokracisë. Kjo do të thotë që, si një instrument i mundshëm pushteti, që mund të përpunojë mendjen e njerëzve përmes ligjërimeve për fetë dhe politikën, duke prodhuar qëndrime negative ndaj njerëzve dhe feve të ndryshme, si dhe konflikte ndërmjet tyre.

Ato do të ndihmojnë pjesëmarrësit të kuptojnë më mirë rëndësinë e përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit për fetë, ngjarjet, njerëzit, për të krijuar opinione dhe gjykime mbi bazën e të qenit të mirëinformuar dhe të paanshëm.

Këshilla

Këto veprimtari mund të përdoren kurdo që në komunitetin e shkollës trajtohen çështje të medias që përfshijnë politikën, konfliktet, ngjarjet shoqërore, fetë ose individët. Këto veprimtari mund të përdoren kur lind nevoja për të reflektuar për mënyrën tonë të menduarit, për paragjykimet dhe kufizimet tona etj. Po kështu, trajnerët dhe pjesëmarrësit duhet të jenë të mirëinformuar për të ruajtur opinione dhe gjykime të paanshëm.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore.
- ▶ Të qenit i hapur ndaj besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave të tjerëve.
- ▶ Empatia

VEPRIMTARI 1 – SI I KRIJOJMË NE IDETË QË KEMI PËR NJERËZIT DHE NGJARJET?

Fokus

Kjo veprimtari synon të ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë ku e kanë bazën idetë e tyre për njerëzit, ngjarjet, politikën dhe fetë. Kjo synon t'i ndihmojë ata të reflektojnë për paragjykimet dhe stereotipat e tyre dhe të vënë në dyshim modelet e tyre të krijimit të ideve dhe njohurive.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit

- ▶ Do të zbulojnë ku e kanë bazën idetë e tyre për fetë, ngjarjet dhe njerëzit.
- ▶ Do të përshkruajnë, përmes shembujve të jetës së përditshme, rolin e dyfishtë të medias si mjet i demokracisë dhe i pushtetit
- ▶ Do të identifikojnë ndikimin që ka propaganda në mënyrën e tyre të të menduarit.
- ▶ Do të reflektojnë në mënyrë kritike për mënyrat se si njerëz të ndryshëm interpretojnë në mënyra të ndryshme të njëjtin informacion ose ngjarje.
- ▶ Do të vënë në dyshim autoritetet dhe median si burime informacioni.
- ▶ Do të përdorin më shumë se një burim informacioni përpara se të krijojnë një opinion ose të marrin një vendim.
- ▶ Do të ofrojnë shembuj pozitive për mënyrën si duhet të paraqiten dhe të interpretohen fetë dhe konceptet/termat, duke përfshirë edhe ato që lidhen me të ndryshmen dhe kundërshtitë, duke vepruar në mënyrë të ndershme e të paanshme.

Procedurat/hapat

Zhvillimi i veprimtarisë/hapat

1. Hapi i parë

Studim rasti

Trajneri u ofron pjesëmarrësve informacionin e mëposhtëm:

Një i ri, i pajisur me armë, hap zjarr në një kamp rinor dhe shkakton 84 të vdekur.

Trajneri kërkon nga pjesëmarrësit të shprehin reagimet e tyre të para për ngjarjen, të cilat mund t'i paraqesin në një tabak të madh letre ose në tabelë. Trajneri ndihmon pjesëmarrësit me anë të pyetjeve të mëposhtme:

- ▶ Cili mund të jetë personi që kreu këtë veprim?
- ▶ Cilat mund të kenë qenë shkaqet e mundshme të tij?
- ▶ Si i argumentoni hamendesimet tuaja?

2. Hapi i dytë

Trajneri informon pjesëmarrësit se nga lajmet e medias mësohet se “personi që qëlloi me armë ishte mysliman”.

Pas këtij informimi, trajneri indan pjesëmarrësit në tri grupe të mëdha, të cilët përfaqësojnë “myslimanët”, “të krishterët” dhe “ateistët” dhe kërkon prej tyre të diskutojnë dhe të shënojnë përgjigjet e tyre për pyetjet e mëposhtme në këndvështrimin e grupit që përfaqësojnë:

- ▶ Cili është mendimi juaj për ngjarjen dhe autorin e saj nga këndvështrimi i një “myslimani”?
- ▶ Cili është mendimi juaj për ngjarjen dhe autorin e saj nga këndvështrimi i një “të krishterit”?
- ▶ Cili është mendimi juaj për ngjarjen dhe autorin e saj nga këndvështrimi i një “ateisti”?

Pjesëmarrësit duhet të përpiqen të përshkruajnë autorin e ngjarjes nga këndvështrime të ndryshme (fizike, intelektuale, morale shoqërore etj.)

Në vijim grupet paraqesin përgjigjet për pyetjet dhe perceptimet e tyre për autorin e veprës. Trajneri duhet të përdorë pyetjet e mëposhtme për të nxitur një diskutim në lidhje me mënyrën e përshkrimit të ngjarjes dhe të autorit nga pjesëmarrësit dhe grupet.

- ▶ Ku e bazuat përkrimin që i bëtë në fillim autorit të ngjarjes?
- ▶ A ka ndikuar në këtë reagim dhe përshkrim të parë ndonjë përvojë paraprake?
- ▶ A dëshiron ndonjë nga ju të thotë diçka në lidhje me situatën dhe për mënyrën se si e njëjta ngjarje është përshkruar nga këndvështrime të ndryshme (të grupeve të ndryshme)?
- ▶ A përputhen idetë e tanishme për ngjarjen dhe autorin e saj me idetë që qenë rrjedhojë e reagimeve të para për to?

Përmbledhje dhe vijimësi

Trajneri i informon pjesëmarrësit që, sipas të dhënave të reja, personi përgjegjës për të shtënat nuk ishte mysliman, as i lidhur me ndonjë grup terrorist.

Ai i fton të gjitha grupet për të identifikuar stereotipat, paragjykimet dhe përgjithësimet e mundshme në mënyrat se si grupet e ndryshme përshkruan paraprakisht autorin e ngjarjes. Trajneri mund të përdorë pyetjet e mëposhtme për diskutim:

- ▶ A mundët të dalloni ndonjë stereotip ose paragjykim në diskutimet tuaja?
- ▶ Nëse po, sipas mendimit tuaj, cili është burimi i tyre?
- ▶ A patët ndonjë informacion paraprak për autorin e mundshëm të të shtënave?
- ▶ Cili është burimi i këtij informacioni?
- ▶ A keni dyshuar ndonjëherë në vërtetësinë e këtij informacioni?
- ▶ A keni menduar ose a jeni përpjekur ndonjëherë të përdorni burime të tjera informacioni përveç atij që është ofrua nga media?
- ▶ Cili është mendimi juaj tani në lidhje me reagimet tuaja të para e të menjëhershme?
- ▶ A do të ndryshoni ndonjë gjë në mënyrën se si u përgjigjët në fillim?
- ▶ A mendoni se duhet të ndryshoni diçka në mënyrën tuaj të të menduarit për çështje të tilla dhe të ngjashme me to?

VEPRIMTARI 2

Të mendojmë për mënyrën tonë të të mësuarit, të eksplorimit, të interpretimit, të përzgjedhjes ose të mbrojtjes së një qëndrimi të caktuar në lidhje me materialet, temat dhe çështjet kundërshtuese që trajtohen në media (por jo vetëm aty)

Fokus

Kjo veprimtari sunon të bëjë nxënësit të vetëdijshëm për rolin e medias, përtej misionit të saj si një burim informacion dhe një instrument i demokracisë, dmth. Si një instrument të mundshëm pushteti që mund të përdorë në mënyrë të padrejtë reagimet/përgjigjet etj., përmes ligjërimeve për fetë dhe politikën, duke prodhuar qëndrime negative ndaj njerëzve, feve dhe konflikteve ndërmjet tyre.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit


Pjesëmarrësit:

- ▶ Do të përshkruajnë, përmes shembujve të jetës së përditshme, rolin e medias në ditët e sotme, si një instrument i demokracisë dhe si mjet pushteti.
- ▶ Do të përshkruajnë ndikimet e propagandës në botën e some.
- ▶ Do të përshkruajnë mënyrat në të cilat media paraqet dhe interpreton fetë dhe ngjarjet që lidhen me to.
- ▶ Do të dyshojnë në autoritete dhe tek media si burime të informacioni.
- ▶ Do të shqyrtojnë në mënyrë kritike modelet fitimit të informacionit dhe të njohurive.

Procedurat/hapat

1. Hapi i parë


Trajneri i fton pjesëmarrësit të përdorin njohuritë e tyre paraprake për të dhënë ide në lidhje me ndikimin pozitiv ose negativ të medias në shoqëri dhe t'i organizojnë idetë e tyre në hartën e koncepteve si më poshtë:



Trajneri mund të shtojë idetë e tij në lidhje me çështjen në fjalë.

2. Hapi i dytë

Trajneri ndan pjesëmarrësit në grupe dhe u kërkon të krijojnë klastër konceptesh në lidhje me median dhe fenë, duke përdorur konceptet në hartën e mësipërme të koncepteve, si më poshtë:



Pas kësaj grupe ndajnë idetë e tyre me njëri-tjetrin, duke dhënë edhe shembuj për t'i mbështetur ato.

3. Hapi i tretë


Trajneri fton pjesëmarrësit që, për disa minuta, të mendojnë dhe të reflektojnë për rezultatet e klasterit. Më tej ata ftohen të diskutojnë në lidhje me pyetjet e mëposhtme:

- ▶ A është e mundur që media më shumë krijon konflikte se sa ofron informacione për konfliktet e krijuara nga të tjerët?
- ▶ Përse njerëz të ndryshëm i shohin lajmet në këndvështrimetë të ndryshme?
- ▶ A besoni në mundësinë e një medie të pavarur? Pse po apo pse jo?
- ▶ A besoni në një media krejtësisht të lirë apo në nevojën e vendosjes së disa kufizimeve?
- ▶ Cila është arsyeja, sipas jush, që individët janë të ndjeshëm ndaj çështjeve që lidhen me fenë e tyre?
- ▶ A mendoni që media duhet të qëndrojë larg aspekteve të identitetit vetjak?
- ▶ A mund të bëjë ose duhet të bëjë ligji në lidhje me këtë çështje?

Të rinjtë, media dhe feja në klasë¹

- ▶ Si diskutojnë të rinjtë për fenë, për çfarë flasin dhe përse flasin në këtë mënyrë? Këto pyetje më janë shfaqur vazhdimisht gjatë punës sime si studiues në fushën e rinisë dhe të fesë. Nga vëzhgimet e bëra në klasë, nga videoregjistrimet që u kam bërë bashkëveprimit të nxënësve klasë, si dhe nga intervista me nxënës me prejardhje të ndryshme etnike, fetare dhe jofetare, kam vënë re se gjuha e të rinjve, në shkallë të madhe ndikohet nga i ashtuquajti ligjërimit “sundues” për fenë dhe politikën. Këto ligjërime ndeshen më shumë në media dhe në debatet publike. Nxënësi, në mënyrë të veçantë ndikohen nga paraqitja e Islamit nga media sunduese. Në klasë, nxënësit bazohen në mënyrën e ligjërimit në këtë medie, duke u prirur të përqafojnë qëndrimet negative ndaj Islamit dhe myslimanëve në këtë kontekst, më shumë se në rastin e intervistave me mua. Është e qartë se këto qëndrime mund të kenë ndikim negativ në idenë e një klase si hapësirë e sigurtë për dialog.
- ▶ Në studimet e mia kam vënë re që bisedat e përditshme të nxënësve karakterizohen si nga ligjërimit sunduese në një debat shumëkulturore, ashtu edhe nga përvojat e tyre vetjake në marrëdhëniet me diversitetin kulturor dhe fetar. Këto ligjërime, shpeshherë kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe për ta duket se bëhet më e vështirë të përdorin ligjërime që lidhen me përvojat e tyre vetjake në raport me paraqitjet e medias. Kur nxënësit interpretojnë realitetin duke u bazuar në përvojat e tyre vetjake me larminë fetare dhe kulturore në jetën e tyre të përditshme, ata e bëjnë këtë, përgjithësisht, në mënyrë më pozitive se ajo që ndeshet në media. Shkurt, ndikimi fuqishëm i ligjërimit mediatik (duke përfshirë këtu edhe lajmet televizive dhe internetin) është i qartë, por nxënësit janë të aftë edhe të formulojnë edhe qëndrime vetjake më të pavarura. Sigurisht, këto fakte kanë shumë rëndësi për shkollën.
- ▶ Sipas vetë nxënësve, shkolla është një ndër vendet e pakta ku ata flasin për fenë dhe përvojën e tyre me larmnië fetare; shkolla në përgjithësi dhe edukimi për fenë në mënyrë të veçantë, mund të luajë rol të rëndësishëm në këtë edukim. Nga studimet e mia në lidhje me bashkëveprimin në klasë kam dalë në përfundimin që duke u dhënë nxënësve mundësinë të ndajnë pikëpamjet e tyre dhe të kritikojnë ligjërimit sunduese, u krijon atyre edhe mundësinë për t’u aftësuar për të lidhur më mirë njohuritë dhe të kuptuarit e feve me përvojat e tyre vetjake dhe zhvillimin shoqëror – sigurisht, e kushtëzuar kjo edhe me vullnetin e tyre për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në këtë drejtim. Lidhja ndërmjet veprimit vetjak me ndërveprimin shoqëror në klasë sugjeron edhe rrugët në të cilat refleksionet vetjake të lidhen me temat e moralit shoqëror dhe qytetarinë. Analiza e ligjërimeve nxjerr në pah nevojën për të mësuar më shumë nga mënyrat se si të rinjtë bisedojnë e flasin me njeri-tjetrin. Nëse kjo dije përdoret për të ndihmuar nxënësit që të bëhen më të vetëdijshëm për mënyrën si ata flasin për të tjerët, për çfarë flasin dhe përse flasin në këtë mënyrë, do të bëhej më e lehtë të zbuloheshin stereotipat dhe paragjykimet dhe si ndërtohen ato. Duke i bërë këto procese më të dukshme dhe më të qarta për nxënësit mund të krijohen kushte më të mira për debate e diskutime më të hapura, më transparente e më të baraspeshuara në klasë.

■ Teksti i mësipërm është një përmbledhje e kërkimeve të kryera nga Mari Von Lippe me të rinj nga Norvegjia. Diskutoni dhe reflektoni duke përdorur pyetjet e mëposhtme:



- ▶ Si mund të përpiqemi të dyshojmë tek media dhe autoritete të tjera, kur përpiqemi të zbulojmë të vërtetën? Si mundet ne, si mësues, të ndihmojmë të rinjtë për këtë qëllim?
- ▶ Si mund të ndryshojmë qasjen tonë ndaj informacionit, pretendimeve të medias ose trajtesave në dukje autoritare për fetë, ngjarjet ose njerëzit?


1. Kjo pjesë është shkëputur nga Signposts, faqe 61



Kapitulli 7


Bindjet dhe botëkuptimet jo fetare

Çështje kyçe/situata




- ▶ Studimi i bindjeve fetare dhe jofetare bazohet në të drejtën për lirinë e besimeve fetare dhe jofetare.
- ▶ Nuk ekziston një përkufizim i vetëm për bindjet jo fetare. Ekzistojnë botëkuptime të organizuara që nuk janë fetare si dhe botëkuptime personale që janë zhvilluar nga individët.
- ▶ Të gjitha fetë janë botëkuptime, por jo të gjitha botëkuptimet janë edhe fe.

Kompetencat për kulturë demokratike



- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore.
- ▶ Të qenit i hapur ndaj tjetrës kulturore dhe ndaj besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave.
- ▶ Empatia.

Çështjet kundërshtuese për t'u marrë në shqyrtim nga mësuesi



- ▶ A duhet që një bindje ose një pikëpamje individuale për jetën të vlerësohet njëllë me një botëkuptim të organizuar?
- ▶ A është një bindje fetare më e fortë dhe më e fuqishme se një bindje jo fetare?
- ▶ A mundet një mësues të jetë mëndjehapur në mësimdhënie nëse ka bindje të fuqishme fetare ose jofetare?
- ▶ Si mundet të paraqiten në kurrikul botëkuptimet personale dhe ato të organizuara?

Si ndikon tek mua kjo çështje?



- ▶ Unë duhet të përpiqem të kuptoj njerëzit që kanë një bindje ose botëkuptim fetar dhe ata që kanë bindje ose botëkuptime jofetare dhe t'i respektoj ata.
- ▶ Unë duhet të jem i vetëdijshëm për përdorimin e fjalëve dhe të koncepteve të tilla si "botëkuptim", "pikëpamje për jetën" ose "jo fetare".
- ▶ Unë duhet të sfidoj vlerat e mia. A vlerësoj unë me të vërtetë larminë kulturore? A e vlerësoj me të vërtetë larminë, për shembull, brenda fesë sime ose brenda një botëkuptimi të ngjashëm me timin?

Si ndikon kjo në mësimdhënien time?



- ▶ Unë duhet të zhvilloj mësimdhënien në mënyrë të tillë që zhvillon tolerancën dhe mirëkuptimin dhe besimin e ndërsjellë ndërmjet nxënësve që kanë botëkuptime të ndryshme fetare ose jofetare.
- ▶ Unë duhet të tregoj interes për botëkuptimet e ndryshme dhe të nxis nxënësit të zhvillojnë këtë interes, ndërkohë që reflektoj për besimet e mia dhe i nxis ata të bëjnë të njëjtën gjë.
- ▶ Unë duhet të jem i vetëdijshëm që çdo individ ka bindjet e tij. Disa prej tyre identifikohen me një fe, një organizatë ose një botëkuptim, ndërkohë që të tjerët nuk e bëjnë këtë.

Çfarë mund të bëj unë si mësues?



- ▶ Unë mund të krijoj një klasë si mjedis i sigurt, ku çdo nxënës mund të shprehë lirisht opinionin e tij dhe të ndihet i mirëpritur.
- ▶ Unë mund të nxis nxënësit e mi të përpiqen për ide të reja edhe nëse ato janë ende të pazhvilluara si duhet.
- ▶ Unë mund të punoj me kolegët e mi për çështje që lidhen me botëkuptimet e ndryshme, duke përfshirë edhe ato që lidhen me mënyrën e mësimdhënies së tyre dhe të diskutoj me ta për të kuptuarit e fjalëve ose koncepteve dhe të punoj për kuptimin e tyre të përbashkët.

Çfarë duhet të zhvilloj?



- ▶ Unë duhet zhvilloj të kuptuarit e feve të ndryshme dhe të bindjeve e botëkuptimeve të ndryshme.
- ▶ Unë duhet të zhvilloj kureshtjen time.
- ▶ Unë duhet të ndihmoj në zhvillimin e bisedave pozitive për këto çështje me mësuesit në shkollën time.

VEPRIMTARIA 1 – SKENAR: PËRGJIGJE LETRËS SË KUSHËRIRIT TUAJ

Fokus

Qëllimi i kësaj veprimtarie është të zhvillojë aftësitë që lidhen me shikimin e besimeve dhe bindjeve në këndvështrime të ndryshme dhe në pikëpamje të ndryshme jetësore. Veprimtaria synon edhe të sfidojë mendimet dhe vlerat vetjake që lidhen me larminë fetare. Mund të jetë e thjeshtë të mendosh për veten në mënyrë të hapur dhe përfshirëse. Por, çfarë ndodh kur e shoh veten nga pikapamja e një tjetri? A jam unë gjithnjë i ndershëm kur flas për fetë dhe pikëpamjet për jetën? A do të dëgjojë marrësi i mesazhit tim atë çfarë unë synoj t'i dërgoj atij?

Këshilla

- ▶ Nëse është e përshatshme, kjo mund të jetë një detyrë private. Në fillim, pjesëmarrësit duhet të sigurohen që nuk duhet të ndajnë me të tjerët mendimet e tyre nëse nuk e dëshirojnë një gjë të tillë.
- ▶ Koha e sugjeruar për këtë veprimtari është e përafërt: për shembull, kur zhvillohen diskutime më të gjata, mund të jetë e nevojshme që të lihet më shumë kohë për t'i nxitur ato. Por nëse ju jeni të sigurt që procesi i të mësuarit është realizuar dhe pikat kryesore të tij janë trajtuar, atëherë mund të kalohet në hapin tjetër. Zakonisht, në praktikë, koha varet edhe nga madhësia e grupit.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të shpjegojnë dhe do të shprehin mendime të njerëzve me pikëpamje të ndryshme;
- ▶ do të eksplorojnë mendimet e tyre për fenë dhe pikëpamjet jo fetare për jetën;
- ▶ do të zbulojnë si mendimet dhe vlerat e tyre ndikojnë vetëshprehjen, diskutimin dhe reflektimin.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore.
- ▶ Të qenit i hapur ndaj besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave të të tjerëve.
- ▶ Empatia

Procedurat/hapat

1. Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të lexojnë letrën nga “kushëri” i tyre, që gjendet në materiale, më poshtë. Pasi pyet pjesëmarrësit për pyetje ose sqarime të mundshme, trajneri i fton ata të ndjekin hapat e detyrës.

5minuta

2. Trajneri kërkon përmbushjen e detyrës 1 dhe 2, duke i siguruar pjesëmarrësit për privatësinë e mendimeve të tyre.

25minuta

Përmbledhje dhe vijimësi

Trajneri fton pjesëmarrësit në një diskutim:

- ▶ A mundët të zbulonit ndonjë gjë për veten ose për mendimet tuaja të cilat dëshironi t'i ndani me të tjerët?
- ▶ A mundët të zbulonit ndonjë gjë për një botëkuptim të cilin nuk dëshironi ta ndani me të tjerët ose ndonjë me të cilin nuk jeni dakord dhe këtë dëshironi ta ndani me të tjerët?
- ▶ Çdo të thotë për ju t'u përgjigjeni mendimeve që shprehët në letrën e parë?
- ▶ A dëshiron ndonjëri të lexojë njëerën ose të dyja letrat? Nëse do të dëshironit ta bënit këtë, ju takon përsëri juve nëse do të ftonit grupin të shprehë qëndrimin e tij me anë të pyetjeve ose komenteve.
- ▶ A mendoni që edhe mënyrat në të cilat njerëz të ndryshëm i mbrojnë botëkuptimet jofetare janë të ndryshme?

30 minuta

Fletë pune

Letër prej kushëririt tuaj

■ Përshendetje! Jam shumë i lumtur që po na jepet rasti të njohim njëri-tjerin dhe që mund të flasim për çështje të tilla siç bëme gjatë takimit të fundit. Që atëherë, kam menduar shumë për bisedën tonë dhe, në vijim, dëshiroj të të sfidoj me një pyetje: Cilat janë arsyet që nuk beson në zot? Më tej, cilat janë vlerat më të rëndësishme në jetën tënde?

Sinqerisht Kushëriri juaj

■ Detyra:



1. Shkruani një letër kushëririt tuaj. Nëse besoni në zot, përpquni të vendosni veten në vendin e atij që nuk beson në zot.
2. Më pas, përpquni të vendosni veten në vendin e "kushëririt" tuaj. Shkruani një përgjigje për përgjigjen që shkruat në detyrën 1.

VEPRIMTARIA 2 – A E VLERËSOJ UNË LARMINË? – DUKE DËGJUAR NJË KËNGË

Fokus

Qëllimi i kësaj veprimtarie është të shqyrtojë si ndihet njeriu kur sfidohen bindjet e tij. Vargjet e një kënge të shkruar nga Joan Osborne, shtrojnë pyetje që bëjnë të reflektojnë, si njerëzit që besojnë në fe ashtu edhe ata që nuk besojnë, për mënyrën e tyre të jetesës ashtu edhe për larminë e pikëpamjeve për jetën.

Këshilla

- ▶ Pjesëmarrësve u luhet kënga pa shtruar pyetjet që do të vijojnë më pas, për të mos ndikuar paraprakisht ndjenjat e tyre.
- ▶ Koha e sugjeruar për këtë veprimtari është e përafërt: për shembull, kur zhvillohen diskutime më të gjata, mund të jetë e nevojshme që të lihet më shumë kohë për t'i nxitur ato. Por nëse ju jeni të sigurt që procesi i të mësuarit është realizuar dhe pikat kryesore të tij janë trajtuar, atëherë mund të kalohet në hapin tjetër. Zakonisht, në praktikë, koha varet edhe nga madhësia e grupit.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të shpjegojnë dhe do të shprehin mendime të njerëzve me pikëpamje të ndryshme;
- ▶ do të shqyrtojnë ndikimin që mund të kenë në ndjenjat tona dhe të tjerëve tekstet për fetë dhe besimet.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Të qenit i hapur ndaj besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave të të tjerëve.
- ▶ Njohuritë për gjuhët dhe komunikimin.

Procedurat/hapat

1. Trajneri u jep pjesëmarrësve vargjet e këngës (shih materiale, më poshtë) dhe u kërkon atyre t'i lexojnë ato ose të dëgjojnë këngën. (Mund të shikoni edhe në adresën

<https://www.youtube.com/watch?v=Xn7rlarpQBk>, ku janë publikuar vargje)

2. Pjesëmarrësve u jepen dhe u lexohen pyetjet 1-6 dhe përsëri u jepet mundësia të dëgjojnë këngën. Ata, gjatë dëgjimit të këngës, duhet të shkruajnë disa fjalë kyçe. Pas leximit, pjesëmarrësve u jepen edhe 5 minuta për të përfunduar idetë e tyre dhe për t'u përgatitur për bisedat në vijim.

20 minuta

3. Pjesëmarrësit ndahen në grupe prej 3 vetash dhe ndajnë përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve me anëtarët e grupit të tyre. Çdo pjesëmarrës duhet t'u përgjigjet me radhë, të gjitha pyetjeve. Ndërkohë ata mund të pyeten për të sqaruar pikat e tyre.

30 minuta

4. Duke qëndruar në grupet e tyre, pjesëmarrësit luajnë një bisedë televizive. Më i riu në grup, me rolin e drejtuesit të bisedës. Dy të tjerët janë të ftuarit: njëri prej tyre beson në zot, tjetri nuk beson në zot. Vargu i tretë i këngës përmban tri pyetje. Drejtuesi i bisedës u drejton pyetjet "të ftuarve" dhe ata përgjigjen sipas rolit të tyre.

10 minuta

Përmbledhje dhe vijimësi

Në seancë plenare, trajneri u kërkon pjesëmarrësve të identifikojnë një pikë/çështje që atyre u ka mbetur në mendje, gjatë kohës kur një tjetër person po fliste në seancën e sotme. Këto pika duhet të bëhen të njohura për të gjithë.

15 minuta

Pjesëmarrësve u kërkohet të shkruajnë ose të vizatojnë në mënyrë individuale diçka që ndryshoi ose u zhvillua në mendjen e tyre gjatë kësaj veprimtarie.

10 minuta

Fletë pune

Nëse zoti do të kishte një emër, cili mund të ishte ai?
A do ta thërrisnit në emër duke qenë përballë tij?
Nëse do të përballeshit me të, në të gjithë lavdinë e tij, për çfarë do ta pyesnit, nëse do të kishit mundësinë vetëm të një pyetjeje?

Po, zoti është i madhërishtëm
Po, zoti është i mirë
Po nëse zoti do të ishte njëri prej nesh Thjesht një përtac e pisanjos si ne Thjesht një i huaj në autobus

Në përpjekje për t'u kthyer në shtëpi?
Nëse zoti do të kishte një fytyrë, kujt do t'i ngjante ajo?
Dhe çfarë do të dëshironit ju të shihnit
Nëse të shohësh do të thotë se duhet të besosh
Në gjëra si parajsja dhe Jezusi dhe në shenjtoret e në të gjithë profetët?

Po, zoti është i madhërishtëm
Po, po zoti është i mirë
Po nëse zoti do të ishte njëri prej nesh Thjesht një përtac e pisanjos si ne Thjesht një i huaj në autobus

Në përpjekje për t'u kthyer në shtëpi? Ai po përpiqet të shkojë në shtëpi Drejt parajsës, i vetmuar
Askush nuk e merr në telefon
Me përjashtim të Papës, ndoshta, në Romë

Po, zoti është i madhërishtëm
Po, zoti është i mirë
Po nëse zoti do të ishte njëri prej nesh Thjesht një përtac e pisanjos si ne Thjesht një i huaj në autobus

Në përpjekje për t'u kthyer në shtëpi? Në përpjekje për t'u kthyer në shtëpi Si një gur i shenjtë që rrokulliset Drejt parajsës, i vetmuar Askush nuk e merr në telefon
Me përjashtim të Papës, ndoshta, në Romë

Pyetje për reflektim personal




- ▶ Çfarë mendimesh më lindin kur dëgjoj këtë këngë ose lexoj këtë tekst?
- ▶ Çfarë emocionesh me ngjallen?
- ▶ Cili prej vargjeve më futi më shumë në mendime?
- ▶ Cili prej vargjeve më shkaktoi më shumë emocion?
- ▶ A ka ndonjë varg që më shqetëson? Cili? Cilët?
- ▶ Përse mendoni që këto vargje patën këtë ndikim tek mua?

Kapitulli 8

Çështje të të drejtave të njeriut


Çështje kyçe/situata



Politikëbërësit, shkollat dhe trajnerët duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar që:


- ▶ të mos ketë diskriminime në bazë të besimeve ose bindjeve fetare ose në bazë të besimeve ose bindjeve jo fetare në shkollë ose në klasë;
- ▶ mësuesit, nxënësit dhe prindërit njohin dokumentet kryesore të të drejtave të njeriut dhe pohimet për lirinë e fesë dhe të besimit;
- ▶ vëmendje në shkollë u duhet kushtuar të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të prindërve ose kujdestarëve;
- ▶ e drejta e lirisë së shprehjes në shkolla dhe në klasa shoqërohet me detyrat dhe detyrimet në lidhje me qytetarinë dhe ndjeshmërinë në prani të pakicave.

Kompetencat për kulturë demokratike



- ▶ Vlerësimi i dinjitetit njerëzor dhe i të drejtave të njeriut
- ▶ Respekti
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të botës: politikën, ligjin, të drejtat e njeriut, fetë dhe bindjet jofetare.
- ▶ Aftësitë për zgjidhjen e konflikteve

Çështjet kundërshtuese për t'u marrë në shqyrtim nga mësuesi



- ▶ E drejta ndërkombëtare shpall se prindërit dhe kujdestarët ligjorë kanë të drejtë të rrisin fëmijët në përputhje me bindjet e tyre fetare ose filozofike. Në të njëjtën kohë, e drejta ndërkombëtare pranon se në disa pika të zhvillimit të tij, fëmija mund të shprehë dëshirën për të pretenduar të drejtat e tij në lidhje me fenë ose besimin. Në shumë vende, prindërit kanë ndikim të madh për mënyrën se si fëmijët e tyre ndeshen me fenë ose besimet jofetare në shkollë. Në çfarë mase prindërit duhet të kontrollojnë një gjë të tillë?
- ▶ Kur është koha që fëmijët të kenë më shumë fuqi të vendosin vetë për zgjedhje të tilla?
- ▶ Të drejtat e njeriut mund të hyjnë në konflikt me njëra-tjetrën. Opinionet që lidhen me një fe ose besim mund të jenë të papranueshme në këndvështrimin e të drejtave të njeriut (p.sh. qëndrimi për orientimin ose praktikën seksuale, çështjet gjinore).
- ▶ A duhet të përqendrohemi më shumë në të drejtat apo në detyrimet? Cili është qëndrimi i feve ose i botëkuptimeve të ndryshme jofetare për këtë çështje?



Si ndikon te mua kjo çështje?



- ▶ Unë duhet të marr parasysh qëndrimin tim për të drejtat e ndryshme të njeriut.
- ▶ Unë duhet të tregoj respektin tim për të drejtat e njeriut dhe si pjesë e detyrimit tim profesional.
- ▶ Unë mund të shpreh fenë time ose besimet e mia jofetare, por nuk duhet të shfrytëzoj pozitën time si mësues për t'u imponuar nxënësve besimet e mia.

Si ndikon kjo në mësimdhënien time?



- ▶ Përmes mësimdhënies dhe sjelljes sime unë duhet të mbroj dhe të përmbush të drejtat e njeriut dhe të kontribuoj për një demokraci të ndryshme.
- ▶ Unë duhet t'u shpjegoj nxënësve rëndësinë e të mësuarit për besimet fetare dhe jofetare të të tjerëve për të jetuar së bashku në mirëkuptim dhe respekt.
- ▶ Unë duhet t'u mësoj nxënësve për marrëdhëniet ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve.
- ▶ Unë duhet të siguroj që e drejta e lirisë së shprehjes në klasën time të baraspeshohet nga detyrimet në lidhje me qytetarinë dhe ndjeshmërinë në prani të pakicave.

Çfarë mund të bëj unë si mësues?



- ▶ Unë mund të ndërtoj një dialog të mirë dhe të qartë me prindërit për të theksuar të drejtat prindërore dhe misionin e shkollës në lidhje me mësimdhënien për fetë dhe botëkuptimet jofetare.
- ▶ Unë mund të sfidoj fëmijët me besimet e ndryshme fetare dhe jofetare për të diskutuar çështje morale duke u bazuar në besimet e tyre ose në lidhje me pikëpamje të tjera.
- ▶ Unë mund të respektoj, pa vënë në dyshim, një dëshirë të një nxënësi për të veshur një simbol ose veshje fetare.

Çfarë duhet të zhvilloj?



- ▶ Unë duhet të zhvilloj njohuritë e mia për të drejtat e njeriut dhe vendin e tyre në legjisllacionin e vendit tim.
- ▶ Unë duhet të zhvilloj aftësitë e mia për trajtimin e opinionëve të ndryshme në klasë duke përfshirë këtu edhe opinionet e skajshme dhe të baraspeshoj të drejtën e lirisë së shprehjes me nevojën për qytetari.
- ▶ Unë duhet të zhvilloj aftësitë e mia të këmbënguljes për të drejtat e njeriut duke treguar, në të njëjtën kohë, respekt për opinionin e të tjerëve.

VEPRIMTARIA 1 – VLERA TË BARABARTA, ARSYE TË NDRYSHME? A E VLERËSOJ UNË LARMINË? – DUKE DËGJUAR NJË KËNGË

Fokus

Thelbi i kësaj veprimtarie është të shqyrtojë nëse nenet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut janë apo jo realisht universale. Si theksohet edhe në Udhërrëfyes, idetë që qëndrojnë në themel të pohimeve, disa herë lidhen me traditat e krishtera (faqe 80). Në të njëjtën kohë, deklarata është miratuar nga të gjithë shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës dhe është një pjesë e rëndësishme e bazave morale të Këshillit të Evropës.

Këshilla

Koha e sugjeruar për këtë veprimtari është e përafërt. Kur janë të nevojshme diskutime më të gjata për një çështje atëherë mund të jetë e nevojshme të lejohen ose të nxiten nxënësit për këtë qëllim. Nëse kjo nuk ndodh dhe ju jeni të bindur për realizimin e objektivave të mësimi dhe trajtimit e pikave kryesore të tij, atëherë mund të kaloni në hapin tjetër. Zakonisht, në praktikë, koha varet nga numri i nxënësve në klasë.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të rrisin kompetencat për të drejtat e njeriut;
- ▶ do të kuptojnë përse është e nevojshme pasja e më shumë njohurive për të drejtat e njeriut dhe për fetë e ndryshme;
- ▶ do të japin shembuj për ngjashmëritë ndërmjet rezultateve të kërkuara nga fe të ndryshme, edhe në rastet kur prejardhja ose arsyet janë të ndryshme.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Vlerësimi i dinjitetit njerëzor dhe i të drejtave të njeriut.
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të botës: politikës, ligjit, të drejtave të njeriut, feve, historisë etj.

Procedurat/hapat

1. Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të lexojnë pjesët e përshtatura nga Udhërrëfyesi (faqe 80-81): Diskutimet ndërkulturore për dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut; Koncepti i dinjitetit njerëzor; Drejt një dialogu konstruktiv për të drejtat e njeriut. Shih Fleta e punës A, më poshtë.

5 minuta

2. Trajneri ndan pjesëmarrësit në grupe prej tri vetash. Secili pjesëmarrës luan rolin e njërit prej botëkuptimeve: njëri prej tyre përfaqëson botëkuptimin jofetar ndërsa secili prej dy të tjerëve merr rolin e një prej feve që përfaqësohen në një vend ose rajon.
3. Në grupe, pjesëmarrësit lexojnë disa nga nenet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (shih Fleta e punës B). Ata, me radhë, shpjegojnë pranimin ose kundërshtimin e çdo neni, duke dhënë edhe argumentet përkatëse në këndvështrimin e botëkuptimeve fetare dhe jofetare që ata përfaqësojnë, duke u bazuar në një tekst ose në informacione të tjera që ata kanë në lidhje me vlerat e tyre. Atyre u duhet dhënë koha e duhur për të përcaktuar qëndrimin e tyre.

Për shembull: Unë, si hebre, i mbështes nenet që ndalojnë torturën ose trajtimin a ndëshkimin mizor, çnjerëzor ose poshtërues, për shkak të parimit të reciprocitetit: "Mos i bëj tjetrit atë që nuk dëshiron që të tjerët ta bëjnë ty"

Trajneri lejon kohën e nevojshme për biseda pas çdo neni.

Pas veprimtarisë, pjesëmarrësit shkruajnë disa pohime (2-4) në një nga postet dhe e paraqesin atë në klasë.

40 minuta

Përmbledhje dhe vijimësi

Në grupe (nëse është e mundur me ata që përfaqësonin të njëjtën fe ose botëkuptim në të njëjtin grup), pjesëmarrësit duhet të diskutojnë pyetjet e mëposhtme:

- ▶ Cilat janë reflektimet tuaja për veprimtarinë?
- ▶ Cilat aspekte të veprimtarisë ishin më të vështirat?
- ▶ Cilat aspekte të veprimtarisë ishin më të pëlqyeshmet?

10 minuta

Në seancë plenare, grupi diskuton pyetjet e mëposhtme

- ▶ Duke punuar në grup në lidhje me të drejtat e njeriut, patët më shumë konsensus apo mosmarrëveshje?
- ▶ Çfarë zbuluat në lidhje me prejardhjen ose arsyetimin e feve të ndryshme ose të botëkuptimeve të përfaqësuara në veprimtari?
- ▶ Më tej, secili duhet të ecë përçark dhe të shohë pohimet e posterave, përpara se t'u kthehen diskutimeve të pyetjeve të mëposhtme
- ▶ Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet kryesore ndërmjet pikëpamjeve të ndryshme?
- ▶ A ekzistojnë kontradita ndërmjet përfaqësuesve të të njëjtës fe ose botëkuptim?
- ▶ Si u ndjetë në përfaqësimin e një feje ose të një botëkuptimi të ndryshëm nga juaji?
- ▶ A ka pika të tjera që dolën gjatë diskutimeve tuaja të cilat do të dëshironit t'i trajtonit?

15 minuta

Fletë pune

Nenet e mëposhtme janë shkëpur nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, të miratuara nga Asambleja e Përgjigjshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1948.

Neni 3

■ Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.

Neni 4

■ Asnjëri nuk duhet të mbahet si skllav ose në robëri; skllavëria dhe tregtia e skllavëve janë të ndaluara në të gjitha format.

Neni 5

■ Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, veprimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 7

■ Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë.

Neni 9

■ Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose dëbimit.

Neni 10

■ Gjithkush gëzon një lloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

VEPRIMTARIA 2 – TË DREJTAT E FËMIJËS PËRKUNDREJT TË DREJTAVE TË PRINDËRVE

Fokus

Kjo veprimtari fokusohet në mundësinë e kontraditës ndërmjet të drejtës së prindit për të rritur fëmijët e tij në përputhje me besimet e tij fetare ose filozofike dhe të drejtës së fëmijës për lirinë e fesë ose të besimit të tij .

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të jenë të aftë të shpjegojnë më mirë DUDNJ-në;
- ▶ do të peshojnë të drejtat e ndryshme, do të jenë të aftë të trajtojnë bisedat dhe diskutimet për të drejta që janë në konflikt me njëra-tjetrën.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Vlerësimi i demokracisë, i drejtësisë, indërsshmërisë dhe i shtetit të së drejtës.
- ▶ Fleksibilitet dhe përshtatshmëri
- ▶ Aftësi për zgjidhjen e konflikteve

Procedurat/hapat

Trajneri i ndan pjesëmarrësit në grupe prej katër personash dhe i jep secilit grup një tabelë me rathë koncentrikë si dhe një listë me pohime që gjenden në materialet në vijim. Çdo pjesëmarrës duhet të zgjedhë një "shënues", p.sh., një monedhë, një çelës, një gomë.

Në grupe, pjesëmarrësit duhet të lexojnë pohimet me radhë dhe më pas të vendosin shënuesin e tyre në tabelë. Nëse ata bien dakord plotësisht, pjesa vendoset në qendër, në numrin

10. Nëse ata janë krejtësisht kundër, atëherë shenja vendoset jashtë rrethit ose në numrin 1. Pjesëmarrësit duhet të shpjegojnë vendimet e tyre. Në fillim ata duhet të shpjegojnë ato për të cilat janë krejtësisht dakord. Pas shpjegimeve, pjesëmarrësve u lejohe të ndyshojnë gjykimet e tyre dhe të shpjegojnë arsyen përse e bëjnë një

gjë të tillë.

40 minuta

Përmbledhje dhe vijimësi

Grupet diskutojnë për pohimin që shkaktoi diskutimin më interesant. Diskutimet mund të vazhdojnë edhe në seancë plenare.

Materiale



Pohime:



- ▶ Prindërit e një fëmije 10 -vjeçar kanë të drejtë të vendosin nëse fëmija e tyre duhet të marrë pjesë në vizitën në një kishë, të organizuar nga shkolla. Pjesa kryesore e vizitës është një shërbim fetar.
- ▶ Një vajzë 12- vjeçare ka të drejtë të vendosë vetë nëse duhet të marrë pjesë në vizitën në një xhami, të organizuar nga shkolla. Në vizitë nuk do të ketë shërbime fetare për përkushtimin ndaj Islamit. Qëllimi i vizitës do të jetë vetëm mësimor dhe në lidhje me ndërtesën dhe artin që ndodhet brenda saj.
- ▶ Prindërit mund të sjellin fëmijët e tyre në një kamp veror me një grup besimtarësh të kishës dhe shpresojnë që fëmijët të marrin pjesë në të gjitha veprimtaritë.
- ▶ Vajza 8- vjeçare e dy prindërve të krishterë duhet të lejohet të falet për zotin Hindu dhe të ketë simbole të kësaj feje në dhomën e saj.
- ▶ Një djalë 9 -vjeçar, duke u bazuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijës të Kombeve të Bashkuara mund të kërkojë të drejtën për të agjëruar në muajin e Ramazanit

VEPRIMTARIA 3 – TË DREJTAT PËRKUNDREJT DETYRIMEVE DHE DETYRAVE

Fokus

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut është kritikuar për përqendrimin në mënyrë të njëanshme vetëm në të drejtat dhe për vëmendje të pamjaftueshme ndaj përgjegjësive dhe detyrave. Kjo veprimtari përqendrohet në marrëdhëniet ndërmjet të drejtave dhe detyrave

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të eksplorojnë marrëdhëniet

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të të drejtave të njeriut
- ▶ Aftësitë e të menduarit analitik dhe kritik ndërmjet të drejtave dhe detyrave.

Procedurat/hapat

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve që, në mënyrë individuale, të plotësojnë fletën e punës për të drejtat dhe detyrat (shih materiale në vijim)

20 minuta

Përmbledhje dhe vijimësia

Trajneri, në seancë plenare, drejton diskutimin për komentet dhe pyetjet në lidhje me fletën e punës.

10 minuta

Fletë pune

Në pjesën që vijon Udhërrëfyesi (faqe 82) i referohet DUDNJ:

■ Meqë të drejta dhe detyrimet janë të lidhura, ideja e një të drejte të njeriut merr kuptim vetëm nëse ne pranojmë detyrimin e të gjithë njerëzve ta respektojmë atë. Pavarësisht nga vlerat e një shoqërie të caktuar, marrëdhëniet njerëzore në mënyrë universale bazohen në ekzistencën e të drejtave dhe detyrave.

■ Më poshtë janë disa shembuj të përgjegjësive në lidhje me të drejtat të përfshira në DUDNJ:

- ▶ Nëse ne kemi të drejtën për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit, atëherë në kemi edhe detyrimin që të respektojmë mendimet ose parimet fetare të të tjerëve.
- ▶ Nëse ne kemi një të drejtë për t'u arsimuar, atëherë ne kemi edhe detyrimin për të mësuar sa më shumë brenda mundësive tona dhe, ku është e mundur të shkëmbejmë njohuritë dhe përvojat tona me të tjerët.


■ Detyra juaj, duke u bazuar në shembuj të mësipërm, është të sugjeroni përgjegjësitë ose detyrimet që mund të përputhen me të drejtat e DUDNJ dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Sugjerimi i parë është modeli për plotësimin e kësaj detyre:

| Të drejtat | Detyrat/Përgjegjësitë |
|--|--|
| ▶ E drejta për lirinë e mendimit dhe të fesë | ▶ Detyrimi për të respektuar mendimet dhe parimet fetare të të tjerëve |
| ▶ E drejta për jetën, liri dhe siguri | |
| ▶ E drejta për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes zgjedhjes së lirë të përfaqësuesve. | |
| ▶ E drejta e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit për të ruajtur marrëdhënie personale dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit në mënyrë të rregullt. | |
| ▶ E drejta për lirinë e opinionit dhe të shprehjes. | |
| ▶ E drejta për arsimim. Arsimi duhet të jetë i lirë, të paktën ai fillor dhe bazë. | |

Kapitulli 9


Lidhja e shkollës me komunitete dhe organizata më të gjera

Çështje kyçe/situata




- ▶ Rekomandimet e Këshillit të Evropës CM/Rec (2008) 12 i vlerëson shkollat si pjesë jetësore të sferës publike dhe vlerëson rëndësinë e komunikimit ndërmjet shkollave, individëve dhe grupeve në shoqëri.
- ▶ Lidhjet me komunitetet jashtë shkollës kërkojnë një politikë mbarë shkollore dhe mbështetjen e duhur për stafin dhe nxënësit që bëjnë pjesë në të, si kurse edhe si person (ose persona) brenda shkollës me përgjegjësinë për këtë lidhje.

Kompetencat për kulturë demokratike



- ▶ Vlerësimi i larmisë kulturore
- ▶ Të qenit i hapur ndaj të ndryshmes kulturore dhe ndaj besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave të tjera.
- ▶ Respekti
- ▶ Empatia
- ▶ Aftësitë për të analizuar dhe menduar në mënyrë kritike
- ▶ Aftësitë për të dëgjuar dhe për të vëzhguar
- ▶ Aftësitë për të bashkëpunuar
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të kulturës, të kulturave dhe të feve.

Çështjet kundërshtuese për t'u marrë në shqyrtim nga mësuesi



- ▶ Vizitat arsimore në komunitetet fetare i shërbejnë nxitjes së të mësuarit dhe nuk janë veprime adhurimi.
- ▶ Nëse prindërit e interpretojnë në mënyrë të gabuar një vizitë në një komunitet fetar si një akt adhurimi, a duhet të jenë ata të lirë të tërheqin fëmijët e tyre nga vizita?
- ▶ Cilat janë kushtet që duhet të shoqërojnë pritjen e vizitorëve dhe organizimin e vizitave?
- ▶ Si do t'u bëhen të njohura këto kushte nxënësve dhe prindërve, së bashku me udhëzimet për sjelljen e nxënësve?
- ▶ Cili është dallimi ndërmjet informimit ose shpjegimit dhe përpjekjes për të mbrojtur ose nxitur një besim të caktuar?

Si ndikon te mua kjo çështje?



- ▶ Unë duhet të përgatitem për të sjellë një zë të ri në klasë ose të përgatis nxënësit të dëgjojnë zëra të rinj në komunitet.
- ▶ Unë duhet të jem i qartë për synimet, qëllimet dhe vlerat edukative të lidhjes së shkollës me komunitetin.

Si ndikon kjo në mësimdhënien time?



- ▶ Unë duhet të aftësoj nxënësit e mi të kuptojnë gjuhën, besimet dhe pretendimet e atyre që i mbajnë qëndrime fetare dhe jofetare në shoqëri
- ▶ Mësimdhënia jashtë klasës ose shkollës kërkon aftësi të tjera, p.sh. vetëdijen për kërkesat e sigurisë ose për marrëdhëniet me publikun.

Çfarë mund të bëj unë si mësues?



- ▶ Unë mund të krijon shanse për shkëmbime dhe dialogje ndërmjet nxënësve nga mjedise të ndryshme kulturore.
- ▶ Unë mund të ftoj në shkollë njerëz nga organizata fetare ose besimtare për të vepruar si persona burimorë (duke mbajtur parasysht nevojat e tyre si persona).
- ▶ Unë mund të organizoj vizita në komunitete të tjera fetare ose jo fetare.
- ▶ Unë mund të punoj për të vendosur lidhje ndërmjet shkollës dhe komunitetit përmes një qasje mbarëshkollore.
- ▶ Unë mund të përfshij mësues tjerë, nxënës dhe prindër në organizimin dhe ruajtjen e këtyre lidhjeve.

Çfarë duhet të zhvilloj?



- ▶ Metodatat e mësimdhënies dhe të mësuarit të cilat sigurojnë arsim demokratik në bazë komuniteti.
- ▶ Vetëdijen për rëndësinë e vendosjes së marrëdhënieve pozitive me prindërit dhe komunitetin vendor, duke përfshirë këtu edhe komunitetet fetare.
- ▶ Ndjeshmërinë dhe vetëdijen për fetë e ndryshme dhe besimet e nxënësve.
- ▶ Ndhimën për stafin e përfshirë për të zhvilluar kompetencat e nevojshme.
- ▶ Besimin dhe vetëdijen që çështjet dhe shqetësimet vendore
- ▶ lidhen me ato globale.

VEPRIMTARIA 1 – ORGANIZIMI I LIDHJEVE SHKOLLË-KOMUNITET

Fokus

Në këtë veprimtari vihet theksi në rëndësinë e lidhjeve ndërmjet shkollës dhe komunitetit të gjerë dhe në mënyrë të veçantë me njerëz dhe vende të rëndësishme. Këtu shqyrtohen rolet, çështjet dhe vështirësitë e organizimit të një vizite, duke marrë parasysh kushtet paraprake të përshkruara në rekomandime.

Këshilla

Veprimtaria ofron disa skenarë alternativë, në varësi të njohurive dhe nevojave të mësuesve. Grupet e formuara mund të punojnë në lidhje me shkollat e tyre ose të përzgjedhin një shkollë në një vend të caktuar në një ndër shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës (duke kërkuar online kushtet e tij arsimore, sociale dhe fetare). Si do ta shohim më poshtë, pjesët e shkëputura nga Udhërrëfyesi që do të përdoren në këtë kapitull janë më të gjata se ato në kapitujt e tjerë. Duke i gjetur dhe përfshirë ata si fletë pune, u kërkohet trajnerëve dhe pjesëmarrësve t'i kthehen tekstit origjinal në Udhërrëfyes.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të kuptojnë dhe do të analizojnë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në organizimin e lidhjes shkollë-komunitet;
- ▶ të zbatojnë parimet e mësimdhënies për botëkuptimet fetare dhe jofetare, ndërkulturore, përmes ndërtimit të lidhjeve shkollë-komunitet;
- ▶ të pranojnë vlerat e përdorimit të lidhjeve me komunitetin dhe të përdorin vizitat jashtë shkolle si mjet edukativ.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Të qenit i hapur ndaj të ndryshmes kulturore dhe besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave të tjerëve.
- ▶ Respekti
- ▶ Aftësitë e të menduarit analitik dhe kritik
- ▶ Aftësi të e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit
- ▶ Aftësitë për të bashkëpunuar
- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të kulturës, të kulturave dhe të feve.

Procedurat/hapat

1. Trajneri formon grupe me 5-6 persona.
2. MPN (Mendo-Puno në dyshe-Ndaj). Pjesëmarrësit lexojnë në mënyrë individuale pjesët e mëposhme të Rekomandimit: Fusha, përkufizimet dhe Kushtet arsimore (Materiali mund të gjendet në faqet 24-25 të këtij manuali trajnimi).
3. Secilit grup i jepet përkatësisht rolet në vijim: një grup përfaqësojnë drejtorët, një grup përfaqëson mësuesit etj.) Nëse grupet janë përbërë prej 5-6 personave, atëherë shmang rolin e përfaqësuesve të komunitetit në grupet me 5 persona.
4. Grupeve u jepet koha e duhur për të lexuar tekstet dhe për të kuptuar veçoritë e çdo roli.
5. Çdo anëtar i grupit i caktohet një numër (1,2,3,4,5 dhe 6). Kështu organizohen grupet e reja sipas numrave (numrat 1 formojnë një grup e kështu me radhë).
6. Grupeve u jepet drejta të zgjedhin llojin e shkollës me të cilën do të punojnë (shih këshillat).
7. Grupet kanë detyrën të organizojnë një vizitë të shkollës në një vend të rëndësishëm për komunitetin vendor, ose një vizitë në shkollë të një ose më shumë personave, duke marrë parasysh hapin 2.
9. Çdo grup përgatit një poster, me anë të të cili reklamon veprimtarinë e planifikuar.
10. Posterat vendosen në mure. Çdo grup cakton edhe përfaqësuesin e vet për të qëndruar pranë posterit, rol të cilin e marrin me radhë të gjithë numrat, çdo tre minuta. Pjesëmarrësit qarkullojnë duke parë posterat dhe duke diskutuar për ta.

Përmbledhje dhe vijim

Trajneri u drejton pjesëmarrësve pyetjet e mëposhtme:

- ▶ Si u ndjetë si pjesëmarrës në këtë veprimtari?
- ▶ Cilat janë përfitimet e organizimit të lidhjeve me komunitetin vendor?
- ▶ Cilat janë rreziqet dhe mangësitë e mundshme?
- ▶ Gjatë vizitave nëpër shkolla, cilët janë njerëzit që mendoni se kishin nevojë për mbështetje? Kush duhet t'ua sigurojë këtë mbështetje?
- ▶ Nëse mendoni ta përdorni këtë veprimtari për trajnimin e mësuesve, çfarë do të përdornit pa ndryshuar dhe çfarë do të ndryshonit?

ALTERNATIVË

Ndiqni hapat e mëposhtëm:

1. Duke u bazuar në rolin tuaj, shkruani një letër një grupi të zgjedhur nga ju, për ta vënë në dijeni për një vizitë të mundshme (p.sh. drejtuesit u drejtojnë një letër prindërve, mësuesit ua drejtojnë përfaqësuesve të komunitetit fetar ose vendor, prindërit ua drejtojnë mësuesve, nxënësit u shkruajnë prindërve etj.)
2. Krijoni një poster në të cilin keni renditur veprimet që duhet të kryejë një person në rolin tuaj për të organizuar lidhjen e shkollës me komunitetin.
3. Pastaj ndiqni hapat e fundit të përshkruar më sipër.

Fletë pune

Organizimi i një lidhjeje shkollë-komunitet

Duke lidhur shkollat

Rolet dhe detyrat për veprimtarinë

| | | |
|--|---|--|
| <p>DREJTORI I SHKOLLËS</p> <p>Lexoni tekstet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">▶ “Këshillii Evropës...deri në▶ ...në formë note” (Udhërrëfyysi, faqe 87)▶ “Në përmbledhje, në anën e shkollës...deri në ...çështje të sigurisë etj.” (po aty, faqe 89)▶ “Rekomandimi ... deri në▶ ..trajnimi” (po aty, faqe 96) | <p>PRINDI</p> <p>Lexoni tekstet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">▶ “Zakonisht, këto vizita ... deri në ...brenda klasës” (po aty, faqe 88)▶ “Një ish ..deri në...2012a fq 59)” (po aty, faqe 90)▶ “Ata ndjenë...deri▶ në...Britton 2012” (po aty, faqe 95) | <p>MËSUESI</p> <p>Lexoni tekstet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">▶ “Këshillii i Evropës...deri në▶ ... klasat e përshira” (po aty faqe 87-89)▶ “Ata ndjenë...deri▶ në...Britton 2012” (po aty, faqe 95)▶ Rekomandimi ... deri në▶ ..trajnimi” (po aty, faqe 96) |
| <p>PËRFAQËSUESI I KOMUNITETIT VENDOR</p> <p>Lexoni tekstet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">▶ “përgatitjet për ...deri në▶ ...në lidhje me fenë” (po aty, faqe 95-96)▶ “Beavan ka kryer ...deri në...në lidhje me fenë” (po aty, faqe 95-96) | <p>PËRFAQËSUESI I KOMUNITETIT FETAR</p> <p>Lexoni tekstet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">▶ “Këshillii Evropës...deri në▶ ...në formë note” (Udhërrëfyysi, faqe 87)▶ “Në lidhje me vizitat ...deri në...mikpritjen” (po aty, faqe 88) | <p>NXËNËSI</p> <p>Lexoni tekstet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">▶ “Zakonisht, këto vizita ... deri në ...brenda klasës” (po aty, faqe 88)▶ “Ata ndjenë...deri▶ në...Britton 2012” (po aty, faqe 95) |

VEPRIMTARIA 2 – NË KËRKIM TË RRUGËVE PËR TË KAPËRCYER PENGESAT PËR ORGANIZIMIN E NJË LIDHJEJE SHKOLLË-KOMUNITET

Fokus

Në këtë veprimtari, vihet theksi në rëndësinë e mbajtjes së disa kushteve të domosdoshme, të përshkuara në Udhërrëfyes, për organizimin e një lidhjeje shkollë-komunitet, me qëllim që të ndihmohen prindërit të kuptojnë qëllimin e saj arsimor dhe të kapërcejnë çdo kundërshtim për pjesëmarrjen e fëmijëve.

Këshilla

Pjesëmarrësve u jepet koha e duhur për t'u familjarizuar me leximet përmes Udhërrëfyesit, për të mos krijuar fletë pune me pjesë të shkëputura.

Në veprimtarinë "Ku qëndroni ju", nëse organizoni një diskutim, përgatisni pohime të paqarta ose të padrejta dhe kërkoni prej pjesëmarrësve të të dy skajeve të shqyrtojnë ku qëndrojnë në raport me këto. Pas veprimtarisë, përpiquni të përfshini persona me pikëpamje të ndryshme në të gjitha grupet.

Objektivat/rezultatet e pritshme të të mësuarit

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të marrin parasysh dhe do të përgatiten të kapërcejnë pengesat në lidhjen e shkollave me komunitetin;
- ▶ do të veprojnë dhe do të negociojnë për të ruajtur shanset e barabarta arsimore për të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës;
- ▶ do të dëgjojnë ose do të parashikojnë kundërshtimet dhe do të formojnë sugjerime që marrin parasysh frikërat e prindërve ose mungesën e mundshme të informimit të tyre.

Kompetencat që lidhen me këtë veprimtari

- ▶ Të qenit i hapur ndaj të ndryshmes kulturore dhe besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave të tjerëve.
- ▶ Respekti
- ▶ Aftësitë e të menduarit analitik dhe kritik
- ▶ Aftësitë e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit
- ▶ Empatia

Procedura/hapat

1. Ku qëndrojnë unë: në klasë, në korridor apo në një ndonjë hapësirë tjetër, shënioni dy qoshe të kundërta si pozitive (+) dhe negative (-). Shënioni një vizë në mes, që nënkupton "s'ka opinion". Lexoni me zë të lartë pohimet dhe u kërkoni pjesëmarrësve të vendosen ndërmjet polit + dhe -. Asnjë prej pjesëmarrësve nuk duhet të vendoset në pikën "s'ka opinion" më tepër se dy herë. Për këtë veprimtari mund të përdoren pohimet e mëposhtme:
 - ▶ Prania e një përfaqësuesi të një feje të vogël në shkollë është propagandë.
 - ▶ Vizitat në shkollë janë të rrezikshme dhe të kushtueshme dhe vlera e shtuar është e pamjaftueshme për ta justifikuar atë.
 - ▶ Shkollat nuk duhet të pranojnë përjashtime nga vizitat e shkollës: fëmijëve duhet t'u jepen shanse të barabarta për të mësuar.
 - ▶ Prindërit që nuk lejojnë fëmijët e tyre të marrin pjesë në vizita ndërfetare janë të paarsimuar.
 - ▶ Prindërit nuk duhet të informohen për vizitat e shkollës, pasi ato janë thjesht veprimtari shkollë.
 - ▶ Prindërit duhet të jenë ata që propozojnë vizitat në vende fetare, sepse, në bazë të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut, ata janë përgjegjës për edukimin fetar të fëmijëve të tyre.
 - ▶ Nxënësve që nuk marrin pjesë në vizitat ndërfetare të shkollës duhet t'u caktohen detyra të tjera në shkollë.
 - ▶ Nxënësit nuk duhet të informohen për fetë e të tjerëve përveç fesë së tyre. Ata mund të hutohen.
2. Trajneri formon grupe prej katër ose pesë personash.
3. Mendo-formo dyshe-shkëmbe mendimet. Pjesëmarrësit lexojnë individualisht pjesët e Rekomandimit, fusha dhe përkufizimet dhe parakushtet arsimore (materiali mund të gjendet në faqet 24-25 të këtij manuali)
4. Trajneri fton grupet të lexojnë Udhërrëfyesin, faqe 87-89.
5. Trajneri paraqet faqet e materialit, të cilat përbajnë arsgumentin për disa prindër në Angli, të cilët nuk i lejojnë fëmijët e tyre të marrin pjesë në një vizitë në xhami.
6. Çdo grupi i jepet nga një pohim për prindërit.
7. Pjesëmarrësit, duke përdorur argumentet e hapave 4 dhe 5, gjejnë argumente që mund të ndihmojnë prindërit të kapërcejnë kundërshtimet e tyre për vizitën e shkollës në xhami.

Përmbledhje dhe vijim

- ▶ Si u ndjetë gjatë kësaj veprimtarie?
- ▶ Sipas mendimit tuaj, cili është shkaku i kundërshtimit nga prindërit të pjesëmarrjes së fëmijëve në vizitën e një qendre fetare, p.sh. në një xhami?
- ▶ Cila do të ishte mënyra më e mirë në të cilën profesionistët të kuptonin prindërit, duke e vënë veten në pozicionin e tyre dhe t'i ndihmonin ata të mposhtnin frikërat e tyre?
- ▶ Duke marrë parasysh përdorimin e kësaj veprimtarie për trajnimin e mësuesve, çfarë do të mbanit si të vlefshme dhe nga çfarë do të hiqnit dorë?

ALTERNATIVË

Ndiqni hapat e mëposhtëm:

1. Trajneri u jep grupeve të gjitha pohimet, së bashku me kohën e nevojshme për t'i lexuar dhe për t'i diskutuar ato.
2. Bëni një listë të kushteve paraprake, që mund të ndihmojnë prindërit të lejojnë fëmijët e tyre të ndjekin vizitën në një xhami.
3. Duke e vënë veten në rolin e një drejtuesi shkolle, pjesëmarrësit shkruajnë një letër për prindërit me anë të së cilës i vënë ata në dijeni për vizitën e shkollës në një xhami.
4. Letra lexohet në seancë plenare.
5. Trajneri bën përmbledhjen si në hapin 8 më lart.

Material 1

Prindër që nuk lejojnë fëmijët e tyre të marrin pjesë

- ▶ Unë jam një mësues matematike, por për shkak të planit mësimor, m'u kërkua të marr pjesë në një udhëtim . Numri i prindërve që kishin kundërshtuar lejen për fëmijët e tyre 8- vjeçarë ishte i habitshëm. Ajo që është më shqetësuese është fakti që pjesa më e madhe e tyre nuk i kanë sqaruar fëmijët e tyre për arsyet e kundërshtimit të tyre. Shumica e stafit mësimor mendojnë se prindërit e kanë quajtur këtë udhëtim si një "Udhëtim drejt xhamisë". Të them të vërtetën, kjo më ngatërron pak, ndonëse mezi pres të marr pjesë në këtë udhëtim, pasi do të vizitojmë katër vende të ndryshme adhurimi dhe mendoj se shumë nga fëmijët ende nuk po e kuptojnë arsyen përse nuk mund të marrin pjesë.
- ▶ Kjo nuk ka të bëjë me respektin, por unë nuk mund ta lë vajzën time të mbulojë kokën, siç kërkojnë pjesa më e madhe e feve të mëdha, me argumentin që gratë duhet të mbulojnë kokën në kishë, sepse ato janë njerëz dhe jo perëndi, që do të thotë që ato nuk janë aq të mira. Pra, nuk është vetëm një çështje respekti, por është angazhim në diçka që për vajzën time do të thotë se duhet të pranojë inferioritetin e saj. Unë nuk e kam problem nëse ajo shkon diku ku askush nuk i kërkon të mbulojë kokën, por jo kur ajo të ketë arritur moshën ku ajo duhet ta bëjë një gjë të tillë.
- ▶ Dy fëmijët e mi më të rritur janë në shkollë të mesme, ndërsa LO është ende një bebe. Problemi nuk u shfaq gjatë kohës së shkollës. Unë e zbulova atë kur ato ishin në shkollën fillore, kur ato po mësonin për çdo fe me përjashtim të Krishtërit. Pra, nëse do të merrnin pjesë në një udhëtim shkollë si ai më sipër dhe jo të mësonin për Krishtërimin, atëherë ata nuk do të shkojnë. Më ka ardhur në majë të hundës me këtë trajtim që i bëhet Krishtërit në ditët e sotme. Si i krishterë e quaj fyese.
- ▶ Unë nuk e lejoj vajzën time të vizitojë një xhami. Ajo është e krishterë, kështu që i vetmi vend nderimi në të cilin ajo duhet të shkojë është kisha. Unë nuk jam dakord me fenë Islame për arsye që nuk kam ndërmend t'i them, pasi nuk dua të filloj një debat të panevojshëm. Deri tani, unë nuk dua ta lejoj vajzën të përfshihet në të. Mosvajtja në xhami, nuk do të ndikojë as arsimimin dhe as jetën e saj. Nëse si një prind, nuk je dakord me diçka, kjo do të thotë se dëshiron të mbrosh fëmijën prej saj, apo jo? Unë dua ta rris fëmijën tim me mendje të hapur dhe nuk do ta rrisja asnjëherë për t'u bërë një raciste ose të diskriminonte kulturat ose fetë e tjera. Unë thjesht nuk dua ta nxis atë në mënyrë aktive në diçka për të cilën unë nuk jam dakord.
- ▶ Jo, vajza ime nuk do të shkojë. Ajo do të rritet me të bardhë, me të zinj, kinezë brenda familjeve tona dhe me këdo që do të bëhet miku ynë, por jo të shkojë në një udhëtim shkollë në vende të tilla! Unë do të nxehesha me vajzën time nëse vajza ime është bërë për të mbuluar fytyrën e saj. Nuk është e drejtë.
- ▶ Më vjen keq nëse dikush ofendohet, por ky është mendimi im. Pësa i përket mbulimit të kokës si shenjë e respektit, kjo është gjë e mirë. Por unë nuk mendoj se gratë myslimane duhet të veshin një perçe si shenjë e respektit për kulturën dhe vendin tonë, pasi të gjithë e dinë që askush nuk e vret mendjen për këtë.

Material 2

Prindër që nuk i lejojnë fëmijët e tyre të marrin pjesë

- ▶ Më vjen keq të them që unë kam disa probleme me të. Për mua, kjo varet nga disa gjëra, moshë e fëmijës etj. Si argumentohet udhëtimi, si përshkruhet vendi fetar në kontekstin e fesë. Për mua nuk ka rëndësi aspekti kulturor, por kam problem me fenë aktuale dhe në mënyrë të veçantë me besimin tek zoti dhe me besimin e verbër. Unë nuk dua që vajza ime ta mësojë atë në çdo kontekst, deri sa të ketë moshën e duhur për të kuptuar atë në rrugë intelektuale dhe jo thjesht të bëjë atë që i thonë. Kjo është hile dhe unë jam i sigurt që ne duhet të merremi me të sa më parë. Fatkeqësisht, ka shumë materiale mësimore për fenë dhe besimin, por unë nuk kam parë ndonjë që të jetë për fëmijët dhe t'u tregojë atyre një këndvështrim ndryshe.
- ▶ Unë jam i sigurt që jo të gjithë do të jenë dakord me mua, por faktikisht, unë nuk mendoj që edukimi fetar duhet të mësohet në shkollë si lëndë e veçantë, aq më tepër të organizohen udhëtime në vende adhurimi fetar. Si pjesë e historisë, ndoshta, por për të qenë i prerë, unë mendoj se ka shumë gjëra të tjera më me vlerë që duhet të mësojnë fëmijët, të cilat do të jenë të dobishme për ta në rrugën e rritjes.
- ▶ Ka shumë njerëz që nuk besojnë në zot, duke përfshirë këtu edhe veten time. Kështu, përse t'i kushtoj kaq shumë kohë diçkaje që, ndoshta, është një përrallë? Ne nuk kemi Borëbardhën me shtatë xhuxhat në kurrikul.
- ▶ Feja Islame pohon të njëjtën gjë që pohonte kur unë isha në shkollë, asgjë nuk ka ndryshuar. Unë jam vetëm 24 vjeç, pra nuk bëhet fjalë për një milion vite më parë.
- ▶ Unë nuk e kam studiuar atë në thellësi dhe nuk kam ndonjë diplomë në fenë islame. Por unë mendoj se di mjaftueshëm për të marrë një vendim të mirëmenduar për vete.
- ▶ Si thashë, unë nuk e detyroj fëmijën time të përqafojë idetë e mia, por as nuk e nxis atë të shkojë në vende të adhurimit fetar që janë në kontradiktë me fenë në të cilën është pagëzuar. Përse të dëshiroj që ajo të mësojë fakte për fe të tjera, nëse unë mendoj se ato nuk janë të vërteta. Nëse ajo dëshiron të zbulojë më shumë kur të jetë më e rritur, unë nuk mund ta ndaloj atë, por atëherë do të jetë vendimi i saj, si një e rritur. Por, si fëmijë, ajo është nën drejtimin tim dhe kjo është mënyra në të cilën unë e drejtoj atë. Unë nuk po i mësoj asaj të jetë raciste ose të mos tregojë respekt për fenë islame. Unë thjesht zgjedh të mos e informoj atë për fenë, pasi nuk e shoh të përshatshme.
- ▶ Vajza ime ka arsim të ndryshëm për moshën e saj, sepse ajo është vetëm 3 vjeç. Por gjatë rritjes, unë do t'i mësoj asaj më të mirën e mundshme në të gjitha fushat, duke përfshirë këtu edhe besimin e saj, Krishtërimin. Unë nuk do t'i mësoj asaj për Islamin, pasi nuk e shoh të nevojshme ose të përshatshme. Kjo nuk do ta lërë vajzën time injorante ose të paarsimuar dhe unë dyshoj se kjo mund të ketë ndonjë ndikim negativ në formimin ose jetën saj. Ju mund të argumentoni se ajo nuk do të jetë e arsimuar sa duhet në lidhje me Islamin, por si thashë, kjo nuk do të ketë asnjë ndikim tek ajo dhe nuk mendoj se është e nevojshme që ajo të dijë gjithçka për të. Ju nuk mund t'i mësoni gjithçka një fëmijë dhe për këtë arsye në shkollë ekzistojnë edhe zgjedhjet për lëndët që lidhen me specializime të caktuara.

Burimi: material online <https://www.netmums.com/coffeehouse/children-parenting-190/primary-schoolage-411-years-60/665016-school-trips-mosques-temples-other-religious-places-all.html>,

Sales agents for publications of the Council of Europe Agents de vente des publications du Conseil de l'Europe

BELGIUM/BELGIQUE

La Librairie Européenne -
The European Bookshop
Rue de l'Orme, 1
BE-1040 BRUXELLES
Tel.: + 32 (0)2 231 04 35
Fax: + 32 (0)2 735 08 60
E-mail: info@libeurop.eu
<http://www.libeurop.be>

Jean De Lannoy/DL Services
c/o Michot Warehouses
Bergense steenweg 77
Chaussée de Mons
BE-1600 SINT PIETERS LEEUW
Fax: + 32 (0)2 706 52 27
E-mail: jean.de.lannoy@dl-servi.com
<http://www.jean-de-lannoy.be>

CANADA

Renouf Publishing Co. Ltd.
22-1010 Polytek Street
CDN-OTTAWA, ONT K1J 9J1
Tel.: + 1 613 745 2665
Fax: + 1 613 745 7660
Toll-Free Tel.: (866) 767-6766
E-mail: order.dept@renoufbooks.com
<http://www.renoufbooks.com>

CROATIA/CROATIE

Robert's Plus d.o.o.
Marasovičeva 67
HR-21000 SPLIT
Tel.: + 385 21 315 800, 801, 802, 803
Fax: + 385 21 315 804
E-mail: robertsplus@robertsplus.hr

CZECH REPUBLIC/ RÉPUBLIQUE TCHÈQUE

Suweco CZ, s.r.o.
Klecakova 347
CZ-180 21 PRAHA 9
Tel.: + 420 2 424 59 204
Fax: + 420 2 848 21 646
E-mail: import@suweco.cz
<http://www.suweco.cz>

DENMARK/DANEMARK

GAD
Vimmelskaftet 32
DK-1161 KØBENHAVN K
Tel.: + 45 77 66 60 00
Fax: + 45 77 66 60 01
E-mail: reception@gad.dk
<http://www.gad.dk>

FINLAND/FINLANDE

Akateeminen Kirjakauppa
PO Box 128
Keskuskatu 1
FI-00100 HELSINKI
Tel.: + 358 (0)9 121 4430
Fax: + 358 (0)9 121 4242
E-mail: akatilaus@akateeminen.com
<http://www.akateeminen.com>

FRANCE

Please contact directly /
Merci de contacter directement
Council of Europe Publishing
Éditions du Conseil de l'Europe
F-67075 STRASBOURG Cedex
Tel.: + 33 (0)3 88 41 25 81
Fax: + 33 (0)3 88 41 39 10
E-mail: publishing@coe.int
<http://book.coe.int>

Librairie Kléber
1, rue des Francs-Bourgeois
F-67000 STRASBOURG
Tel.: + 33 (0)3 88 15 78 88
Fax: + 33 (0)3 88 15 78 80
E-mail: librairie-kleber@coe.int
<http://www.librairie-kleber.com>

NORWAY/NORVÈGE

Akademika
Postboks 84 Blindern
NO-0314 OSLO
Tel.: + 47 2 218 8100
Fax: + 47 2 218 8103
E-mail: support@akademika.no
<http://www.akademika.no>

POLAND/POLOGNE

Ars Polona JSC
25 Obrońcow Street
PL-03-933 WARSZAWA
Tel.: + 48 (0)22 509 86 00
Fax: + 48 (0)22 509 86 10
E-mail: arspolona@arspolona.com.pl
<http://www.arspolona.com.pl>

PORTUGAL

Marka Lda
Rua dos Correios 61-3
PT-1100-162 LISBOA
Tel: 351 21 3224040
Fax: 351 21 3224044
E mail: apoio.clientes@marka.pt
www.marka.pt

RUSSIAN FEDERATION/ FÉDÉRATION DE RUSSIE

Ves Mir
17b, Butlerova ul. - Office 338
RU-117342 MOSCOW
Tel.: + 7 495 739 0971
Fax: + 7 495 739 0971
E-mail: orders@vesmirbooks.ru
<http://www.vesmirbooks.ru>

SWITZERLAND/SUISSE

Planetis Sàrl
16, chemin des Pins
CH-1273 ARZIER
Tel.: + 41 22 366 51 77
Fax: + 41 22 366 51 78
E-mail: info@planetis.ch

TAIWAN

Tycoon Information Inc.
5th Floor, No. 500, Chang-Chun Road
Taipei, Taiwan
Tel.: 886-2-8712 8886
Fax: 886-2-8712 4747, 8712 4777
E-mail: info@tycoon-info.com.tw
orders@tycoon-info.com.tw

UNITED KINGDOM/ROYAUME-UNI

The Stationery Office Ltd
PO Box 29
GB-NORWICH NR3 1GN
Tel.: + 44 (0)870 600 5522
Fax: + 44 (0)870 600 5533
E-mail: book.enquiries@tso.co.uk
<http://www.tsoshop.co.uk>

UNITED STATES and CANADA/ ÉTATS-UNIS et CANADA

Manhattan Publishing Co
670 White Plains Road
USA-10583 SCARSDALE, NY
Tel: + 1 914 472 4650
Fax: + 1 914 472 4316
E-mail: coe@manhattanpublishing.com
<http://www.manhattanpublishing.com>

Council of Europe Publishing/Éditions du Conseil de l'Europe
F-67075 STRASBOURG Cedex

Tel.: + 33 (0)3 88 41 25 81 – Fax: + 33 (0)3 88 41 39 10 – E-mail: publishing@coe.int – Website: <http://book.coe.int>

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.



9 789287 189677

<http://book.coe.int>
ISBN 978-92-871-8967-7
€16/US\$32

